

Projekt i BE-së
Mbi një milion
euro për
30 komuna

Fq.4



**RRËFEHEN
DËSHMITARËT**

Para vrasjes së
pesëfishtë, polici
na kërcënoi me vdekje

Fq.5



TIAGO SILVA

Kanë shumë
histori këto
pesë yje

Fq.22



Koha

www.koha.mk



**Ndaluam
luftën në
Kosovë!**

Fq.12

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3388 · E mërkurë, 13 qershor 2018

19°C | 32°C

15 DEN

EDITORIAL

**"Mizat" në
ambasadat
e huaja**



Shpesh ndodhë që përfaqësuesit e huaj diplomatikë të na mbajnë leksione për disa punë tona të brendshme, të cilat ne i njohim shumë më mire se ata. Është bërë tash më rutinë që vokabulari i këtyre përfaqësuesve të dominohet nga përshkrimet sipërfaqësore të gjendjes, ku zënë vend edhe disa formulime që fare nuk korrespondojnë me realitetin. Dhe kjo...

Fq.2

RAJON

**Evropa t'ia
hapë portat
Ballkanit**

Fq.17

RAJON

**Dëshmitarët
po vdesin,
rrezikohet
ndriçimi i
krimeve të
luftës në
Kosovë**

Fq.17



DEFINOHEN PIKAT E FUNDIT TË MARRËVESHJES GREQI-MAQEDONI

"MAQEDONIA E VERIUT"



"Unë shpresoj se sot do të jemi në gjendje diçka të bukur t'i kumtojmë opinionit. Unë jam optimist se është e mundur që të arrihet marrëveshja... dy qeveritë, shumica e qytetarëve të të dyja shteteve janë të interesuar që përfundimisht të mbyllim këtë kontest shumëvjeçar... nëse gjithçka konkretizohet atëherë mund të takohemi në Prespë për të konkretizuar apo nënshkruar marrëveshjen", ka deklaruar kryeministri Zoran Zaev, duke i bërë thirrje kreut të shtetit, por edhe të gjitha partive tjera, të mbështesin marrëveshjen e mundshme

Fq.3

Çnuklearizim dhe kthimi i robërve të luftës

I pyetur nëse do të ftonte udhëheqësin e Koresë së Veriut në Shtëpinë e Bardhë, Trump tha: "Absolutisht, po. Kjo do të çojë në gjithnjë e më shumë", tha Trump. "Mësora se ai është një njeri shumë i talentuar dhe gjithashtu mësora se ai e do shumë vendin e tij", tha Trump duke iu referuar Kimit. Gazetarja e NBC e ka pyetur gjatë konferencës, se si po e quan 'njeri të mrekullshëm' një person që ka vrarë madje

edhe anëtarë të familjes së tij. Trump ka thënë se e di se kanë ndodhur gjëra të tmerrshme, por gjërat po përmirësohen. "Ai është person i veçantë, mendoj se nisma e fundit tregon se do të ndodhin gjëra të mira. Ka ndodhur gjëra të tmerrshme por njerëzit shpresojnë se diçka e mirë do të ndodhë, në veçanti, të rinjtë. Ai ka shumë punë për të bërë", ka thënë Trump. Më herët, pas përfundimit të...

Fq.14-15



EDITORIAL

"MIZAT" NË AMBASADAT E HUAJA



Emin AZEMI

Shpesh ndodhë që përfaqësuesit e huaj diplomatikë të na mbajnë leksione për disa punë tona të brendshme, të cilat ne i njohim shumë më mire se ata. Është bërë tash më rutinë që vokabulari i këtyre përfaqësuesve të dominohet nga përshkrime sipërfaqësore të gjendjes, ku zënë vend edhe disa formulime që fare nuk korrespondojnë me realitetin. Dhe kjo zakonisht ndodhë kur diplomatët e huaj përdorin dy standarde në qasjet e tyre. Se pse ndodhë kështu, shkaqet mund të jenë të natyrave të ndryshme, por ajo që bie në sy është fakti se nëpër ambasada dhe fondacione të huaja në Shkup dominon një staf vendor që të gjitha zhvillimet në terren i shikon nga prizmi maqedonas. Për rrjedhojë, shumë projekte, iniciativa e ide "hekurosen" nga ky staf, i cili pastaj i prezanton ato në formë mendimesh e sugjerimesh deri te shefat e tyre. Këta të fundit, të painformuar me gjendjen konkrete në terren, nënshkruajnë dokumente finale në stilin "zdravo za gotovo" që si dedikim kanë nevojat e kërkesat e një komuniteti me dominancë maqedonase.

Një koleg po më tregonte një ditë se si një diplomat i rëndësishëm në Shkup, para disa viteve, në një takim me përfaqësues të shoqërisë civile, i shoqëruar edhe nga disa kolegë të tjerë ambasadorë, po e kritikonte ashpër regjimin e Gruevskit për praktikat diskriminuese ndaj qytetarëve të etnive të ndryshme. Me mendime të ngjashme në atë takim ishin paraqitur edhe folësit tjerë, duke sjellë si argument se Gruevski ishte ai që po e frentonte shoqërinë të jetë e lirë dhe e barabartë.

Mirëpo në atë takim ishte shfaqur edhe një mendim ndryshe, pikërisht nga kolegu që po ma rrëfente këtë ngjarje. Si argument që e bënte situatën të shihet nga një këndvështrim tjetër, ai, para se të shprehte pajtueshmëri të plotë sa i përket konstatimeve për Gruevskin, kishte ofruar edhe disa shembuj konkret që tregonin se pikërisht ambasadorët e huaj (disa prej tyre) ishin ata që me asgjë nuk ndryshonin nga qasja e Gruevskit për sa i përket shumë projekteve me të cilat konkurronin pjesëtarë të ndryshëm të shoqërisë shqiptare, kryesisht nga fusha e mediave dhe e demokracisë. Ai kishte prezantuar disa raste kur subjekte të ndryshme të shqiptarëve kishin aplikuar me projekte konkrete në agjenci e ambasada të caktuara, me dokumentacion të kompletuar dhe me të gjithë përbërësit e nevojshëm që një projekt e bëjnë të jetë gjithpërfshirës.

Mund të ketë edhe arsye reale për të refuzuar ndonjë projekt që vjen nga shqiptarët, sepse e kemi të njohur mendjelehtësinë e disave që pretendojnë se mjafton një letër kinse projekt për tu konsideruar si shans financimi. Por, ama është e njohur, në anën tjetër, edhe praktika e refuzimit të projekteve, jo pse ato janë shqyrtuar nga shefat e agjencive e ambasadave, por pse janë filtruar para praktikisht nga pjesëtarë të ndryshëm të stafit vendor, tek të cilët dominojnë preferencat e tifozerisë etnike, që në rastin konkret i bie që mund të mos jesh fans i tyre vetëm pse flet një gjuhë tjetër.

Filtrat e stafeve vendore nuk do të duhej të konsiderohen si qëndrime përfundimtare të ambasadave e agjencive të huaja. Por kur ndodhë që ato qëndrime të mos mbështeten gjithmonë në gjendjen faktike në terren, atëherë duhet punuar më shumë me stafet vendore, që të edukohen më tepër në frymën e diversiteteve kulturore e etnike në këtë shoqëri, me kusht që "mizat" që i kanë ata në krye të mos i bartin edhe në vendet e punës ku punojnë.

PËR MJESHTRIN

"Në vjeshtën e vitit 1987, nga 'Severna Tribina - Maksimir', e kam shikuar ndeshjen Dinamo - Partizani (1:2). Ka qenë hera e tretë që gjendesha në këtë stadium madhështor i mbushur përplot me shikues.

Por, ishte hera e parë që unë nuk do të isha 'navijaq' i ekipit tim: Dinamos. Dinamon po e tradhëtoja jo për shkak të Partizanit por për shkak të Vokrrit. I vetmuar, në mesin e tërë asaj mase të 'çmendur' që përkrahte ekipin e vet vendas, bëja zhurmë, shpesh edhe kur nuk kishte nevojë, në favor të Partizanit. Për çudi të paspjegueshme masa më toleronte. Sikur sot më kujtohen brohoritjet e mëdha të disa dhjetëra mijëra përkrahësve të Dinamos kur filloi ndeshja.

Por, Maksimiri shpejt ra në heshtje. Arsyeja ishte Fadil Vokri. Sa herë e merrte topin (atë ditë topi ishte pothuaj vetëm në këmbët e tija) stadiumin e kaplonte qetësia e vdekjes.

Partizani shënoi golin e parë në minutën e tretë të lojës, tërësisht si meritë e Vokrrit. Rezultati u barazua pas disa minutave por Vokri në minutën 24 shënoi me kokë në mënyrë spektakolare. Loja ishte e Vokrrit. Atë ditë, zagrebasi që i kisha përrreth i pashë të mahnitur dhe shumë herë i dëgjova duke thënë: 'Majstor je, nema šta' (Mjeshtër është, s'ka fjalë).

Disa njerëz, sikur mjeshtri i futbollit Fadil Vokri, vdesin herët.

Por, i përbushin plotësisht qëllimet dhe arsyet e ardhjes në këtë botë. Këta njerëz, në mesin e tyre edhe Fadil Vokri, bëjnë punë dhe arrijnë suksese sa disa miliona njerëz së bashku", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, studiuesi nga Londra, Daut Dauti.

G7 U NXORI BOJËN KRIMINELËVE

"G7 bëri një dridhje. Mjaft i fshehën dridhjet e brendshme që kishin këta të mëdhenjtë duke shkaktuar konflikte nëpër vendet e huaja.

Konflikte false.







Filloi ti dal boja problemeve nga pak. Shpresoj që problemet kyçe të botës dalëngadalë të dalin në shesh.

Të dal në shesh rrënja e tyre, aty ku ka qenë gjithmonë.

Aty ku e ka burimin lufta e helmeve para 100 viteve kur u helmuan dhe u vranë mbi 16 milionë njerëz.

Aty ku u zhvillua lufta që u mori jetën 53 milionë njerëzve, ndërsa duke vranë njerëz u promovua edhe bomba atomike.

Egërsira në ato vende ende është gjallë dhe po kultivohet. Kjo dëshmohet kur i sheh duke shkelur me këmbë mbi fëmijë, duke vranë gra, okupuar vende, eksploatu popuj. Ashtu siç bënë para 150 viteve me të shkretit fukara që me miliona i shpërndanë nëpër Atlantik e pjesën tjetër i skllavëruan duke u marrë të drejtën edhe për tu ushqyer nëpër restorante me parat e tyre të pakta. E vërteta është e hidhur...", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti nga Kumanova, Sead Ramadani.



MEDIACitate

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka thënë se Kosova synon anëtarësimin në NATO si dhe daljen në ndihmë secilit që ka nevojë. Këto deklarata Haradinaj i ka bërë pas zbulimit të memorialit për ushtarët e KFOR-it që kanë humbur jetën në Kosovë.

Haradinaj ka thënë se Kosova dhe populli i saj do të jenë përjetësisht mirënjohës ndaj atyre që dhanë jetën për të siguruar paqe dhe stabilitet në këtë vend. "Kosova synon anëtarësimin në NATO për të ndihmuar jo vetëm veten dhe rajonin, por këdo që ka nevojë. Kosova është e gatshme që të kontribuojë për sigurinë dhe paqen në botë. Ky memorial është një shenjë për këtë", ka thënë Haradinaj. Zëvendësi i Ndihmëssekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, John Manza, në emër të Sekretarit të Përgjithshëm, ka falënderuar popullin e Kosovës, për ndërtimin e këtij memoriali në qendër të Prishtinës.

"Siç e dini NATO ka udhëhequr misionet paqeruajtëse që nga qershori 1999, pothuajse 19 vjet. KFOR-i ka dëshmuar efektivitetin e vet dhe është bërë organizata më e besueshme në Kosovë", ka thënë Manza, duke shtuar se e ardhmja e Kosovës është integrimi në strukturat euro-atlantike. Gjenerali i KFOR-it, Salvatore Cuoci në ceremoninë e zbulimit të pllakatës së 157 ushtarëve të KFOR-it, që humbën jetën gjatë luftës në Kosovë, ka thënë se institucionet e këtij vendi po i nderojnë ushtarët e KFOR-it, duke u ndërtuar një memorial që shërben si kujtesë e përhershme e atyre që u flijuan për Kosovën. "Sot institucionet e Kosovës nderojnë ushtarët e KFOR-it. Respekti për këta ushtarë të rënë tregon se kontributi i tyre çmohet lartë. Përvoja më e hidhur për komandantin është humbja e një ushtari. Falënderoj familjarët për prezencën e tyre këtu sepse kjo do të thotë shumë", ka thënë Cuoci. Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, ka thënë se 12 qershor do të mbetet në historinë e Kosovës si dita e shpresës dhe dita kur vendit i është ofruar bindja se nuk është vetë. "U bënë 19 vjet nga koha kur NATO udhëhoqi operacionin, operacion ky që ktheu shpresën për liri dhe siguri.

(REL, 12 qershor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

KUSH ISHTE HANSTUNMAN?

Hans Tunman (1746-1778) ishte historian suedez, një nga albanologët e parë, profesor në Universitetin e Halles në Gjermani. Në veprën e tij "Hulumtime për historinë e popujve të Evropës Lindore", Hans Tunman bën përpjekjen e parë shkencore për të shpjeguar prejardhjen e shqiptarëve e të gjuhës së tyre. Arriti në përfundimin se shqiptarët mesjetarë janë vazhdues autoktonë të popullsisë antike

të ilirëve, e cila nuk u romanizua dhe as nuk u zëvendësua në viset e veta nga një popullsi e mëvonshme e vendosur këtu. Hans Tunman jep historinë e shqiptarëve mesjetarë si një formacion etno-kulturor unitar dhe si faktor politik më vete. Vepra e tij përbën një ndihmesë për ta vënë mbi baza shkencore problemin e formimit të popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij.

"MAQEDONIA VERIORE"...

DISA NGA PIKAT E MARRËVESHJES

Republika e Maqedonisë Veriore "erga omnes", me gjuhë maqedonase dhe identitet është ajo që përmban marrëveshja që duhet të nënshkruajnë Maqedonia dhe Greqia, sipas informacionit të radios greke "247" dhe gazetarëve të cilët zbuluan detaje nga vendimi. Konkretisht, gazetarët grekë publikuan se në marrëveshje:

- Hiqen citatet në Kushtetutë për "mbrojtjen e pakicës maqedonase" jashtë kufijve dhe zbatohet neni përkatës që ekziston në Kushtetutën greke për diasporën.

- Përcaktohen periudha kalimtare për ndryshimin e dokumenteve të brendshme dhe ky proces i ndërlikuar lidhet me hapjen e kapitujve në negociatat inkuadruese.

- Formohet komision, i cili do ta shqyrtojë përdorimin e shenjave tregtare në të dy vendet.

- Njihet gjuha maqedonase (macedonian language) me shënimin se Maqedonia Veriore në kuadër të marrëveshjes e pranon se kjo gjuhë është me prejardhje sllovene (siç është regjistruar në kuadër të KB-së).

- Lidhur me kombësinë, vlen termi Macedonian/citizen of the Republic of North Macedonia me nënvizim të qartë se populli i këtij vendi nuk ka lidhje me civilizimin antik grek.

- Marrëveshja fillimisht do të ratifikohet në Parlamentin e Maqedonisë, Qeveria greke do të dërgojë shkrim deri në BE dhe NATO, se "e nxit fillimin e negociatave për integrim të Maqedonisë Veriore me BE dhe integrimin në NATO, nën kushtim se do të bëjë revizion kushtetues".

- Lidhur me mbledhjen e ministrave të Punëve të Jashtme të BE-së më 25 dhe 26 qershor në Bruksel dhe samitin e NATO-s në korrik, Koxias në BE do të dërgojë mesazh pozitiv për fillimin e negociatave inkuadruese, ndërsa për Aleancën atlantike të Veriut, "Maqedonia Veriore do të marrë ftesë nën kushtim që të bëhet revizion kushtetues".

- Kryeministri Zaev do të dërgojë shkrim deri te vendet që e kanë njohur Republikën e Maqedonisë me emrin kushtetues që t'i njoftojë se është në fuqi emri "Maqedonia Veriore" për marrëdhënie dypalëshe dhe forume ndërkombëtare.

- Në periudhën nga korriku deri më dhjetor të vitit 2018, Qeveria e Zaevit do të duhet të mbajë referendum dhe nëse epilogu është pozitiv do të bëjë revizion kushtetues. Nëse është negativ, si plan B ekziston siguria e shpalljes së zgjedhjeve parlamentare me karakter referendumi për çështjen e Shkupit.

- Kur të gjitha detyrimet nga pala maqedonase do të përfundohen, atëherë marrëveshja do të vijë në votim në Parlamentin grek, ndërsa në të njëjtën kohë do të ratifikohet edhe anëtarësimi në NATO.

DEFINOHEN PIKAT E FUNDIT TË MARRËVESHJES GREQI-MAQEDONI

"MAQEDONIA E VERIUT"

"Unë shpresoj se sot do të jemi në gjendje diçka të bukur t'i kumtojmë opinionit. Unë jam optimist se është e mundur që të arrihet marrëveshja... dy qeveritë, shumica e qytetarëve të të dyja shteteve janë të interesuar që përfundimisht të mbyllim këtë kontest shumëvjeçar... nëse gjithçka konkretizohet atëherë mund të takohemi në Prespë për të konkretizuar apo nënshkruar marrëveshjen", ka deklaruar kryeministri Zoran Zaev, duke i bërë thirrje kreut të shtetit, por edhe të gjitha partive tjera, të mbështesin marrëveshjen e mundshme

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 12 qershor - Republika e Maqedonisë së Veriut, jo zyrtarisht është emri i ri dakorduar mes kryeministrave të Maqedonisë dhe Greqisë, Zoran Zaev dhe Aleksis Tsipras. Sipas mediave greke, dy palët janë marrë vesh që ky emër të përdoret si brenda ashtu edhe jashtë vendit apo sipas formulës së njohur "erga omnes", për të cilën në vazhdimësi ka insistuar pala greke.

Sipas marrëveshjes, e cila duhet të konfirmohet nga kryeministrat e dy vendeve, gjuha maqedonase njihet, por me vërejtje se kjo gjuhë ka prejardhje sllave ndërsa si i përket identitetit, qytetarët në dokumentet personale do të evidentohen si shtetas të Maqedonisë së Veriut, por edhe këtu me sqarim se bëhet fjalë për një popullatë e cila nuk ka lidhshmëri me kulturën greke.

"Unë shpresoj se sot do të jemi në gjendje diçka të bukur t'i kumtojmë opinionit. Unë jam optimist se është e mundur që të arrihet marrëveshja... dy qeveritë, shumica e qytetarëve të të dyja shteteve janë të interesuar që përfundimisht të mbyllim këtë kontest shumëvjeçar... nëse gjithçka konkretizohet atëherë mund të takohemi në Prespë për të konkretizuar apo nënshkruar marrëveshjen", ka deklaruar kryeministri Zoran Zaev, duke i bërë thirrje kreut të shtetit, por edhe të gjitha partive tjera, të mbështesin marrëveshjen e mundshme. Ndërkohë, për orët e pasdites dje ishte caktuar biseda telefonike e radhës e Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras. Mediat sqar-



rojnë se të dyja palët duhet që fillimisht të njoftojnë përfaqësuesin special të KB-së, ndërsa fakti që mediatori Methju Nimic është në Nju-Jork dhe për shkak të dallimeve kohore, biseda telefonike është caktuar për pasdite.

Siç raportoi korrespondentja e MIA-s nga Athina, jozyrtarisht, pas bisedës telefonike me Zaev, Aleksis Cipras do ta informojë fillimisht presidentin e Greqisë Prokopis Pavllopoulos, më pas liderët e partive politike dhe në fund do të ketë fjalim para opinionit publik. Ndërsa, të premtën, në Parlamentin grek do të mbahet debat që deputetët dhe qytetarët të informohen për përmbajtjen e marrëveshjes.

IVANOVI KUNDËR

Por, presidenti i shtetit, Gjorgje Ivanov, duke komentuar thirrjen e kryeministrit për mbështetjen e marrëveshjes, ka thënë se për zgjidhjen e kontestit nevojitet konsensus i gjerë politik dhe se për një çështje kaq jetësore nuk mund të vendoset përmes një bisede telefonike.

"Presidenti Ivanov edhe njëherë thekson nevojën për konsensus të gjerë kombëtar për gjetjen e zgjidhjes e cila nuk do të rrezikojë dinjitetin e popullit maqedonas dhe të qytetarëve. Presidenti Ivanov vlerëson se është joserioze dhe e papërgjegjshme që për çështjen e emrit, që është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme për qytetarët e Maqedonisë, dhe kërkesa të imponuar, të zgjidhen përmes telefonit dhe marrëveshjes mes vetëm dy kryeministrave të shteteve", kanë kumtuar nga kabineti i presidentit. Por, kryeministri Zaev ka thënë se për marrëveshjen fjalën përfundimtare do ta thonë qytetarët në referendum. "Qytetarët janë atë të cilët do të vendosin në referendum ndërsa unë dhe presidenti Ivanov duhet t'i ndihmojmë njerëzve... unë besoj se do të kemi takime ku do të

mund t'i nxjerrim të gjitha argumentet dhe çdonjëri të veprojë në bazë të kompetencave që ka... ne duhet të punojmë për perspektivën, ne duhet të kemi parasysh se nëse arrijmë marrëveshja zhbllokohet procesin eurointegues dhe më ketë do të ketë perspektivë për të gjithë qytetarët", ka deklaruar Zaev. Ratifikimi i dokumentit parashihet në disa faza bazuar në marrëveshjen e mundshme. Pas kalimit në Parlament, Qeveria greke do t'i dërgojë letër BE-së dhe NATO-s se inkurajon fillimin e negociatave për anëtarësim të Maqedonisë së Veriut në BE dhe NATO, pasi që të bëhen ndryshimet kushtetuese. Një nga fazat është edhe organizimi i referendumit dhe në rast të dështimit të tij atëherë parashihen zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare dhe në rast se fiton partia që mbështet marrëveshjen atëherë kjo do të konsiderohej si mbështetje për dokumentin e dakorduar. Jo zyrtarisht bëhet e ditur se marrëveshja do të nënshkruhet gjatë fundjavës në Prespë të Greqisë dhe me pas ajo do të ratifikohet nga Parlamentet e dy shtetet.

KUMUCAKOS KËRKON DEBAT NË PARLAMENT PARA SE TË FIRMOSËT MARRËVESHJES

Nëse Cipras i paraqitet Mico-takis për ta informuar për marrëveshjen për emrin, atëherë lideri i Demokracisë së Re opozitare do të kërkojë debat në parlament para se të nënshkruhet marrëveshja, zbuloi përgjegjësi për politikë të jashtme në partinë më të madhe opozitare greke, Jorgos Kumucakos, gjatë pjesëmarrjes në emision në televizionin shtetëror ERT. Siç lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina, Kumucakos, thotë se para Prespës dhe para çfarëdo lloj vendimi apo marrëveshje, nevojitet të informohen edhe parlamenti edhe qytetarët, sepse konsideron se edhe vetë nënshkri-

mi e obligon vendin, ndërsa Cipras nuk ka shumicë dhe unitet në qeverinë e tij, duke pasur parasysh atë që partneri i koalicionit, Panos Kamenos është kundër emrit të përbërë me termin Maqedoni. "Cipras nuk ka legjitimitet politik për ta obliguar vendin, kërkojmë debat urgjent në parlament, për popullin grek të marrë vesh, para se të obligohet, çka përmban marrëveshja", thotë Kumucakos dhe shton se kërkesa e tyre "do të konfirmohet në mënyrë më se zyrtare, nëse Cipras i lajmërohet Mico-takisit".

NUK DO TË VOTOJMË PËR MARRËVESHJE ME TERMIN "MAQEDONI"

Partneri i koalicionit në Qeverinë greke, ministri grek i Mbrojtjes dhe kryetar i Greqëve të Pavarur, Panos Kamenos mbetet në qëndrimin e tij se nuk do të mbështesë marrëveshje që do ta përmbajë emrin me termin Maqedoni dhe konsideron se nevojitet edhe takim të liderëve nën organizim të presidentit të shtetit që të ndryshohet vendimi i marrë në vitin 1992, sipas të cilit emri duhet të jetë pa termin Maqedoni. Siç lajmëroi korrespondenti i MIA-s nga Athina, Panos Kamenos pozicionin e pandryshuar e ka përsëritur në konferencën e sotme për shtyp, në të cilën tha se partia ka qëndrim të qartë, të njohur të fortë, por shprehu edhe rezervë nëse marrëveshja do të kalonte tek ne. Lidhur me kushtet në marrëveshje, Kamenos, pa zbuluar detaje, komentoi se janë mjaft të fuqishëm dhe nëse nuk ishte përfshirë emri Maqedoni, ata si parti nuk do të obligoheshin të votonin kundër. Partneri i koalicionit në Qeverinë greke e sqaroi edhe procedurën që do të ndjekë në nënshkrimin e marrëveshjes dhe tha se ky mund të jetë proces që do të zgjasë edhe një vit, ndërsa votimi në parlament të vijë pas zgjedhjeve në Greqi.

Opozita po frenon Ligjin për media

Shkup, 12 qershor - Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mançevski, apeloj deri te Komisioni parlamentar për transport, lidhje dhe ekologji, me të cilin kryeson VMRO-DPMNE, të punojë pa ndalesë dhe për çdo ditë derisa nuk përfundon debati i amendamenteve për Propozim-ligjin për shërbime mediaike audio dhe audiovizuale, dhe i bën thirrje opozitës të harrojë në lojërat e ngushta partiake dhe ta vendosë interesin e qytetarëve në vend të parë. "Nuk jemi kundër debatit për amendamentet, por duhet të përfundojë në një kohë të arsyeshme. Deputetët e VMRO-DPMNE-së janë kundër debatit publik, gjegjësisht paraqitje publike të kandidatëve për anëtarë të Këshillit programor të RTM-së dhe të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediaike Audio dhe Audiovizuale", tha Mançevski në konferencën e djeshme për shtyp në Qeveri dhe shtoi se po bëjnë gjithçka që vetëm të vazhdojë mandati i udhëheqësve aktual në RTM dhe ASHMAA nga ku një pjesë e madhe janë anëtarë partiakë dhe funksionarë të lartë partiak të tanishëm dhe të mëparshëm në VMRO-DPMNE. Ai theksoi se tashmë katër muaj opozita me debate të pafundshme lidhur me amendamentet e parashtruara e frenon miratimin e ligjit për media. "U mbajtën gjashtë seanca të Komisionit ku arritëm të kalojmë vetëm shtatë amendamente, ndërsa na mbesin edhe 67. Me këtë dinamikë ligji do të miratohet për 2.5 vjet nga tani", tha Mançevski. Ai theksoi se edhe më shqetësuese përmbajtja e amendamenteve. Në ndryshimet, theksoi ai, propozohet që programi i obligueshëm i RTM-së me produksion vendor të ulet nga 50 për qind sa është aktualisht në 40 për qind, ndërsa në amendamentet VMRO-DPMNE kërkon edhe ulje edhe rritje dhe propozon të ketë prej 30 deri në 70 për qind në shtatë amendamente të ndryshme. (E.H)

I themeluar në vitin shkollor 2015/2016, gjimnazi "7 Marsi" i Tetovës u bë me pedagog vetëm para dy muajve, kur në prill të 2018-ës u sigurua leja për financimin e një vendi pune për shërbimin profesional në këtë shkollë të mesme. Për psikolog, sociolog apo defektolog, pra për kompletimin e stafit me të gjitha shërbimet profesionale, as që bëhet fjalë. Situata të këtilla ka në shumë shkolla duke mos përjashtuara as ato të kryeqytetit

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 12 qershor - Nevojat e shkollave për të punësuar kuadër profesion jo çdoherë janë konform kërkesave të tyre dhe mundësive

FILLON IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT TË BE-së

MBI NJË MILION EURO PËR 30 KOMUNA

Fillimisht është parashikuar financimi i tetë projekteve, në tetë komuna malore, ndërsa 30 komuna të tjera do të përfitojnë gjatë fazës së dytë të projektit, për projektet e të cilave është parashikuar një fond prej më shumë se një milion euro. Fondi i përgjithshëm që BE vë në dispozicion për përmirësimin e qeverisjes në pushtetin lokal është mbi 2.4 milionë euro

Koha

Evis HALILI

Shkup, 12 qershor - Ka filluar në praktikë implementimi dhe aktivitetet konkrete të projektit "Përmirësimi i menaxhimit të komunave", për të cilin Bashkimi Evropian ka ndarë 2.4 milionë euro. Kriteret e financimit që duhet të plotësojnë projektet e hartuara nga komunat janë bërë publike në forumin e organizuar të martën, ku ishte morën pjesë ministri i Vetëqeverisjes Lokale, Suhejl Fazliu dhe përfaqësues të UNDP. Fillimisht është parashikuar financimi i tetë projekteve, në tetë komuna malore, ndërsa në 30 komuna të tjera do të përfitojnë gjatë fazës së dytë të projektit, për projektet e të cilave është parashikuar një fond prej më shumë se një milion euro. Në konsultimet e para me përfaqësues të komunave është folur për principet e përgjithshme mbi bazën e të cilave duhet që të ngrihen kriteret për hartimin dhe përzgjedhjen e tetë projekteve të para. Sa



i takon fazës së parë të projektit ku mbështeten projekte që vijnë nga zonat malore, mbi të gjitha ato duhet të përmbajnë komponentin e zhvillimit dhe se me anë të tyre të mundësohet zhvillimi i zonave malore, turizmi, ekonomia, e të tjera.

"Gjatë përgatitjes së këtyre projekteve duhet të merren parasysh qëllimet globale për zhvillimin e qëndrueshëm, si një vizion nga mund të orientohen përmes realizimit të politikave të zhvillimit nacionale dhe lokale.... Që nënkupton se me këto projekte duhet të nxitet zhvillimi i këtyre zonave malore dhe të rritet konkurrenca e tyre në kuadër të politikës rajonale të zhvillimit të BE", ka thënë ministri i Vetëqeverisjes lokale, Suhejl Fazliu. Qëllimi i projektet është që përmes qeverisjes së mirë të pushtetit lokal të sigurohet akses edhe më cilësor i qytetarëve në shërbimet komuna-

le dhe përmirësimi i cilësisë së jetës, që sipas realizuesve projekti është një hap më tej në këtë drejtim.

Në takim u bisedua edhe për zbatimin e dy projekteve aktuale përmes së cilëve Ministria për vetëqeverisje lokale në bashkëpunim me UNDP është duke punuar për forcimin e kapaciteteve të komunave për përmirësimin dhe ofrimin e shërbimeve si dhe përmirësimin e sistemit të qeverisjes vendore, përmes vendosjes së sistemit për monitorimin e funksionimit të komunave, njofton Ministria e Vetëqeverisjes Lokale. Në forumin e organizuar për promovimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dhe zhvillimit të komunave, po ashtu është prezantuar edhe programi për ndarjen e ndihmave financiare të pakthyeshme për Qendrat për zhvillimin e rajoneve.

PUNËSIMET NË ARSIM ME VËSHTIRËSI TË SHUMTA

SHKOLLAT PA PEDAGOGË DHE PSIKOLOGË

që krijohen në bllok-dotacionet që ndan Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) për shkollat fillore dhe të mesme. Për shkak të mos harmonizimit të kërkesave me mundësitë e krijuara, rrallë ndonjë shkollë e ka të kompletuar stafin profesional me pedagog, psikolog, sociolog dhe defektolog. Në rastin më të mirë, shkollat kanë zakonisht pedagogun dhe psikologun dhe eventualisht sociologun apo defektologun, por thuajse asnjëherë të gjitha shërbimet profesionale.

Këto mungesa, të pranishme sidomos në arsimin e mesëm, sikurse shpjegojnë kompetentët, vijnë për shkak të buxhetit jo të mjaftueshëm të parave me të cilat financohet arsimi, për çka shkollat dhe komunat duhet të persin me vite të tëra derisa të sigurohet leja për hapjen e një vendi të ri pune në arsim. Me kuadrin

mësimor, sikurse tregon Amet Qazimi, përgjegjësi për arsim në Komunën e Tetovës, gjwrat shkojnë pak më lehtë. Por edhe këtu, që të hapet një vend i ri pune apo të financohet ai vend, duhet që Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) të sigurojë nga Ministria e Financave lejen përkatëse. Ndërsa kur është në pyetje punësimi i kuadrove për shërbimet profesionale dhe stafit teknik të shkollës, gjërat ndryshojnë. Marrja e lejeve shkon përmes Ministrisë të Shoqërisë Informatike (MSHI) pasi punësimet në fjalë bëhen përmes agjencive të punësimit, vëren Qazimi, ndërsa jo më pak e diskutueshme, sipas tij, është edhe formula për financimin e shkollave, prandaj e buxhetit të shkollave përmes bllok-dotacioneve. Sikurse dihet, kriteri bazë për financimin e shkollave është numri i nxënësve, i cili shënon rënie viteve të fundit.

Mirëpo, pavarësisht kësaj rënie, kemi rritjen e nevojave të shollave për shtimin e kuadrit, qoftë me staf mësimdhënësish - qoftë me staf profesional dhe teknik. Kështu që kemi një raport të zhdrejtë të financimit të shkollave me nevojat reale të tyre, pa përmendur këtu vështirësitë në sigurimin e lejeve për financimin e vendeve të punës, plotëson ai.

Gjimnazi "7 Marsi" i themeluar në vitin shkollor 2015/2016, nuk kishte asnjërin prej shërbimeve profesionale deri në prill të 2018-së. Vetëm para dy muajve u mundësua punësimi i një pedagogu në këtë shkollë, ndërsa për psikolog, sociolog dhe defektolog, aq nuk bëhet fjalë.

Qëllimi i Komunës së Tetovës ishte që asnjë shkollë fillore dhe e mesme të mos mbetej e pa përfshirë me shërbimet profesionale dhe ky objektivi u arrit me siguri-

min e lejes për financimin e vendit të punës pedagog në gjimnazin "7 Marsi". "Për momentin nuk kemi asnjë shkollë pa kuadër të stafit profesional", thotë Qazimi, "ndërsa objektivi i radhës është që të kompletohen të gjitha shkollat me komplet shërbimin profesional".

Shkollat e Tetovës sigurisht që nuk janë të vetmet me mungesa të theksuara sa i takon shërbimeve profesionale. Situata të këtilla ka në shumë shkolla pa përjashtuar edhe ato të Shkupit, apo edhe të Kumanovës ku megjithëse funksionojnë si të ndara prej shkollave amë, paralelet e mesme me mësim në gjuhën shqipe të drejtimeve teknikë, ekonomi dhe bujqësi - nuk kanë as edhe njërin prej shërbimeve në fjalë. Pra jo që nuk e kanë të kompletuar stafin me kuadro të shërbimeve profesionale, por nuk kanë asnjërin prej tyre.

DETAJE TË REJA NGA DËSHMITARËT E LIQENIT TË SMILKOVËS

PARA VRASJES SË PESËFISHTË, POLICI NA KËRCËNOI ME VDEKJE



"Drejtë rrugës kryesor në plazhin e dytë, e vërejtëm një veturë të errët, ku te ulësja e shoferit qëndronte një person. Papritmas, përpara na doli një njeri me pushkë në dorë dhe na tha: 'Ndal, policia'. Ne u shtangëm. Ai kishte të veshur uniformë të errëta, mendoj se kishte edhe jelek antiplumb. Më pas na kërcënoi duke na kërkuar të largohemi se ndryshe do të na vriste. Prapa tij, me sa kujtoj, ishin edhe 3-4 katër persona tjerë", tha dëshmitari Kemal

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 12 qershor - Ahmet Bekir dhe Nesim Kemal, dëshmitarë në rastin "Monstra", të hënë rrëfyan detajet e 12 prillit të vitit 2012, kur në liqenin e Smilkovës u krye vrasje e pesëfishtë. Për dallim nga Nesimi, dëshmitari Ahmet, qytetar rom rreth 70-vjeçar, pasi filloi të përshkruaj ngjarjen e 12 prillit, ai u alivanos dhe me Ndihmën e Shpejtë, u largua nga Gjykata Penale e Shkupit. Peshkimi dhe rekreacioni kishin qenë arsye kryesore se pse këta dy qytetarë datën e 12 prillit, së bashku me shokë tjerë, kanë shkuar në vendin e zakonit, në Liqenin e Smilkovës, në periferi të Shkupit. Sipas dëshmitarit Nesim Kemal, lokacioni i këtij liqeni si nga ana e tyre po edhe nga peshkatarë tjerë, ka qenë mjaft atraktiv dhe shumë i vizituar. Kësisoj, ai shtoi se brenda muajit shumë shpesh me shokët tjetër kanë shkuar në këtë vend.

"Atë ditë, nga shtëpia u nisëm rreth orës 14:00 dhe për një orë arritëm aty. U vendosëm si zakonisht, i hapëm kallamet e peshkimit dhe bisedonim si çdoherë. Brenda një ore apo më shumë, në afërsi tonën erdhën tre apo katër persona, me veturë ngjyrë të bardhë, llojin nuk e di. Njëri prej tyre më kërkoi krimba për peshkim. I thash se unë gjuaj peshkun me bukë dhe ai u largu. Ata ishin në një largësi prej 4-5 metra, mirëpo mes nesh kishte drunjë. Brenda

kohës ata u larguan dhe u përshëndetën. Kështu që, edhe ne kur filloi të errësohet, u nisëm për në shtëpi. Drejtë rrugës kryesor në plazhin e dytë, e vërejtëm një veturë të errët, ku te ulësja e shoferit qëndronte një person. Papritmas, përpara na doli një njeri me pushkë në dorë dhe na tha: 'Ndal, policia'. Ne u shtangëm. Ai kishte të veshur uniformë të errëta, mendoj se kishte edhe jelek antiplumb. Më pas na kërcënoi duke na kërkuar të largohemi se ndryshe do të na vriste. Prapa tij, me sa kujtoj, ishin edhe 3-4 katër persona tjerë", tha dëshmitari Kemal.

Largësia nga vendi i peshkimit deri te lokacioni ku i kishte ndalur polici, siç tha dëshmitari Kemal, është më tepër se një kilometër. Të habitur dhe të frikësuar nga kërcënimi i policit (i cili ashtu ishte prezantuar) dëshmitarët në rastin "Monstra", më 12 prill janë nisur të kthehen në vendin ku ka qenë duke peshkuar më herët, gjegjësisht gjatë kësaj kohe dëshmitari Kemal kishte dëgjuar të shtëna të njëpasnjëshme. Duke mos ditur se çka ndodhur, ata në hapësirën e Liqenit të Smilkovës janë fshehur për më tepër se një orë derisa kishte rënë errësira e plotë.

"Pasi i dëgjua krismat, ne ikëm me vrap drejtë vendit ku peshkonim fillimisht. Brenda kohës Ahmeti e thirri djalin e tij për ta marrë me veturë dhe ai e priste të mbikalimi i rrugës kryesore. Rrugës, duke u kthyer, e vërejtëm një veturë ngjyrë hiri, në afërsi të

të cilës ishte të shtrirë trupat e 3 apo 4 personave. Dyert e veturës ishin të hapura dhe kallamet e peshkimit ishin afër. Ne u frikësua më tepër dhe nuk ndalua farë. Por vazhduam tutje dhe kështu arritëm në shtëpi", theksoi dëshmitari Nesim Kemal.

Ai, mes tjerash shtoi se pasi i kishin dëgjuar të shtënat dhe i kishin parë trupat e shtrirë, kishin supozuar se bëhet fjalë për vrasje, për të cilët në mënyrë më të detajuar ishin njoftuar nga lajmet. Ndërkohë, të nesërmen policia i kishte marrë dhe dërguar në stacionin policor, ku edhe kanë dhënë deklaratat për ngjarjet.

Ndryshe, gjatë marrjen në pyetje, prokurorja speciale Fatime Fetaj ia kujtoi Kemalit se në deklaratën e dhënë para gjykatësit hetues, gjashtë vite më parë, (më 14 prill 2012), ai kishte potencuar se personi i cili i kishte ndaluar, ka folur në gjuhën maqedonase, me theks të shqipës. Njëkohësisht, prokurorja Fetaj e pyeti se valë e kishte lexuar deklaratën para se ta nënshkruaj? Nesim Kemal u përgjigj negativisht dhe tha se qëndron në fjalët e thëna në këtë seancë, duke mos përmendur çështjen e dialektit dhe theksit të policit që ju kishte drejtuar. Seanca e radhë për rastin "Monstra" është caktuar të mbahet më datë 25 qershor, respektivisht kjo fazë e rigjykit kryesisht lidhet me prezantimit e provave dhe dëshmitarëve, të cilët janë paraqitur atë kohë.

KRONIKË

Aksion policor në lokalit e natës në Negotinë

Të hënë mbrëma, pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, Stacioni policorë Gostivar dhe Stacioni policorë Gallate, kanë kryer bastisje në objektin hotelierik "Alpa Mare" dhe në hapësirat ndihmëse të objektit, pronë e personit T.F. (49) nga fshati Negotinë i Gostivarit. Sipas policisë, në objektin hotelierik janë takuar personat A.O. 19 vjeç nga fshati Pirok, i angazhuar si kamerier dhe personi A.B. 44 vjeç nga fshati Negotinë, i cili ka punuar si banakier, gjithashtu janë takuar edhe disa femra të cilat kanë punuar si këngëtare dhe valltare edhe atë: S.M. 21 vjeçe nga Makedonski Brodi, D.Gj. 39 vjeçe nga Velesi, R.M. 33 vjeçe nga Republika e Shqipërisë me qëndrim të rregulluar në Maqedoni, gjegjësisht në Gostivar. Po ashtu, është arrestuar edhe T.J. 31 vjeçare nga Gostivari, B.B. 44 vjeçare nga Republika e Shqipërisë me qëndrim të rregulluar në Maqedoni në Gostivar dhe I.C. 45 vjeçare, gjithashtu nga Shqipëria me qëndrim të rregulluar në Gostivar. Bastisja është kryer në prezence të pronarit të lokalit T.F. ku gjatë kontrollit menjëherë pas banakut janë gjetur nëntë qese najloni me mbetje nga substanca e panjohur pluhuri dhe një enë me shenja të dukshme të substancave të lartpërmendura, që bën të ketë dyshim të arsyeshëm, se në hapësirat e lokalit përdoren droga narkotike, thonë nga policia e Tetovës. Lëndët e gjetura janë marrë nga vendi ku janë gjetur nga ana e krim-ekipit, ku me vërtetim janë marrë nga personi A.B. për ekspertizë si dhe procedure të mëtejme.

Arrestohet shkupjani, ofendoi policët

Të hënë rreth orës 14 e 5 minuta, pjesëtarë të policisë nga Stacioni policor për Siguri në komunikacion dhe rrugë, gjatë patrullimit në bulevardin "Iliria", në zonën të rrethrotullimit me bulevardin "Blagoja Toska" kanë vërejtur veturën "Krajsler" me targa të Shkupit, e cila ka qenë gabim e parkuar, dhe ka penguar qarkullimin e lirshëm. Gjatë tentimit të merren masa ndaj vozitësit, nga ana e bashkudhëtarit ka dalur personi R.A. 31 vjeçar nga Shkupi, të cilit i është dhënë urdhër që ta thirr vozitësin. Pasi i kanë sqaruar për kundërvajtjen e kryer dhe gjobën personit B.B. 32 vjeç nga Shkupi, i cili e kishte parkuar veturën në atë vend, ka reagu bashkudhëtarit R.A. me fjalë nënçmuese ndaj pjesëtarëve të policisë dhe në një moment, edhe fizikisht e ka sulmuar, duke penguar në kryerjen e detyrës zyrtare, dhe ka tentuar të kthehet në veturë. I njëjti menjëherë është privuar nga liria, ndërsa ka dhënë rezistencë aktive, ndërsa më pas i njëjti është dërguar në Stacionin policorë Tetovë, për procedure të mëtejshme. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit, ku edhe do të aplikohen padi adekuate. (U.H)

Shkup, 10 të lënduar në 9 aksidente

Shkup, 12 qershor - Nëntë persona janë më pak të lënduar dhe një më rëndë në gjithsej nëntë aksidente të regjistruara në 24 orëshin e fundit në rajonin e SPB-së Shkup.

Policia e komunikacionit ka sanksionuar 69 shoferë të cilët kanë qarkulluar

me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, ndërsa nga komunikacioni janë përjashtuar gjithsej 21 shoferë, prej të cilëve tre që kanë drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit dhe 18 shoferë të cilët kanë drejtuar automjetin para se të marrin patentë shoferi. Nga komunikacioni janë

përjashtuar 21 automjete, me vlerë të skaduar të patentë shoferit, 98 automjete të cilat janë parkuar në mënyrë të paligjshme, ndërsa me karrotrec janë mënjanuar 60 automjete. Njëzet e tetë shoferë janë dënuar për shfrytëzimin e celularit.

EKSPERTËT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË MAQEDONISË

VETËM INTEGRIMI SHPËTON EKONOMINË

Qeveria e Maqedonisë për momentin nuk ka dalë me qëndrim nëse do ta ulë projeksionin për rritje ekonomike prej 3.2 për qind për këtë vit. Banka Botërore e ka korrigjuar projeksionin për rritjen e ekonomisë së Maqedonisë në 2.3 për qind për vitin 2018



Shkup, 12 qershor - Njohësit e çështjeve ekonomike theksojnë se stagnimi i zhvillimit ekonomik mund të jetë me pasoja fatale për Maqedoninë në aspektin e mirëqenies sociale, nëse vendi nuk arrin të zhblllojë proceset integruese dhe me këtë të marrë, siç thotë, infuzion financiar. Ekspertët thonë se rritja ekonomike prej vetëm 0.1 gjatë fillimit të këtij viti paraqet alarm se shteti është në prag të recesionit.

Ndërkohë, gjatë të hënës ministri i Financave në Maqedoni, Dragan Tevdovski, ka paralajmëruar realizimin e programit të reformave ekonomike 2019-2021, përmes së cilave synohet përshtetimi i rrugëtimit të Maqedonisë drejt anëtarësimit në familjen evropiane. Ministri Tevdovski ka theksuar se ngeçjet në ndërtimin e autostra-

dave janë shkaktarë për rritjen e vogël të ekonomisë në tremujorin e parë, megjithëse ka shtuar se kjo Qeveri ka ndërprerë investimet në fasadat barok, për të mos shpenzuar paratë e qytetarëve dhe kjo sipas tij ka ulur edhe rritjen ekonomike.

Alaudin Zeqiri, ligjërues në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tetovës për Radion Evropa e Lirë thotë se Maqedonia sa më afër familjes evropiane të jetë, aq më shumë do të ketë qasje në fondet evropiane, që i japin shtytje zhvillimit të ekonomisë së vendit. Megjithatë, Zeqiri thekson se rritja ekonomike prej 0.1 për qind paraqet kampanë alarmi se gjërat po shkojnë shumë keq në planin ekonomik në vend.

"Sigurisht se nëse analizohet

pjesa integruese, përkatësisht çdo shtet që është pretendent për të qenë pjesë e BE-së shfrytëzon fonde plotësuese. Megjithatë, rritja ekonomike prej vetëm 0.1 për qind në pjesën e parë të këtij viti paraqet alarm për Qeverinë, andaj nevojitet që sektori i ekonomisë të ketë një zgjim për të ngritur rritjen ekonomike", thotë Zeqiri. Ekspertë vlerësojnë se për t'u arritur shkalla e projektuar nga ana e Qeverisë prej 3.2 për qind e rritjes ekonomike do të duhet që deri në fund të vitit, në tre tremujorët e ardhshëm, Maqedonia të shënojë rritje prej 4.2 për qind, gjë që nuk ka ndodhur asnjëherë në Maqedoni.

Eksperti i ekonomisë, Zoran Ivanovski për Radion Evropa e Lirë thotë se Qeveria duhet të fokusohet në realizimin e investimeve

kapitale, sipas të cilit, realizimi i reformave në planin ekonomik, ecë me dinamike tejet të ngadalësuar. "Çështje thelbësore mbetet kapaciteti kësaj përbërjeje qeveritare që t'i realizojë projektet e planifikuara kapitale. Të detektojë pikat se ku duhet vepruar dhe eliminonjë të gjitha pengesat gjatë fazave të ndryshme të realizimit të tyre, me qëllim që t'u mundësohet të punojnë me kapacitet të plotë kompanitë në sektorin e ndërtimit", si degë shumë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Maqedonisë", thotë Ivanovski.

Partia opozitare maqedonase VMRO-DPMNE edhe sot përmes një komunikate për mediat ka akuzuar dhe ka kërkuar përgjegjësi, nga siç theksojnë, treshja që e ka futur në kolaps financiar vendin

kryeministri Zoran Zaev, zëvendëskryeministri për çështje ekonomike Koço Angjushev dhe ministri i Financave, Dragan Tevdovski. "Paaftësia e Qeverisë së socialdemokratëve e ka çuar vendin në humnerë. Produktet gjithnjë e më shumë shtrenjtohen dhe këtë presion të varfërimit e ndjejnë në kuriz qytetarët. Askush gjerë më tani s'ka marrë përgjegjësi. Kjo është e patolerueshme", thuhet në komunikatën e VMRO-DPMNE-së. Përdërisa, Qeveria e Maqedonisë për momentin nuk ka dalë me qëndrim nëse do ta ulë projeksionin për rritje ekonomike prej 3.2 për qind për këtë vit. Banka Botërore e ka korrigjuar projeksionin për rritjen e ekonomisë së Maqedonisë në 2.3 për qind për vitin 2018. (REL)

Prilli me më shumë turistë

Shkup, 12 qershor - Në Maqedoni në prill të këtij viti janë evidentuar 82.635 turistë, të cilët kanë realizuar 164.183 buajtje, kumtoi Enti shtetëror i statistikave. Numri i turistëve në prill të vitit 2018 në krahasim me prillin e vitit të kaluar, është rritur për 21.4 për qind, ndërsa i buajtjeve për 17.2 për qind. Numri i turistëve vendorë është rritur për 12.3, ndërsa i turistëve të huaj për 25.5 për qind. Numri i buajtjeve të turistëve vendorë është rritur për 6.1, ndërsa i turistëve të huaj për 24.5 për qind. Në periudhën janar - prill 2018, lidhur me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, numri i turistëve është rritur për 18.7 për qind, dhe atë: tek turistët vendorë për 10.8 për qind, ndërsa tek të huajt për 23 për qind. Numri i buajtjeve, ndërkaq është rritur për 17.5 për qind. Tek turistët vendorë ka rritje për 10.3, ndërsa tek të huajt për 22.5 për qind.

BIZNES FORUM ITALIAN NË MAQEDONI

Mbështetje italiane për Korridorin 8 dhe 10

Shkup, 12 qershor - Interesimi për të investuar në Maqedoni është duke u rritur dhe është gjithnjë e më i madh për shkak të miqësisë, reformave të cilat po ndodhin në shtetin tonë dhe perspektivat të cilat i sigurojmë. Besoj se i gjithë interesi në fund do të shndërrohet në zhvillimin e cilësisë së jetës së qytetarëve tanë, nga aspekti i ekonomisë, infrastrukturës, energjetikës dhe prej çfarëdo lloji të perspektivave, të cilat i presin gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme. Këtë dje e deklaroi kryeministri Zoran Zaev pas hapjes së Biznes Forumit të Italisë dhe të Maqedonisë me temë "Projektet investuese dhe mundësitë në sektorët transport, energjetikë dhe mjedis jetësor në Maqedoni". Ai kumtoi se janë të përkushtuar në realizimin e procesit të gazifikimit përmes intensifikimit të ndërtimit të rrjetit gazsjellës por edhe lidhjes së gazit në tokë nga gazsjellësi TAP. Kryeministri u përqendrua edhe në zhvilli-



min e planifikuar të infrastrukturës rrugore, në ndërtimin dhe rehabilitimin e 800 kilometrave rrugë në mbarë Maqedoninë për çka janë siguruar 270 milionë euro, një pjesë e tyre janë mjete buxhetore, ndërsa një pjesë e Bankës Evropiane për Ripërtëritje dhe Zhvillim dhe Banka Botërore. Ambasadori italian në Maqedoni, Karlo Romeo theksoi se Italia jep

mbështetje të madhe për korridorët 8 dhe 10 dhe se viteve të fundit është regjistruar përfshirje më e madhe e kompanive italiane në projektet infrastrukturore me vlerë më të madhe se 125 milionë euro.

Ai vlerëson se kompanitë italiane kanë interes dhe dëshirojnë të kyçen në projekte të cilat shteti dëshiron t'i realizojë viteve të

ardhshme, si projektimin dhe ndërtimin e rrugëve, hekurudhave, gazsjellësve... Kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov kumtoi se Shkupi është qytet i pazhvilluar dhe se i nevojitet infrastrukturë e re. Paralajmëroi se së shpejti do të publikohet tender ndërkombëtar për projektimin e viaduktit mbi lumin Vardar dhe tunelet nën Kalanë e Shkupit. (Z.V)

KREDITIMI I BUJQËSISË

BANKAT TË SHKOJNË TE FERMERËT, JO ANASJELLTAS

Bujqit ankohen se kushtet e kreditimit nuk janë të favorshme, ndërsa shpesh mungojnë edhe produktet bankare të dizajnuara enkas për bujqit me kushte fleksibile dhe në bazë të specifikave të prodhimitarisë bujqësore



Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 12 qershor - Bankat në Maqedoni jo se nuk ofrojnë kredi për bujqit dhe zhvillimin e bujqësisë, por megjithatë kushtet e kreditimit nuk janë të favorshme, ankohen bujqit. Gjithashtu, shpesh mungojnë edhe produkte bankare të dizajnuara enkas për bujqit me kushte fleksibile në bazë të specifikave të prodhimitarisë bujqësore, si dhe kreditë me vlera më të ulëta prej disa mijë euro në bazë të kërkesave dhe nevojave të bujqve.

Gjithashtu, edhe shteti nevojitet që sa më parë të realizojë kërkesën disave bujqve për formimin e Fondit Garantues që do të lehtësojë marrjen e kredive për këtë veprimtari ekonomike, ku me

shumë vështirësi qarkullohen dhe kthehen të hollat e investuara.

"Bankat në Maqedoni kanë interesim të kreditojnë fermerët, por megjithatë, si bankat ashtu edhe shteti, duhet të marrin parasysh faktin se prodhimitaria e ushqimit është një interes strategjik i çdo shoqërie. Andaj nevojitet që të mos mbetet vetëm në letër, por të jetësohet edhe në praktikë Fondi Garantues për bujqit që do sigurojë deri në 50 për qind nga garancitë e nevojshme bankare. Gjithashtu, nevojitet maksimalisht të thjeshtësohen edhe procedurat e ndryshme bankare me qëllim që bujqit më lehtë të marrin kredi për të financuar prodhimitarinë bujqësore dhe blegtorale", thotë Memet

Sinani, kryetar i kooperativës "Kamjani", nga fshati Kamjan i Tetovës, në debatin e djeshëm profesional nga Sesioni i dytë punues i Konventës Kombëtare për BE-në në Maqedoni (KEBE-MK).

Sipas tij, bankat nevojitet të mendojnë edhe për kreditimin e fermerëve edhe për shumën prej disa mijë euro, dhe jo të fokusohen në kredi të mëdha prej 15 mijë euro, pasi siç u shpreh Sinani, natyra e punës në bujqësi shpesh kërkon edhe mbulimin e punëve të ndryshme me shumën më të vogël të borxheve kreditore.

"Bankat në Maqedoni duhet më shumë të ndjekin nevojat dhe kërkesat e bujqve. Në këtë drejtim, ato duhet të shkojnë tek fermerët

dhe jo anasjelltas, duke intensifikuar për shembull mobilitetin apo duke qenë më afër në teren me ekipet e tyre pranë fermerëve. Pra, nevojitet të krijohen më shumë produkte bankare të dizajnuara enkas për bujqit me kushte fleksibile në bazë të specifikave të prodhimitarisë bujqësore, kur - për shembull, ia vlen të mendohet edhe për pagesën jo mujore, por tremujore apo në bazë të kuartalit, kur fermerët edhe fitojnë të hollat nga pagesa e prodhimeve të tyre", thekson më tej Sinani.

Në ndërkohë, nga Ministria e Bujqësisë kanë premtuar se së shpejti do të jetësohet Fondi shtetëror garantues, që do të lehtësojë qasjen e fermerëve ndaj kredive.

Ministri i Bujqësisë, Lupço Nikollovski, tha se Qeveria ndërmerr masa intensive për qasje më të lehtë deri te financat në bujqësi. Vetëm këtë vit, janë parashikuar 30 milionë denarë për subvencionimin e normave të interesit për investimet IPARD, ndërsa së shpejti duhet të funksionojë edhe fondi kombëtar i garancisë, i cili do të jetë një lloj garantuesi për fermerët.

"Që të lehtësohet qasja deri në kredi nga bankat dhe shtëpitë e kursimit, Qeveria ka vendosur skemë të garantuar prej 26 milionë denarësh, me të cilën mbulohej struktura e ndryshme e bizneseve bujqësore, gjegjësisht huamarrësit, nga fermerët e vegjël deri tek operatorët e biznesit dhe përpunuesit. Përmes këtij fondi, është siguruar garanci për maksimum prej 50 për qind nga lartësia e kredisë së kërkuar, vlera e së cilës mund të jetë më shumë se 500,000 dollarë", tha ministri. Pas përfundimit të këtij projekti, shtoi Nikollovski, duhet të fillojë Fondi kombëtar garantues. Sipas koordinatores të KKBE-MK, Mileva Gjurovska, kreditimi nuk duhet t'i kompensojë vetëm mundësitë e kufizuara të financimit, por për shkak të specifikave të bujqësisë, duhet të merren parasysh pasiguria në rendimentet e pritshme, çmimet dhe distancat kohore nga shfaqja e shpenzimeve deri në fitimin e prodhimeve.

Nga 1 qershori i vitit 2017 e deri më tani janë regjistruar 12 raste në të cilat është përkeqësuar siguria e gazetarëve dhe të gjitha këto 12 raste janë zbardhur nga ana e MPB-së

Shkup, 12 qershor - Policia duhet të mësojë se gazetarët, të cilët raportojnë nga protestat nuk janë armiq, por gjithashtu profesionistë në krye të detyrës, të cilët duhet të mbrohen nëse sulmohen nga pjesëmarrësit në protesta. Këtë mbrojtje e meritojnë në bazë të së drejtës vendore dhe ndërkombëtare. Këtë e kërkoi kryetari i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, Naser Selmani, në hapjen e punëtorisë të dedikuar në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve gjatë kohës së ngjarjeve kritike, në organizim të SHGM-së, MPB-së, me përkrahje të OSBE-së. Selmani theksoi se trajnimet për siguri të gazetarëve për ngjarje me rrezik të lartë janë synim i përbashkët i OBS-s, SHGM-së dhe MPB-së me

PUNËTORI PËR SIGURIMIN E GAZETARËVE NË PROTESTA

POLICIA TË MËSOJË SE GAZETARËT NUK JANË ARMIQ



qëllim që të ndërtohen mekanizma institucionalë për krijimin e ambientit më të sigurt për punën e gazetarisë. Selmani shprehu siguri se gjendja me mediat në Maqedoni dukshëm do të përmirësohet nëse i jepet fund politikës së mos dënimit të sulmeve ndaj gazetarëve. Punëtorija është pjesë e përpjekjeve për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet gazetarëve dhe policisë, pasi MPB dhe SHGM

në dhjetor të vitit të kaluar në shkruan memorandum për bashkëpunim. Në punëtorinë udhëheqësit e sektorëve për punë të brendshme së bashku me gazetarët hollësisht i analizojnë problemet me qëllim që të përmirësohet komunikimi ndërmjet tyre dhe në të ardhmen secili në sferën e tij të veprimit të japë kontribut për demokratizim të shoqërisë. Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, thek-

soi se primare për çdo shoqëri demokratike është puna e pandarë e mediave. Nga 1 qershori i vitit 2017 e deri më tani janë regjistruar 12 raste në të cilat është përkeqësuar siguria e gazetarëve dhe të gjitha këto 12 raste janë zbardhur nga ana e MPB-së. Dhuna ndaj gazetarëve përmban më shumë aspekte, theksoi u.d. ambasadori i OSBE-së, Xhef Goldstajn në hapjen e ngjarjes. Ai sqaroi se dhuna ndaj gazetarëve

nuk janë vetëm sulme verbale dhe fizike, por edhe paraburgime joligjore, shkatërrim i pronës, bastisje arbitrare në redaksitë ose në shtëpitë e gazetarëve, gjuhës së urrejtjes, sulme në rrjete sociale dhe kërcënime për sulme seksuale ndaj grave gazetare. Misioni i OSBE-së, siç theksoi Goldstajn, nga viti i kaluar ka filluar përsëri me aktivitete në sferën e lirisë së mediave, me fokus të sigurisë së gazetarëve, për shkak se vlerësojnë se qeveria e re do të jetë e gatshme të bashkëpunojë me shoqatat e gazetarëve dhe organizatat ndërkombëtare për përmirësimin e situatës. Dy punëtoritë e fundit sot dhe nesër realizohen në Shkup, ndërsa më parë punëtoritë të tilla kishte në Ohër, Kumanovë, Shtip, Strumicë dhe Tetovë. Trajnimet, mes të tjerash, kanë për qëllim t'i njoftojnë përfaqësuesit e policisë për rëndësinë e rolit të gazetarëve për informim të qytetarëve për ngjarje me rrezik të lartë, siç janë protestat. (Z.V)



NPVK "Komunalec - Polin"
Marshall Tito pn 1487 Dojran i Vjetër
Tel. 034-225-217
E-mail: jkp_polin@t.mk

Në pajtim me nenin 1 paragrafi 2, nenin 2 paragrafi 1 pika 4, pika 8, dhe nenin 67 të Ligjit për shfrytëzim dhe posedim me mjetet në pronësi të shtetit dhe mjetet në pronësi të komunave (Gazeta Zyrtare e RM nr. 78/2015; 106/2015; 153/2015; 190/2016 dhe 21/2018) ndërsa në lidhje me nenin 4 të Vendimit për heqje dorë nga përdorimi i përkohshëm i mjeteve të tundshme të NPVK Komunalec - Polin Dojran i Vjetër nr. 08-605/5 të datës 22.05.2018 të sjellë nga ana e Këshillit të Komunës së Dojranit si dhe në pajtim me nenin 2, 3, 14 dhe nenin 370-602 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 18/2001, 4/2002, 5/2003, 84/2008, 81/2009, 161/2009 dhe 123/2013) Komisioni për realizim të procedurës për ndarje të marrëveshjes për dhënie me qira të mjeteve të tundshme të formuar nga u.d Drejtori i ndërmarrjes në vijim publikon:

THIRRJE PUBLIKE

Për grumbullim të fletëparaqitjes me shkrim në lidhje me procedurën për ndarje të marrëveshjes për dhënie me qira të mjeteve të tundshme – pajisje për plazhin Karaç

Me vendim për heqje dorë të përdorimit të përkohshëm të mjeteve të tundshme të NPVK "Komunalec-Polin" Dojran i Vjetër nr. 08 - 605/5 të datës 22.05.2018 të sjellë nga Këshilli i Komunës së Dojranit, NPVK "Komunalec - Polin" Dojran i Vjetër i kanë mbetur në shfrytëzim mjetet e tundshme në vijim:

Plazhi "KARAÇ"

Nr. r	Plazhi dhe pajisja urbane	sasia
1	Shezllone plastike për plazh	95
2	Çadra për plazh nga pëlhura	6
3	Kabina druri për zhveshje 25x130x230	2
4	Kullë druri për shpëtimtarët	1
5	Dush për plazh (2x2)	1
Nr. r	Pajisje sanitare	sasia
1	WC guacë me kazan të ulët montues me tërë pajisjen e nevojshme nga qeramika 45 cm/ 35 cm/ 55 cm	8
2	Pisoare nga qeramika 21cm/35cm/60 cm	3
3	Set lavamani nga qeramika	10
4	Mbajtës metalike për rroll letër higjienike	5
5	Mbajtës metalik për peshqir	2
6	Mbajtës plastike për sapun	8
7	Tharës elektrik për duar marka Jofel	2
8	Pasqyrë 60x40cm	2
9	Pasqyrë 200x60cm	2
Nr. r	Pajisje në punktin e servisimit	sasia
1	Shportë metalike për mbeturina me kapak	9
2	Ulëse nga druri 190 cm/90 cm/ 90cm	5
3	Shatërvan për pirje uji nga jashtë të punuar nga druri, ve çezme	1
4	Bojlerë të ulët montues prej 10 litra marka Tesy	1
5	Lavaman nga shpërpallaka me shtrydhës dhe bateri përzierëse me krahë 382cm/60cm/85cm	2
6	Pult i ftohtë metalik për pije me kompresor marka Mrako i cili përbëhet nga: Banak metalik me gjatësi 190 cm	2
7	Frigorifer për pije me dyer nga qelqi marka LTH 2 x 60cm/ 60 cm/ 180 cm	2

1. **LËNDË** e kësaj thirrje publike është ndarja e marrëveshjes për dhënie me qira të mjeteve të tundshme të theksuara taksativisht më lartë të personave të tretë – subjekte juridike me kompensim për periudhë prej 3 (tre) vjet duke konsideruar nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes për qira me ofertuesin më të volitshëm. Dhënia me qira veç e veç të mjeteve të tundshme të veçanta nuk është paraparë. **Trualli ku janë të vendosura mjetet e tundshme është pronë e Republikës së Maqedonisë dhe në të njëjtën nuk do të përcaktohen të drejta të mjeteve.**

2. **TË DREJTË PËR Pjesëmarrje** kanë të gjitha subjektet e interesuara juridike të cilat në momentin e parashtrimit të fletëparaqitjes do të parashtrorjnë dëshmi se janë subjekt i regjistruar juridik në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë. Pjesëmarrësit e interesuar mund të marrin pjesë vetëm me një fletëparaqitje të vetme. Fletëparaqitje grupore të parashtruar nga më shumë pjesëmarrës së bashku nuk pranohet.

VËREJTJE: Parashihet vizitë të lokacionit për shkak të informimit të ofertuesve të interesuar më datë 18.06.2018 në periudhë nga ora 08,00-11,00.

3. **DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR Pjesëmarrje:** Për pjesëmarrje në procedurë për grumbullim e fletëparaqitjeve pjesëmarrësit e interesuar nevojiten të parashtrorjnë dokumentacionin në vijim:

1. Fletëparaqitje me shkrim të certifikuar, të vërtetuar dhe nënshkruar nga personi i autorizuar i subjektit në pajtim me kushtet e parapara në thirrjen publike në të cilën do të theksohen të dhënat themelore – të përgjithshme për subjektin (Emri i saktë i subjektit, selia, drejtuesi, NVT, NVPS, e-mail adresa etj), deklaratë se pajtohen me kushtet e theksuara në thirrjen publike dhe vërtetim se i përbushin kushtet e kërkuara në thirrjen publike.

2. Vërtetim për veprimtari të regjistruar – DRD formular të dhënë nga Regjistrin qendror i Republikës së Maqedonisë.

3. Dëshmi për të ardhura të realizuara prej së paku 3.000.000,00 denarë për vitin e fundit 2017.

4. Vërtetim se nuk është iniciuar procedurë falimentimi/likuidimi.

5. Vërtetim se subjekti nuk ka ndalesë për kryerje të veprimtarisë.

Të njëjtat duhet t'i parashtrorjnë në zarf të mbyllur me shenjë "MOS HAP" dhe shenjë për thirrjen publike konkrete. Fletëparaqitjet të parashtrohen në arkivin e ndërmarrjes në rr. "Marshall Tito" pn, 1487 Dojran i Vjetër.

4. **SHPLLJA** do të zgjasë 5 ditë, duke filluar nga 13.06.2018 deri më 17.06.2018 deri në ora 12:00, ky është edhe afati i caktuar për parashtrimin e fletëparaqitjes.

VËREJTJE: Pasi që data 17.06.2018 i bie e diel, afati shtyhet për ditën e parë të ardhshme të punës, gjegjësisht të hënën 18.06.2018 deri në ora 12:00. Secila fletëparaqitje e pranuar në arkiv pas kalimit të afatit nuk do të merret parasysh dhe e njëjta do t'i kthehet mbrapa ofertuesit. Gjithashtu edhe fletëparaqitjet të cilat nuk do të jenë të kompletuara me dokumentacionin e lartpërmendur nuk do të mund të marrin pjesë në ankandin publik.

5. **ANKANDI PUBLIK** do të mbahet më datë 18.06.2018 në ora 13:30 në Ndërtësen administrative të NPVK "Komunalec - Polin" Dojran i Vjetër (Salla e takimeve).

Personat – përfaqësues të subjekteve juridike – parashtrues të fletëparaqitjes që do të marrin pjesë në ankandin publik është e nevojshme që deri te komisioni që parashtron procedurën të parashtrorjnë autorizim të dhënë nga personi i autorizuar të subjektit juridik që e përfaqësojnë.

6. **ÇMIMI FILLESTAR** – Çmimi i caktuar minimal (çmimi fillestar) i qirasë mujore është 12.000,00 denarë.

7. **OFERTUESI MË I VOLITSHËM** do të konsiderohet ai pjesëmarrës i cili në procedurën për ankand publik ka parashtruar çmimin e fundit të qirasë që paraqet çmimin më të lartë të qirasë.

8. **DEPOZITA:** Pjesëmarrësit e interesuar obligohen të paguajnë depozitë në shumë prej 10% të çmimit fillestar si garanci për seriozitet të ofertave.

Pagesa të bëhet në emrin: NPVK "Komunalec - Polin" Dojran i Vjetër, xh-logaria: 200 00003177906; d-nent Stopanska Banka SHA Shkup.

Ofertuesi i cili do të zgjidhet si më i volitshëm obligohet para lidhjes së Marrëveshjes për qira të parashtrorjë garanci bankare për realizim kualitativ me validitet të kohëzgjatës së marrëveshjes ndërsa në shumë prej 250.000,00 denarë.

9. **PROCEDURA:** Procedura fillon me publikimin e thirrjes konkrete publike.

Pjesëmarrësit e interesuar duhet të parashtrorjnë fletëparaqitje me shkrim së bashku me dokumentacionin e lartpërmendur dërgues në afatin e caktuar më lartë si datë përfundimtare dhe kanë mundësi nëse i përbushin kushtet të marrin pjesë në ankandin publik.

Ankandi publik fillon me publikimin e çmimit fillestar të qirasë mujore dhe realizohet përmes licitacionit nga ana e kandidatëve-pjesëmarrësve të paraqitur.

Ankandi publik do të mbahet edhe në qoftë se në bazë të shpalljes paraqitet vetëm një pjesëmarrës i cili përbushë kushtet nga thirrja dhe ofron çmimin fillestar.

Licitacioni minimal mbi vlerën e qirasë mujore është 10 % nga çmimi fillestar i qirasë mujore ose në vlerë prej 1.200,00.

Ankandi do të zgjasë 15 minuta nga fillimi. Nëse para kalimit të 2 (dy) minutave të fundit të kohës së caktuar dhe të kohëzgjatës së ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve jepet ofertë, atëherë afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdon edhe për 2 (dy) minuta dhe do të përfundojë kur për kohë prej 2 (dy) minutave të ardhshme nuk do të jepet ofertë e re. Ankandi publik vazhdon pakufi derisa në intervalin kohor prej 2 (dy) minutave jepet ofertë e re.

Për ofertues më të volitshëm konsiderohet pjesëmarrësi në ankandin publik i cili ka ofruar çmimin e fundit për qira që paraqet çmimin më të lartë të qirasë. Pas përfundimit të ankandit publik komisioni përpilon procesverbal për ankandin e realizuar publik me propozim vendim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm dhe të njëjtin e parashtron deri te drejtori i ndërmarrjes. Drejtori sjellë vendim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm dhe me të njëjtin do të lidhë marrëveshje për qira me të cilin në mënyrë precize do të rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella me qiradhenësit dhe qiramarrësit.

Pjesëmarrësit kanë të drejtë për apel në lidhje me procedurën e ankandit publik në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik deri te komisioni që vendosë në bazë të apelit me vendim në afat prej 5 (pesë) ditëve nga pranimi i apelit.

NPVK "Komunalec - Polin" Dojran i Vjetër

Komisioni për realizim të procedurës për ndarje të marrëveshjes për dhënie me qira të mjeteve të tundshme



NPVK "Komunalec - Polin"
Marshall Tito pn 1487 Dojran i Vjetër
Tel. 034-225-217
E-mail: jkp_polin@t.mk

Në pajtim me nenin 1 paragrafi 2, nenin 2 paragrafi 1 pika 4, pika 8, dhe nenin 67 të Ligjit për shfrytëzim dhe posedim me mjetet në pronësi të shtetit dhe mjetet në pronësi të komunave (Gazeta Zyrtare e RM nr. 78/2015; 106/2015; 153/2015; 190/2016 dhe 21/2018) ndërsa në lidhje me nenin 4 të Vendimit për heqje dorë nga përdorimi i përkohshëm i mjeteve të tundshme të NPVK Komunalec - Polin Dojran i Vjetër nr. 08-605/5 të datës 22.05.2018 të sjellë nga ana e Këshillit të Komunës së Dojranit si dhe në pajtim me nenin 2, 3, 14 dhe nenin 370-602 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 18/2001, 4/2002, 5/2003, 84/2008, 81/2009, 161/2009 dhe 123/2013) Komisioni për realizim të procedurës për ndarje të marrëveshjes për dhënie me qira të mjeteve të tundshme të formuar nga u.d Drejtori i ndërmarrjes në vijim publikon:

THIRRJE PUBLIKE

Për grumbullim të fletëparaqitjes me shkrim në lidhje me procedurën për ndarje të marrëveshjes për dhënie me qira të mjeteve të tundshme – pajisje për plazhin Nikoliç

Me vendim për heqje dorë të përdorimit të përkohshëm të mjeteve të tundshme të NPVK "Komunalec-Polin" Dojran i Vjetër nr. 08 - 605/5 të datës 22.05.2018 të sjellë nga Këshilli i Komunës së Dojranit, NPVK "Komunalec - Polin" Dojran i Vjetër i kanë mbetur në shfrytëzim mjetet e tundshme në vijim:

Plazhi "NIKOLIÇ"

Nr. r	Plazhi dhe pajisja urbane	sasia
1	Kolovajzë e njëfishtë	1
2	Kolovajzë e dyfishtë	1
3	Kolovajzë e trefishtë	1
4	Luhatëse e dyfishtë	1
5	Tobogan i vogël	1
6	Tobogan i mesëm	1
7	Tobogan i madh me konstruksion m.	1
8	Majmunëse	1
9	Tarzane	1
10	Karrosel	1
11	Kullë, luhatëse kolovajzë e njëfishtë	1
12	Kalë	1
13	Elefant	1
14	Tobogan spirale	1
15	Ulëse	20
16	Shportë për mbeturina	20
17	Shazllone	300
18	Çadra për diell	150
19	Platformë për shpëtimtarët	2
20	Kabina për zhveshje	4
21	Dush	4
22	Tavolina të plastikës	150
23	Pajisje për fusha sporti	4

1. **LËNDË** e kësaj thirrje publike është ndarja e marrëveshjes për dhënie me qira të mjeteve të tundshme të theksuara taksativisht më lartë të personave të tretë – subjekte juridike me kompensim për periudhë prej 3 (tre) vjet duke konsideruar nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes për qira me ofertuesin më të volitshëm. Dhënia me qira veç e veç të mjeteve të tundshme të veçanta nuk është paraparë. **Trualli ku janë të vendosura mjetet e tundshme është pronë e Republikës së Maqedonisë dhe në të njëjtën nuk do të përcaktohen të drejta të mjeteve.**

2. **TË DREJTË PËR Pjesëmarrje** kanë të gjitha subjektet e interesuara juridike të cilat në momentin e parashtrimit të fletëparaqitjes do të parashtrorjnë dëshmi se janë subjekt i regjistruar juridik në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë. Pjesëmarrësit e interesuar mund të marrin pjesë vetëm me një fletëparaqitje të vetme. Fletëparaqitje grupore të parashtruar nga më shumë pjesëmarrës së bashku nuk pranohet.

Pjesëmarrësit e interesuar mund të marrin pjesë vetëm me një fletëparaqitje të vetme. Fletëparaqitje grupore të parashtruar nga më shumë pjesëmarrës së bashku nuk pranohet.

VËREJTJE: Parashihet vizitë të lokacionit për shkak të informimit të ofertuesve të interesuar më datë 18.06.2018 në periudhë nga ora 08,00-11,00.

3. **DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR Pjesëmarrje:** Për pjesëmarrje në procedurë për grumbullim e fletëparaqitjeve pjesëmarrësit e interesuar nevojiten të parashtrorjnë dokumentacionin në vijim:

1. Fletëparaqitje me shkrim të certifikuar, të vërtetuar dhe nënshkruar nga personi i autorizuar i subjektit në pajtim me kushtet e parapara në thirrjen publike në të cilën do të theksohen të dhënat themelore – të përgjithshme për subjektin (Emri i saktë i subjektit, selia, drejtuesi, NVT, NVPS, e-mail adresa etj), deklaratë se pajtohen me kushtet e theksuara në thirrjen publike dhe vërtetim se i përbushin kushtet e kërkuara në thirrjen publike.

2. Vërtetim për veprimtari të regjistruar – DRD formular të dhënë nga Regjistrin qendror i Republikës së Maqedonisë.

3. Dëshmi për të ardhura të realizuara prej së paku 1.500.000,00 denarë për vitin e fundit 2017.

4. Vërtetim se nuk është iniciuar procedurë falimentimi/likuidimi.

5. Vërtetim se subjekti nuk ka ndalesë për kryerje të veprimtarisë.

Të njëjtat duhet t'i parashtrorjnë në zarf të mbyllur me shenjë "MOS HAP" dhe shenjë për thirrjen publike konkrete. Fletëparaqitjet të parashtrohen në arkivin e ndërmarrjes në rr. "Marshall Tito" pn, 1487 Dojran i Vjetër.

4. **SHPLLJA** do të zgjasë 5 ditë, duke filluar nga 13.06.2018 deri më 17.06.2018 deri në ora 12:00, ky është edhe afati i caktuar për parashtrimin e fletëparaqitjes.

VËREJTJE: Pasi që data 17.06.2018 i bie e diel, afati shtyhet për ditën e parë të ardhshme të punës, gjegjësisht të hënën 18.06.2018 deri në ora 12:00. Secila fletëparaqitje e pranuar në arkiv pas kalimit të afatit nuk do të merret parasysh dhe e njëjta do t'i kthehet mbrapa ofertuesit. Gjithashtu edhe fletëparaqitjet të cilat nuk do të jenë të kompletuara me dokumentacionin e lartpërmendur nuk do të mund të marrin pjesë në ankandin publik.

5. **ANKANDI PUBLIK** do të mbahet më datë 18.06.2018 në ora 12:30 në Ndërtësen administrative të NPVK "Komunalec - Polin" Dojran i Vjetër (Salla e takimeve).

Personat – përfaqësues të subjekteve juridike – parashtrues të fletëparaqitjes që do të marrin pjesë në ankandin publik është e nevojshme që deri te komisioni që parashtron procedurën të parashtrorjnë autorizim të dhënë nga personi i autorizuar të subjektit juridik që e përfaqësojnë.

6. **ÇMIMI FILLESTAR** – Çmimi i caktuar minimal (çmimi fillestar) i qirasë mujore është 6.000,00 denarë.

7. **OFERTUESI MË I VOLITSHËM** do të konsiderohet ai pjesëmarrës i cili në procedurën për ankand publik ka parashtruar çmimin e fundit të qirasë që paraqet çmimin më të lartë të qirasë.

8. **DEPOZITA:** Pjesëmarrësit e interesuar obligohen të paguajnë depozitë në shumë prej 10% të çmimit fillestar si garanci për seriozitet të ofertave.

Pagesa të bëhet në emrin: NPVK "Komunalec - Polin" Dojran i Vjetër, xh-logaria: 200 00003177906; d-nent Stopanska Banka SHA Shkup.

Ofertuesi i cili do të zgjidhet si më i volitshëm obligohet para lidhjes së Marrëveshjes për qira të parashtrorjë garanci bankare për realizim kualitativ me validitet të kohëzgjatës së marrëveshjes ndërsa në shumë prej 125.000,00 denarë.

9. **PROCEDURA:** Procedura fillon me publikimin e thirrjes konkrete publike.

Pjesëmarrësit e interesuar duhet të parashtrorjnë fletëparaqitje me shkrim së bashku me dokumentacionin e lartpërmendur dërgues në afatin e caktuar më lartë si datë përfundimtare dhe kanë mundësi nëse i përbushin kushtet të marrin pjesë në ankandin publik.

Ankandi publik fillon me publikimin e çmimit fillestar të qirasë mujore dhe realizohet përmes licitacionit nga ana e kandidatëve-pjesëmarrësve të paraqitur.

Ankandi publik do të mbahet edhe në qoftë se në bazë të shpalljes paraqitet vetëm një pjesëmarrës i cili përbushë kushtet nga thirrja dhe ofron çmimin fillestar.

Licitacioni minimal mbi vlerën e qirasë mujore është 10 % nga çmimi fillestar i qirasë mujore ose në vlerë prej 600,00.

Ankandi do të zgjasë 15 minuta nga fillimi. Nëse para kalimit të 2 (dy) minutave të fundit të kohës së caktuar dhe të kohëzgjatës së ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve jepet ofertë, atëherë afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdon edhe për 2 (dy) minuta dhe do të përfundojë kur për kohë prej 2 (dy) minutave të ardhshme nuk do të jepet ofertë e re. Ankandi publik vazhdon pakufi derisa në intervalin kohor prej 2 (dy) minutave jepet ofertë e re.

Për ofertues më të volitshëm konsiderohet pjesëmarrësi në ankandin publik i cili ka ofruar çmimin e fundit për qira që paraqet çmimin më të lartë të qirasë.

Pas përfundimit të ankandit publik komisioni përpilon procesverbal për ankandin e realizuar publik me propozim vendim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm dhe të njëjtin e parashtron deri te drejtori i ndërmarrjes. Drejtori sjellë vendim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm dhe me të njëjtin do të lidhë marrëveshje për qira me të cilin në mënyrë precize do të rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella me qiradhenësit dhe qiramarrësit.

Pjesëmarrësit kanë të drejtë për apel në lidhje me procedurën e ankandit publik në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik deri te komisioni që vendosë në bazë të apelit me vendim në afat prej 5 (pesë) ditëve nga pranimi i apelit.

NPVK "Komunalec - Polin" Dojran i Vjetër

Komisioni për realizim të procedurës për ndarje të marrëveshjes për dhënie me qira të mjeteve të tundshme

VJEDHJE SI NË FILMA, AUTORËT NUK ZBULOHEN



ASNJË GJURMË E HAJNAVE TË TETOVË

Nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë thonë se gjatë ditëve të kaluara janë marrë masa për zbardhjen e dy rasteve, ku krahas bastisjeve - po ashtu janë kontrolluar edhe rrugët në qytetin e Tetovës

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 12 qershor - Gati se pesë ditë, policia e Tetovës ende është në kërkim të personave të dyshuar për dy plaçkitjet si në filma të marketeve dhe veturës së kompanisë të sigurimit që transportonte paratë nga marketi Kipper. Nga policia e Tetovës thonë shkurt se po punohet në identifikimin e autorëve të dy vjedhjeve, por asgjë konkrete nuk ka.

"Janë marrë masa dhe aktivitete për identifikimin dhe ndalimin e autorëve të këtyre dy vjedhjeve dhe në momentet kur do të ketë diçka të re, do t'ju njoftojmë me shkrim", tha Fatmir Rexhepi, zëdhënës i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë. Sipas informacioneve zyrtare, policia deri më tani ka bastisur nëpër disa shtëpi

ku ka patur edhe të dyshuar në lidhje me këtë rast, por nuk ka grumbulluar dëshmi të mjaftueshme për të arrestuar ndonjë person që është implikuar në dy vjedhjet. Sipas burimeve jozyrtare, policia ka humbur gjurmët edhe në vjedhjen e dytë, pasi që hajnat kanë shkyçur telefonat që kishin vjedhur në market. Ende nuk dihet nëse ka patur kamera të sigurisë të vendosura që do të mund të çonin në kapjen e hajnave.

Përndryshe, policia e Tetovës është vënë në kërkim të personit i cili mëngjesin së premtes së kaluar, me pushkë automatike ka grabitur veturën me të cilën ishin marrë paratë në supermaketin Kiper në lagjen 109 në Tetovë. "Ngjarja ka ndodhur rreth orës 9 e 45 minuta, kur një i punësuar i një Agjencie për Sigurim ka hyrë brenda në market, ndërsa një tjetër ka qëndruar jashtë në veturën Fiat Dablllo. Në ndërkohë, në vendngjarje ka arritur një person i panjohur me skuter dhe me pushkë automatike ka goditur personin në veturë, e ka tërhequr dhe e ka nxjerrë jashtë, kurse vet me veturën është larguar nga vendi i ngjarjes. Më pas, vetura është gjetur në rrugën Industriale në afërsi të një pompe të benzinës. Në ndërkohë, personi i panjohur është larguar në drejtim të panjohur", thotë Fatmir Rexhepi, zëdhënës i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë.

As për këtë vjedhje nuk është arrestuar asnjë person i cili në mesditë dhe në mes qytetit ka arritur që të kryejë plaçkitje. Dhe, përderisa policia është duke e kërkuar hajnin e plaçkitjes së të premtes së kaluar, një vjedhje tjetër e rëndë si nëpër filma ka ndodhur në Tetovë në një market në rrugën "Vidoe Smilovski Bato", nga dy persona të maskuar, të shtunën mbrëma. Sipas policisë, rreth orës 21.10 minuta, në Sektorin për Punë të Brendshme në Tetovë personi I.S 32 vjeçar nga Tetova, i punësuar në një market në rrugën Industriale, ka denoncuar se dy persona të panjohur, duke e kërcënuar me pistoletë, kanë kryer plaçkitje, me ç'rast kanë marrë 32.146 denarë, ndërsa nga denoncuesi kanë marrë një telefon celularë, kurse nga tre persona të tjerë që kanë qenë në market, pas kryerjes së kontrollit - kanë marrë 2200 denarë, dhe dy telefona celularë dhe e kanë lëshuar vendin e ngjarjes. Nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë thonë se gjatë ditëve të kaluara janë marrë masa për zbardhjen e dy rasteve, ku krahas bastisjeve, po ashtu janë kontrolluar edhe rrugët në qytetin e Tetovës. Nuk dihet nëse policia do të kërkojë nga gjykata të marrë xhirimet e sigurisë nëpër rrethrutullimet kryesore të qytetit, të cilët mund edhe të ndihmonin në identifikimin e autorëve të vjedhjeve spektakolare në Tetovë.

Zbatim i zbehtë i Ligjit për qasje në informacionet publike

Tetovë, 12 qershor - Dyzet e dy për qind e kërkesave për informacione me karakter publik vitin e kaluar janë dorëzuar deri tek qytetarët nga institucionet kompetente. Kjo tregon se edhe pse ka më shumë zgjidhje të mira në Ligjin për qasje në informacionet me karakter publik këto rregulla kanë zbatim të dobët në praktikën në Maqedoni. Ky është konstatimi i debatit të sotëm të realizuar në Universitetin e Evropës Juglindore dedikuar për studentë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare qëllimi i së cilave ishte të njoftohen me atë se si mund të vijjnë drejt informacioneve me karakter publik që të kemi institucione transparente dhe përgjegjëse. Sipas profesorit universitar Sefer Tahiri për qindja e vogël e përgjigjeve të marra nga institucionet duhet të rritet me tejkalimin e barrierave kulturologjike dhe psikologjike nga qytetarët dhe interesimit të tyre për institucione të hapura. "Të gjithë qytetarët veçanërisht studentët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare duhet më shumë të angazhohen dhe ta realizojnë të drejtën e tyre dhe të dinë se si të punojnë institucionet të cilat financohen prej parave të tyre. Gjithashtu edhe drejtuesit e institucioneve shtetërore, ministrat, drejtorët dhe ngjashëm duhet ta kuptojnë se duhet t'i informojnë qytetarët e interesuar për të gjitha informacionet me karakter publik dhe më pak ta përdorin të drejtën e tyre diskrete diçka e panevojshme që të fshihet nën formulimin sekret shtetëror apo informacione të besueshme. Nëse institucionet shtetërore bëhen më të hapura dhe më përgjegjëse lidhur me pyetjet e qytetarëve rreth punës së tyre kjo do ta ngritë rolin e tyre dhe funksionin në interes publik që do të thotë edhe zhvillim i demokracisë dhe proceseve demokratike", tha Tahiri. Debatin e djeshëm në UEJL e organizoi organizata joqeveritare Asociacioni për nisma demokratike nga Gostivari përmes programit Civika Mobilitas.

Deri në fund të javës deri në 36 gradë celsius

Shkup, 12 qershor - Deri në fund të ditës do të mbajë mot i ngrohtë me temperaturë deri në 36 gradë celsius, ndërsa pasdite dhe nesër pritet jostabilitet me shi të rrëmbyeshëm lokal dhe vetëtim. Jostabiliteti fillimisht do të jetë në pjesët perëndimore ndërsa më pas kryesisht përmes pjesëve veriore do të zhvendoset drejt atyre lindore.

Reshjet përkohësisht do të jenë të rrëmbyeshme dhe të shoqëruara me vetëtim vendende me erë të përforcuar dhe kushte për paraqitjen e breshrit.

Ditëve në vijim moti do të jetë me vranësi të ndryshueshme dhe jostabil, në nivel lokal proceset do të jenë edhe në formë të motit të keq. Të premtën pritet reshjet të jenë më të rrëmbyeshme.

Temperaturat e ditës do të bien gradualisht. Temperatura e mëngjesit do të lëvizë prej 13 deri në 20 gradë celsius, ndërsa e ditës prej 23 deri në 36 gradë celsius.

ASH ME AKUZA NË ADRESË TË NUHIUT DHE BDI-së

Të diskriminuar në mes të Tetovës

Tetovë, 12 qershor - Aleanca për Shqiptarët ka akuzuar zëvendësministrin e Punëve të Brendshme, Agim Nuhiun dhe BDI-në. Sipas partisë së Selës, diskriminimi më i madh shqiptarëve u bëhet në policinë e Tetovës, ku edhe pse shqiptarët janë shumicë, megjithatë përfaqësimi është i ulët. "Kryeshefi - shqiptar, zëvendësi - maqedonas, kryeshefi i uniformës policore - maqedonas, zëvendësi maqedonas, komisarati i lartë për komunikacion - maqedonas, komisarati për rendin dhe qetësinë publike - maqedonas, komisarati i përbërjes rezerve dhe menaxhimit me krizat - maqedonas, komisarati për preventivë - shqiptar, këshilltari për menaxhim - shqiptarë, këshilltari për trajnime dhe aktivitete - maqedonas, kryeshefi i krim policisë - shqiptar (ushtrues detyre pa vendim), zëvendëskryeshefi - maqedonas, kryeshefi

për analitik është maqedonas, komandant i SPB në Tetovë - shqiptarë me dy zëvendës maqedonas, Qendra për informim dhe koordinim - udhëheqësi maqedonas me 3 shefa ndërrimi maqedonas dhe 1 shqiptar. Komandant i policisë rrugore është maqedonas, ndërsa zëvendësi shqiptar. Kontrolli i Brendshëm udhëhiqet nga maqedonas, Financat gjithashtu, nga është maqedonas. Edhe Burimet njerëzore nga maqedonas, sikurse Divizioni i armëve, Krim teknika, Stacioni në Kodrën e Diellit dhe Stacioni në Jazhincë. Sektori për kundërvajtje udhëhiqet nga një shqiptar dhe një maqedonas...", tha Altrim Mamuti, kryetar i Degës së ASH-së në Tetovë. Nga ASH kanë ftuar publikisht të përgjigjet dhe të mbajë përgjegjësi zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Agim Nuhiu së bashku me subjektin e tij



politik për diskriminimin politik që ju bëhen kuadrove shqiptarë vetëm për përkatësinë e tyre etnike, "edhe pse jetojmë në një regjion me shumicë absolute shqiptare". (U.H)

Ura e Ibrit mbi Bosfor

Nga
Fadil LEPAJA



Ura e Ibrit dhe ajo mbi Bosfor nuk kanë të krahasuar, përpos në nivel metafore. Në gusht të vitit 2016, Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan e kishte përruar urën e tretë mbi Bosfor, e cila është e gjatë 1.4 kilometra dhe e gjerë 59 metra, dhe mban emrin e njërit nga sulltanët e famshëm, osman, "Yavuz Sultan Selim". Është kjo ura më e re dhe më e madhe nga tri urat, që lidhin Turqinë evropiane me atë aziatike.

Thuhet se Sulltan Selimi, i parë, i cili sundoi në fillim të shekullit të XVI, dhe u bë i famshëm për pushtimin e Sirisë, Irakut Verior, Palestinës dhe vet Egjiptit, kur u kthye në Stamboll nga ekspedita e tij e famshme, hyri në pallatin e tij natën, i përcjellë vetëm nga një grup besnikësh, dhe mbi një barkë. Sulltani modest, po ikte nga festa në nder të tij. Ofensiva ekonomike turke, ishte impulsive sidomos në fillim të shekullit XXI. Bruto prodhimi nacional u shumëfishua, dhe bashkëpunimi me vendet e rajonit filloi të lulëzojë, sidomos me formulën që e plasonte ish kryeministri dhe ministri i jashtëm, i njohur edhe si ideolog i neo osmanizmit, Ahmet Davutoglu i cili promovonte paqe me të gjithë fqinjët, dhe hapje ndaj të gjithëve, "zero armiqësi me fqinjët" thoshte ai.

Deklaratat provokuese në Prishtinë, Sarajevë e gjetiu, për kulturën dhe historinë e përbashkët dhe rolin çlirimtar të sulltanëve, tregonin rrugën e shtruar kulturore, dhe politike drejt Sarajevës dhe viseve shqiptare, dhe kjo shumë shpejt filloi të shoqërohej me projekte tjera infrastrukturore që e thellonin bashkëpunimin dhe komunikimin me popujt dhe vendet të cilat dikur ishin pjesë e perandorisë osmane, me shekuj të tërë. Klasa politike në Sarajevë, Tiranë, Prishtinë dhe Shkup ra shumë shpejtë nën ndikimin e kësaj energjie të re, që po shpërthente nga bumi ekonomik turk, dhe për shkak të rolit të rëndësishëm të Turqisë në NATO, çka e bënte atë ndërmjetëse të besueshme në (mos)marrëveshjet mes popujve të Ballkanit, sidomos rreth Bosnjës dhe Kosovës.

Urat dhe krejt infrastruktura e ngritur për të lidhur kontinentet, për të lidhur Ballkanin me Turqinë, sidomos autostradat dhe mega projektet i madh turk i gazit, që synonte të zëvendësojë trasën bullgare dhe rumune të projektit rus

Gjithsesi, për një vend që gjithnjë e më tepër po mbyllet në barrikada, dhe i cili prej formulës "zero armiqësi me fqinjët" po e bënë të kundërtën, mund të pritet të jetë edhe nxitës i spekulimeve të llojllojshme, por ndalja e rritës ekonomike turke duket se ka shqetësuar shumë kë

"Rrjedha jugore", u bënë simbol i frymës së re, i një Turqie që ofronte diçka për të gjithë. Ballkani u mbush me shkolla turke, u rinovuan gati të gjitha Xhamiat nga epoka e lavdishtme e perandorisë, sidomos në Kosovë, Shqipëri, Bosnje, Sanxhak, Maqedoni, dhe krejt kjo pastaj rezultoi me blerjen apo marrjen me koncesion të infrastrukturës ajrore, energjetike, telekomunikimit, bankat etj. Por modestia sot nuk është në modë. As urat nuk kanë karakter veç ekonomik. Se sa simbolika e urave është shndërruar në ideologji, viteve të fundit, mund të shihet edhe nga emrat e tyre. Ura e parë mbi Bosfor, e përruar më 1973, në

vitin 2016 e mori emrin e ri, "Ura e martirëve", në përkujtim të vrarëve në puqin e dështuar, kundër presidentit aktual turk, Erdogan.

Presidenti, ambiciet e të cilit që nga koha e ardhjes në pushtet, duket se ngjajnë shumë me ato të Sulltanit të famshëm Selim, për puqin, e akuzoi armikun e jashtëm dhe atë të brendshëm, madje arrestoi me dhjetëra mijëra kuadro të larta, në të gjitha nivelet dhe segmentet e shtetit, përfshi ushtarak, gjyqtarë, polic, intelektual. Numri i të larguarve nga puna dhe nga vendi nuk dihet saktë. Derisa urat në mes popujve të Ballkanit, ende dergjeshin të pa renovuara ose të bllokuara, sikur ajo në Ibër, të Mitrovicës, fijet e panumërta infrastrukturore, ekonomike, politike, kulturore, të Turqisë, po e qëndrisin hartën e re politike të rajonit. Sa ka simbolikë në ndërrimin e emrit të urës më të vjetër që e lidhë Turqinë me Evropën, ku ajo mori emrin "Ura e martirëve" dhe sa politika e re që pasoi puqin e përgatitur, dhe të dështuar ndaj presidentit Erdogan u dha tjetër karakter urave që lidhin Evropën me Azinë? Pengesat në këto mrekulli të arkitekturës nuk janë fizike, sikur dikur në urën e Ibrit në Mitrovicë, por janë barrikada edhe më të mëdha politike, e madje edhe

ekonomike e kulturore të cilat sapo kanë filluar të shihen me një intensitet të fuqishëm dhe dimension tjetër.

Edhe pse Presidenti Erdogan, kohëve të fundit po shpërndante para, në Serbi dhe Bosnje, po përmenden mega-projekte si rruga Beograd-Sarajevë, duket se dashuria e vjetër Beograd-Ankara, përpos që ka shqetësuar disa kryeqytete në Ballkan, nuk do të mjaftojë që të garantojë ritmin e njëjtë të rritjes ekonomike dhe standardit të qytetarëve. Ajo më tepër përfaqëson rreshtimin anti perëndimor turk, në boshtin e krijuar rreth Sirisë, por edhe gjithë trasës së dëshiruar të gazsjellësit që do të lidhte burimet e naftës në Lindjen e Afërt, me Evropën, e cila pas krizës në Ukrainë, për boshtin ka marrë karakter jetik.


Pyetjet se prej nga i merr Erdogan, paratë që ua premtun Serbisë dhe Bosnjës, në kohën kur shenjat e krizës ekonomike dhe sociale janë bërë më se të dukshme në Turqi, është vështirë të thuhet me siguri, në kohën kur mijëra biznesmenë, milioner, tashmë e kanë lëshuar vendin që nga koha e puqit të dështuar. Shifra prej më se 1500 milionerësh, që kanë ikur nga vendi, siç përmendet në qarqet diplomatike, duket se ka lënë shenja në rritjen

ekonomike. Disa mendojnë se këto para, vijnë nga boshti Moskë-Teheran-Ankara, dhe se janë një formë e mbuluar e investimeve ruse në Serbi dhe Bosnje, duke u ikur kështu sanksioneve ndaj Rusisë, por mund të jenë edhe prekje në rezervat strategjike, për të vazhduar ndërtimin e infrastrukturës, neo-otomane. Gjithsesi, për një vend që gjithnjë e më tepër po mbyllet në barrikada, dhe i cili prej formulës "zero armiqësi me fqinjët" po e bënë të kundërtën, mund të pritet të jetë edhe nxitës i spekulimeve të llojllojshme, por ndalja e rritës ekonomike turke duket se ka shqetësuar shumë kë. Neve dashuri, dhe xhamia, ndërsa Serbisë miliarda investime ekonomike, ankohen boshnjakët dhe shqiptarët në rajon, ndaj "ndihmës" turke. Një pjesë e elitës politike shqiptare, e ndodhur në mes të furtunës që po prodhojnë marrëdhëniet e tendosura të Turqisë me perëndimin, tashmë po këndellet dhe po jep deklarata lojaliteti ndaj perëndimit, vend e pa vend.

Por, jo të gjithë. A do të prodhojë pasoj sociale, ekonomike dhe politike edhe ndër shqiptarët, orientimi i ri gjeopolitik i Turqisë? A ka kapur miti turk, "thellësitë strategjike" ndër shqiptarët?

(gazeta shqip)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribucioni: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 12 qershor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

SHËMBËLLTYRA E PROFETIT MUHAMED (2)

Besa e madhe e Akabesë, vendimtare për Islamin



Nga
Rexhep Torte

Kjo gjendje zgjati tre vite duke shkaktuar vuajtje të mëdha sa që filluan të ushqehen me gjethe por qëndruan të palëkundur dhe nuk e dorëzuan Profetin Muhamed dhe as Profeti nuk hoqi dorë nga ideja e tij për përhapjen e mesazhit dhe se namazi është takim mes rrobotit dhe Zotit. Ndërkohë Allahu shpallte ajetet me të cilat e qetësonte Profetin së bashku me muslimanët e tjerë. Në të njëjtën kohë Allahu i dërgoi shpalljen Profetit se ka dërguar krymbin për ta gëryer dokumentin e bojkotit duke i lënë vetëm fjalët "Në emrin tënd o Zot" kjo mrekulli i detyroi Kurejshët që ta ndërpresin bojkotin.

Profetin armiqtë nuk arritën ta dëshpërojnë dhe as ta frikësojnë. Ai vazhdoi aktivitetin e tij duke udhëtuar për në Taif për të kërkuar ndihmë nga fiset e atjeshme për misionin e tij, por për fat të keq ato fise nuk e ndihmojnë por e ofendojnë dhe e gurëzojnë. Megjithatë ai vazhdoi aktivitetin e tij duke u mbështetur te Zoti. Udhëtimi i Israsë dhe Miraxhit nga Qabja për në Jerusalem për në xhaminë Aksa dhe udhëtimi i tij në 7 palë qiej brenda një nate, ku u takua me Allahun i shoqëruar nga Xhebraili, ishin mrekullitë e radhës. Profeti përhapjen e mesazhit e vazhdoi gjatë mbajtjes së Haxhit në Mekë ku takonte grupe të rinjsh nga Medina të cilët pranojnë Islamin dhe në këtë mënyrë bashkoi 26 fise që luftonin njëri tjetrin duke arritur Besën e madhe të Akabesë që ishte vendimtare në historinë e Islamit. Përmbajtja e kësaj bese ishte që Medinasit ti binden Profetit në të mirë e të keqe të shpenzonin pasuritë e tyre në të mirë e të keqe, të urdhëronin për mirë dhe të ndalonin nga e keqja, të mos frikësoheshin dhe të mos tërhiqeshin në çaste të vështira, ta mbronin nëse Profeti shkonte te ata, ashtu siç i mbronin familjet dhe fëmijët e tyre. Kjo ia hap rrugën Profetit që të shkonte në Medinë si i pari i tyre, të kontribuonin për shtetin Islam që do të formohej. Më vonë për t'ju shmangur vuajtjeve dhe keqtrajttimeve që muslimanët i përjetonin nga Kurejshët, Profeti organizoi migrimin e muslimanëve nga Meka për në Medinë ku themeloi Shtetin e parë Islam dhe nënshkroi Marrëveshjen të Akabesë. Kjo u bë me qëllim për sigurinë e brendshme dhe të jashtme për tu kuptuar se atdheu është i të gjithëve me të drejtat themelore për të gjithë. Megjithatë kjo marrëveshje u prish nga disa fise arabe të cilët e tradhëtuan, duke mos pranuar mesazhin Islam. Profeti hyri në luftë me çifutët për shkak se ata i



shkelën ligjet dhe vlerat e shoqërisë ku jetonin. Në fjalimin e tij në Medinë Profeti Muhamed tha, "Përhapeni paqen, ushqeni ata që kanë nevojë, shkonni mirë me farefisën dhe faluni natën". Në Medinë u ndërtua edhe xhamia për lutje ndaj Zotit dhe për bashkimin e vëllezërimitin e shoqërisë.

Shpërngulja e muslimanëve nga Meka në Medinë u bë në mënyrë të fshehtë dhe i fundit u shpërngul Profeti Muhamed i shoqëruar nga Ebu Bekri. Në Medinë muslimanët u pritën me dashamirësi nga Ensarët, banorët vendas, por jo edhe nga çifutët dhe hipokritët. Në Medinë u themelua edhe shteti i parë Islam.

Profeti Muhamed dëshmoi aftësi administrative, reformim të shoqërisë, energji shpirtërore, marrëdhënie me njerëzit si burrshteti dhe durim në përçarjen e mesazhit hyjnor. Profeti Muhamed u tregua edhe strateg ushtarak, por jo për të sulmuar i pari, por gjithnjë për tu mbrojtur dhe sulmonte vetëm atëherë kur muslimanët ishin të rrezikuar. Në të gjitha betejat që i zhvilloi me Kurejshët, Persët, Romakët apo me shtetet e tjera ai fillimisht dërgonte delegacionet e tij për të negociuar dhe për tu treguar se dëshiron ta përçojë mesazhin hyjnor Islam. Profeti Muhamed u shkruante edhe mbretërve të botës ku i ftonte të pranojnë Islamin. Letra të këtilla i dërgoi Herakliut, mbretit të romakëve, Mukaukisit, mbretit të Egjiptit, Kistras mbretit të Persisë, në të cilat shkruante "Nga Muhamedi, i dërguari i All-llahut. Unë të ftoj të pranosh Islamin dhe të shpëtosh". Popujt e këtyre shteteve jetonin në vuajtje e padrejtësi të mëdha ndërsa paria e këtyre

shteteve jetonte në begati dhe luks të paparë. Vetëm atëherë kur këto shtete nuk binin dakord me propozimin e Profetit Muhamed atëherë Profeti shprehte gatishmërinë për të luftuar. Gjatë luftimeve që zhvilloi Profeti Muhamed i udhëzonte komandantët dhe ushtrinë që të mos vrasin gra, pleq e fëmijë dhe njerëzit që gjendeshin duke u lutur në tempujt e tyre. Ai gjithashtu urdhëronte që të mos prishen të mbjellat bujqësore dhe të mos shkatërrohen shtëpitë. Pjesën më të madhe të robërve të luftës e lironte dhe plaçkën e luftës e ndante në mënyrë të barabartë.

Lufta për të vërtetën dhe përçarjen e fesë Islame, fesë humane dhe të drejtë, bënë që për 25 vite Islami të shkatërrojë imperatoritë më të mëdha të kohës dhe sundoi në pjesën më të madhe të botës. Profeti Muhamed edhe Mekën e Qabën i mori në rrugë paqësore duke negociuar dhe bindur Kurejshët e fiset e tjera se qëllimi i tij i vetëm ishte përhapja e mesazhit hyjnor Islam. Profeti Muhamed edhe para betejave diskutonte me ushtarët për të gjetur rrugën më të mirë drejt fitores. Me Marrëveshjen e Hudejbies pa derdhur gjak u arrit paqja dhe vizita për në Qabe. Profeti Muhamed i udhëhoq gjithnjë nga paqja vendosi që me Kurejshët të arrijë marrëveshje paqësore për Mekën dhe Qabën dhe ti shmanget gjakderdhjes. Kurejshët e kuptuan forcën ushtarake të Profetit Muhamed dhe se edhe mund tua ndalonte rrugën e karvaneve ranë dakord për këtë marrëveshje që muslimanëve të Medinës tu mundësohet ta vizitojnë Qabën në kohën e Haxhit. Kjo marrëveshje ishte fitorja më e madhe në historinë e Islamit. Pas

kësaj marrëveshje një numër i madh fisesh e pranuan fenë Islame. Megjithatë Kurejshët disa herë e shkelën këtë marrëveshje gjë që e detyroi Profetin Muhamed që të përgatitet për luftë kundër Kurejshëve. Fuqia ushtarake e Profetit i tmerroi Kurejshët kështu që ata më në fund u dorëzuan paqësisht dhe duke e pranuar fenë Islame dhe Profetin Muhamed si të dërguarin e tij. Pas kësaj Muslimanët i thyen të gjithë idhujt rreth Qabes, dhe i amnestuan të gjithë kundërshtarët e dorëzuar, duke ua hapur rrugën që ta pranojnë fenë Islame dhe Profetin Muhamed si të dërguarin e Zotit. Profeti Muhamed asnjëherë nuk gënjeu, nuk tradhtoi dhe nuk i prishi marrëveshjet e arritura me armiqtë. Profeti u torturua, u keqtrajtua, u nxor jashtë vendlindjes, u vranë të afërmit e tij, por megjithatë ai u udhëhoq nga fryma e shpirtit të bashkimit e jo nga urrejtja e përçarja. Kjo i shtyri edhe armiqtë më të mëdhenj ndaj tij që ta pranojnë Islamin. Profeti Muhamed caktoi edhe dhënien e zekatit si formë të ndihmës dhe të barazimit ekonomik të popullatës.

Historia e Profetit Muhamed nuk është që të përfitojnë vetëm muslimanët, por i tërë njerëzimi. Nuk ka patur në botë gjer më sot njeri tjetër që të ketë vuajtur, ofenduar dhe të jetë torturuar më shumë se Profeti Muhamed. Profeti Muhamed në moshën 63 vjeçe në vitin 10 të migrimit kreu Haxhin e lamtumirës. Gjatë këtij Haxhi ai të pranishëmve në mënyrë të fuqishme ua transmetoi mesazhet e paqes, dashamirësisë, mëshirës, bashkimit dhe kryerjes së obligimeve kuranore si rrugë e vetme për ta fituar kënaqësinë e Allahut

“Nga vuajtjet që muslimanët pësonin nga Kurejshët, profeti Muhamed urdhëroi që një pjesë e tyre të shpërngulen për në Abisini. Kurejshët duke parë se nuk po ia arrijnë qëllimit vendosën sanksionet dhe bojkotin ndaj fisit Beni Hashim në Mekë ku u ndalohej tërë banorëve që të mos blenin ose shisnin atyre mallra ose të martoheshin me ndonjë nga fisi i tyre.

të madhërisëm dhe Xhenetin. Pas kryerjes së Haxhit Profeti Muhamed u kthye në Medinë me ç'rast sëmuret dhe duke e lënë zëvendës së tij Ebu Bekrin si imam në xhaminë e Medines, pas disa ditësh ndërroi jetë duke iu lutur Allahut që të takohen në Xhenet dhe duke ndjerë kënaqësinë se në tërësi e realizoi amanetin e Allahut. Profeti ndërroi jetë në çastet e lindjes së diellit ashtu siç edhe u lind. Kjo tregon se drita hyjnore nuk do të largohet me vdekjen e Profetit, këtë dritë do ta mbajnë të ndezur muslimanët e brezave që vijnë duke e përhapur në tërë botën.

Profeti Muhamed është njeriu i vetëm në historinë e njerëzimit i cili jetoi i pasur dhe i varfër, i dobët dhe i fuqishëm, udhëheqës dhe njeri i rëndomtë, paqësor dhe luftëtar, i vetmi që dinte të krijojë lidhje me të gjitha shtresat e shoqërisë, me çifutët dhe arabët, me vendasit dhe të huaj, me popullin e thjeshtë dhe me fuqitë më të mëdha të kohës. Ai posedonte të gjitha format e madhësisë, ishte madhështor në paqe dhe madhështor në luftë, madhështor si bashkëshort, si prind, si njeri i thjeshtë në moral dhe në çdo aspekt tjetër.

Historia e Profetit Muhamed është histori e përpjekjeve, e durimit dhe e triumfit të së drejtës dhe të mirës, ndaj të keqes dhe interesave vetjake. Të gjithë muslimanët falen, agjërojnë, shumë prej grave mbajnë shami etj., por në shoqërinë e Profetit Muhamed në Xhenet do të jenë vetëm ata që e kanë mbajtur lartë mesazhin e Profetit.

Këto janë të dhënat e argumentuara nga ky libër për Profetin Muhamed, Kur'anin dhe fenë Islame. **(fund)**

Atë natë qershori, para 19 vjetësh, sytë e gjithë Jugosllavisë ishin të drejtuara nga ekranet televizive, në të cilat nga terri pranë qytetit të Maqedonisë, Kumanova, para çadrës ushtarake, me një mesazh të rëndësishëm po shfaqej gjenerali i NATO-s, Michael Jackson

Kështu e nisë BBC në gjuhën serbe bisedën me këtë gjeneral, që do të kujtohet në historinë e shtetit më të ri të Europës, Kosovës. Nënshkrimi i tij ishte në Marrëveshjen e Kumanovës, me të cilën pas 78 ditësh iu dha fund bombardimeve të Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ-së), ndërsa për Jacksonin shënonte edhe fillimin e operacionit të misionit të KFOR-it në Kosovë, të cilin do ta drejtonte në cilësinë e komandantit të parë. Nëntëmbëdhjetë vjet më vonë, në pyetjen se e a e kishte të qartë rëndësinë historike të atij momenti, buzëqeshet dhe thotë se beson se ka qenë mjaft i ndërgjegjshëm. "Isha i gëzuar dhe ndihesha i lehtësuar meqë ishte arritur marrëveshja, lufta nuk vazhdonte më", tha Jackson në bisedën me BBC.

NGA KAFENEJA DERI TE TENDA

Parimet politike, sipas të cilave Ushtria e Jugosllavisë (UJ) dhe forcat e MPB-së të Serbisë do të tërhiqeshin nga Kosova, ndërsa forcat e NATO-s do të hynin në atë territor, duhej të shndërroheshin në praktikë. Kjo ishte detyrë nga njëra anë e gjeneralit të NATO-s, Michael Jackson, ndërsa nga ana tjetër e delegacionit të RFJ-së, që përbëhej nga gjenerali Obrad Stevanović, gjenerali i UJ-së Svetozar Marjanović, përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Negociatat e ditës së parë u mbajtën në kafenenë "Evropa" në vendin Bllacë në anën e Maqedonisë, menjëherë përtej kufirit me Jugosllavinë. "Kjo ishte rastësi, nuk kishte kurrfarë lidhjeje simbolike me emrin", sqaron gjenerali Jackson dhe shton se bisedimet shumë shpejt u zhvendosën në bazën e ushtrisë franceze të Kumanovës, meqë për delegacionin serb nuk kishte siguri të mjaftueshme që të vinin deri te "Evropa". Dispozitat më të rëndësishme: Ndërprerja e armiqësisë ndërmjet forcave të NATO-s dhe forcave të UJ-së dhe policisë serbe, tërheqja e UJ-së dhe policisë së Serbisë nga territori i Kosovës në periudhën brenda 11 ditësh, vendosja e zonës së sigurisë nga kufiri (në tekstin në gjuhën serbe të intervistës cilësohet administrative -sqarim ynë) me Kosovën, detyrimi i forcave të KFOR-it që të çarmatosin UÇKN-në (teksti i plotë i Marrë-

KOMANDANTI I PARË KFOR-IT, MICHAEL JACKSON

S'DESHËM TË FILLONIM LUFTËN E TRETË BOTËRORE NË KOSOVË



veshjes gjenet në sajtin e NATO-s).

Negociatat i kujton për gjatësinë e mundimshme, harmonizimin e hollësishëm me palën jugosllave, thekson BBC. "E mbaj në mend se herë pas here detyroreshin të shkonin në territorin serb për të realizuar kontakt telefonik me Beogradin", thotë Jackson. Gjenerali britanik thotë se gjatë negociatave nuk ka pasur rishqyrtim të qëndrimeve politike, por bisedohej vetëm për zbatimin praktik të pikave për të cilat ishte arritur marrëveshje. "Serbia ishte e shqetësuar për kohën e vakuimit të sigurisë kur

të tërhiqeshin forcat e ushtrisë e të policisë dhe dëshironte që hyrja e NATO-s në Kosovë të ndodhte sa më shpejtë të jetë e mundur", kujton Jackson.

"NUK DOJA TË FILLONTE LUFTA E TRETË BOTËRORE"

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes kishte prituri me shumë gjumë dhe realizimin e planit të përgatitur paraprakisht të hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë. E zgjuan nga gjumi me informatën se forcat ruse, deri atëherë pjesë e forcave të SFOR-it në Bosnjë e Her-

cegovinë, kishin mbingjyrosur shenjat dhe të parat ishin futur në Aeroportin e Prishtinës.

"Ne kishim prituri që të na bashkohej kontingjenti i forcave ruse, ashtu si në Bosnje. Edhe unë këtë e pata mbështetur, në radhë të parë për arsye të lidhjeve kulturore dhe religjioze të popullit dhe të kishës ruse e serbe. Por, mënyra dhe koha kur kishte ndodhur kjo nuk ishte pjesë e planit", përshkruan Jackson situatën që kishte tronditur të gjithë edhe në selinë e NATO-s, edhe në Bruksel. Gjenerali amerikan Wesley Clark,

komandant i forcave europiane të Aleancës, kishte urdhëruar ndaljen e trupave ruse, largimin e tyre nga aeroporti dhe bllokimin e furnizimit. "Unë i thashë se kjo nuk ishte pjesë e mandatit tonë të marrë nga Kombet e Bashkuara, ndërsa gjërat do të mund të merrnin anën nga e keqja, të paplanifikuar, jo qëllimshëm, por të ndodhte. Duhej të shmangej mundësia e konfliktit të drejtpërdrejtë".

Në autobiografinë e tij, Jackson thekson se Çlark kishte tërhequr vërejtjen se nuk dëshiron të shkaktojë Luftën e Tretë Botërore, ndërsa sot thotë se ishte sinqerisht i shqetësuar. Forcat e Jacksonit u futën të parat në territorin e shkatërruar nga luftimet. "Ishim të vetëdijshëm se lufta midis Ushtrisë së Jugosllavisë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) kishte qenë shumë brutal sikundër edhe bombardimet e NATO-s mbi pozitat e Ushtrisë, ndonëse rezultatet nuk ishin ashtu siç disa njerëz mendonin se janë". Nuk ishin prituri as detyrat që u shfaqën, me gjithë përshtypjet që mbretëronin. "Problemi i Kosovës, siç e shihet shumica në Perëndim, ishte represioni serb mbi shqiptarët e Kosovës.

Fatkeqësisht, ishte tragjike se pas tërheqjes së forcave serbe patëm situatë të kundërt—disa shqiptarë të Kosovës kishin kujtuar se ishte rasti të shfrytëzonin pozicionin e vet shumicë për të kryer represion mbi pakicën serbe. E kishim problem çfarë të bënim me UÇK-në, si ta zbatonim çarmatimin dhe demilitarizimin".

Pas përfundimit të bombardimeve, forcat e KFOR-it ishte thujta pushteti i vetëm në Kosovë, meqë me forcat e sigurisë të Jugosllavisë u larguan shumë refugjatë. "Ajo që na befaso i ishte se Serbia kishte sunduar Kosovën gati si një koloni—të gjitha organet e shtetit përbëheshin krejtësisht nga serbë.

Përveç ushtrisë e policisë, pu-



"BALLKANI MË ËSHTË FUTUR NËN LËKURË"

Jackson sot i ka 74 vjet dhe jeton në Britani të Madhe. Vetën e përshkruan si "gjysmëpnesionist", ushtarakisht nuk është më aktiv, por mban ligjërata të ndryshme, punëtori, fjalime motivuese dhe këshillon klientët të ndryshëm.

shteti civil, spitalet, shkollat dhe universitetet, sistemi elektroenergjetik, që të gjitha ishin kontrolluar nga serbët. Pastaj shumë nga këta njerëz u larguan, ndonëse me marrëveshje kjo nuk kërkohet, tërheqja kishte të bënte vetëm me forcat e sigurisë, përshkruan Jackson dhe shton se forcat e tij u desht të merren edhe me administratën deri sa nuk u vendos sistemi civil, transmeton Koha.net.

"FLIJA VETËM PESË ORË"

Nga distanca kohore nëntëmbëdhjetë vjeçare, Jackson konsideron se KFOR-i bëri të gjitha ato që i kishte për detyrë, kurse në insistimin nëse ka pasur ndonjë gjë për të cilën është dashur të bëje më shumë, ai është përgjigjur me pyetje. "Është e vërtetë se kam fjetur nga pesë orë në natë, gjë që ndoshta nuk është dashur ta bëja? Por, nuk mundeni gjithmonë pa gjumë."

Jackson është i bindur se forcat e tij kanë kryer me sukses misionin në një që ai e përshkruan jashtëzakonisht të rëndë. "U kemi ndihmuar njerëzve që ndodheshin në situatë të pamundur, dhe këtu llogaris edhe Serbinë – Serbia kishte hyrë në një situatë të pamundur nën Millosheviqin. KFOR-i i ka ndihmuar jo vetëm Kosovës por edhe të ardhmes më të mirë të Ballkanit".

I pyetur nëse konsideron se ka miq edhe ndër serbë të Kosovës, Jackson përgjigjet: "Do të dëshiroja të kisha". "Posaçërisht e kujtoj një klerik të Kishës Ortodokse Serbe, që është bërë një nga përfaqësuesit e serbëve të Kosovës. Shpesh herë më ka ftuar në drekë në manastir, shpesh më ka bërë me dije edhe se ku po gaboja", përshkruan Jackson takimet me serbët e Kosovës.

"PRINCI I ERRËSIRËS"

Gjenerali Jackson mori nofkën në ushtrinë britanike "Princi i errësirës" (Prince of Darkness). "Nuk mund t'ua them çfarë qëndron pas kësaj nofke, nuk e kam shpikur unë", përgjigjet me buzëqeshje. 1995 - 1996 ishte komandant i forcave të OKB-së në Bosnjë e Hercegovinë. Një muaj para fillimit të luftës në Irak mori pozitën e shefit të Ushtrisë së Britanisë. U pensionua pash shërbimit të gjatë 45 vjet. Djali i tij, Marku, ka shërbyer në ushtrinë britanike në Kosovë derisa i atij i tij ishte në krye të KFOR-it. Në Ballkan është kthyer shpesh, ndonëse thotë se nuk e ndjek situatën në hollësi. "Meqë e dini se kam qenë në Bosnjë qysh më 1995, e kuptoni se Ballkani më është futur nën lëkurë". Në shembullin e Mostarit, ku është në bordin drejtues të një shkolle ndërkombe-tare, thotë se me rindërtimin e urës është bërë edhe rindërtimi fizik dhe se vihat re përparim i madh.

"Më intereson të di se në ç'masë ky rekonstruktiv fizik është ndjekur nga përtëritja filozofike, politike e religjioze, për këtë jam më pak i bindur". Jackson e kupton pse NATO-ja në Serbi vazhdon të jetë jopopullore, e pranon se ndërhyrja ushtarake më 1999 vazhdon të ketë gjurmë. "Shikuar hipotetikiisht, sikur Serbia edhe të dëshironte të bëhej anëtare e NATO-s, kjo nuk do të shihej me simpati nga ana e Moskës. Por, kjo është punë për pushtetin serb dhe për qytetarët e Serbisë", përfundon gjenerali britanik i cili shërbeu në Ushtrinë Mbretërore 45 vjet. (koha.net)

NJERËZIT ME MBIPESHË E SHIJOJNË MË PAK USHQIMIN

Mungesa e kënaqësisë (shijimit të ushqimit) gjithsesi mund të kontribuojë në ngrënie të tepërt dhe mund të ndodhë që konsumohet një sasi më e madhe e ushqimit për ta kompensuar mungesën e shijimit të ushqimit. Njerëzit mund të ndihmohen që të dobësohen duke i kushtuar më shumë vëmendje ndjenjës së kënaqësisë që pason pas ngrënies së ushqimit

Nëse bazohemi në një studim të kryer në Universitetin Bangor në Uells, njerëzit me mbipeshë e shijojnë ushqimin më pak se ata që janë me peshë të shëndetshme.

Njerëzit me peshë të shëndetshme kryesisht hanë kur janë të uritur dhe e shijojnë ushqimin. Njerëzit me mbipeshë, megjithatë, hanë kur e ndjejnë dëshirën për ndonjë ushqim edhe pse nuk janë domosdo të uritur, dhe më pas pohojnë se nuk e kanë shijuar në veçanti ushqimin. Shkencëtarët po diskutojnë nëse kjo është pjesërisht për shkak të faktit se njerëzit e trashë gjithnjë e më shumë hanë më shumë ushqim, duke u përpjekur ta kompensojnë ndjenjën e pakënaqësisë.

Pjesëmarrësit e studimit përmes aplikacionit në telefonat mobilë regjistruan kur ndiheshin të uritur dhe nëse ishin të këna-



qur pas ushqimit, në një shkallë nga 1 deri në 10, transmeton Koha.net. Hulumtuesit u befasuan nga fakti se individët me mbipeshë e ndienin nevojën për ushqim njëjtë si ata me peshë të shëndetshme.

Të dy grupet e të anketuarve kishin nevoja shumë të ngjashme të ngrënies, tri herë në ditë, ndërsa kohëzgjatja e ngrënies ishte e ngjashme, tetëmbëdhjetë minuta. Njerëzit me mbipeshë definitivisht nuk ishin më të uritur se njerëzit me peshë të shëndetshme. Megjithatë, është vënë re se këto grupe të ndryshme të njerëzve kanë shprehur të ndryshme të ngrënies dhe një qëndrim të ndryshëm ndaj ushqimit. Njerëzit me peshë të shëndetshme hanë kur janë

të uritur dhe pas ngrënies janë shumë të lumtur.

Një nga autorët e studimit, dr. Hans Peter Kubis, tha se shumë dëshira tona për ushqimin janë të bazuara në shpërblimin e vetes sonë, dhe jo për shkak të ndjenjës së urisë.

Mungesa e kënaqësisë (shijimit të ushqimit) gjithsesi mund të kontribuojë në ngrënie të tepërt dhe mund të ndodhë që konsumohet një sasi më e madhe e ushqimit për ta kompensuar mungesën e shijimit të ushqimit. Njerëzit mund të ndihmohen që të dobësohen duke i kushtuar më shumë vëmendje ndjenjës së kënaqësisë që pason pas ngrënies së ushqimit.

Pica që e parandalon kancerin dhe sëmundjet e zemrës!

Shkencëtarët dhe kuzhinierët italianë pohojnë se e kanë krijuar picën e cila e parandalon kancerin dhe sëmundjet e zemrës. Pica Pascalina është bërë në Napoli, ndërsa ajo u cilësua edhe si "pica e cila e zgjatë jetën" dhe "pica antitumorale". Pascalina është bërë nga përbërësit e kuzhinës mesdhetare për të cilën dihet se është e mirë për shëndetin. Ajo do të jetë në shitje gjatë festivalit të picës në Napoli. Shkencëtarët nga Instituti Kombëtar për tumore në Milano treguan se këtë picë mund ta hani dy herë

në javë. Picën e krijuan së bashku studiuesit, furnizuesit, prodhuesit e ushqimit dhe konsumatorët. Ata shpresojnë t'i inkurajojnë njerëzit që të hanë shëndetshëm dhe të tregojnë se pica mund të jetë një ushqim i shëndetshëm. Brumi është standard nga mielli i bardhë, ndërsa në të ka domatina, ullinj, vaj ulliri ekstra të virgjër, hudhër, spec djegës dhe lloji i brokollit rapini. Këta përbërës e zvogëlojnë rrezikun prej sëmundjeve kardiovaskulare dhe disa llojeve të kancerit që shfaqen në sistemin e tretjes.



Facebook-u po rrit ndarjet e çifteve

Terapistja e njohur e seksit, Dr. Ruth Westheimer, ka folur për efektet që rrjetet sociale po i shkaktojnë të mijëvjeçarët. Psikoterapistja 90-vjeçare beson se rrjetet sociale janë duke i bërë mijëvjeçarët të vetmuar dhe janë duke ndikuar në aftësinë e tyre për t'i mbajtur lidhjet romantike. E njohur si "Dr. Ruth" përgjatë Shteteve të Amerikës, autorja e lindur në Gjermani ka shpjeguar se rrjetet sociale kanë ndikuar edhe në aftësitë sociale të jetës reale. "Jam tejet e shqetësuar për vetminë. Njerëzit janë duke e humbur artin e komunikimit. Ata vazhdimisht janë duke qëndruar në telefonat e tyre të mençur. Ju shihni shpesh çifte në restorante duke qëndruar secili në telefonin e tyre. Ky është problem i madh për lidhjet romantike", ka thënë ajo. Ajo ka shpjeguar se lidhjet sot janë shumë më të vështira për t'u mbajtur shkaku i internetit. "Interneti sot po iu jep njerëzve pritshmëri të paarsyeshme, sikur ajo që femrat presin një Princ me një kali të vijë dhe të dashurohen në të".



OKB: Janë nisur 2.5 milionë sirianë drejt Turqisë

Përshkallëzimi i dhunës në rajonin sirian të Idlibit mund të shkaktojë një lëvizje masive të refugjatëve drejt kufirit me Turqinë, paralajmëroi sot një zyrtar i lartë i OKB-së në Gjenevë. Në javët e fundit, forcat siriane dhe ruse kanë intensifikuar sulmet në rajonin veriperëndimor që kontrollohet kryesisht nga Hayat Tahrir al Sham, një aleancë islamike e drejtuar nga një grup i lidhur me Al Kaedën. Panos Moumtzis, shefi i OKB-së përgjegjës për ndihmën në krizën siriane, deklaroi në një konferencë për shtyp se 2,5 milionë persona në Idlib duke përfshirë edhe më shumë se 1,25 milionë persona tashmë të shpërngulur do të arratisen për në një zonë më të qetë, përcjell Atsh. "Me këtë përshkallëzim dhe përkeqësim mendojmë se këta 2,5 milionë persona mund të shpërngulen në drejtim të kufirit me Sirinë", tha ai.



Erdogan: Turqia do të zhdukë "moçalin" terrorist

Turqia do të "thajë moçalin terrorist" në rajonin verior të Kandil irakian ashtu siç "pastroi" Afriini sirian dhe zona të tjera ku luftëtarët kurdë ishin aktivë, tha sot presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan. Ai gjatë një tubimi u zotua se Turqia do të vazhdojë të kryejë operacione kundër kampeve ekstremiste kurde në zonën malore të Kandilit.

ÇNUKLEARIZIM DHE KTHIMI I ROBËRVE TË LUFTËS, NË QENDËR TË TAKIMIT TRUMP-KIM

Presidenti amerikan Donald Trump dhe ai i Koresë së Veriut Kim Jong Un shtrënguan duart në orët e para të mëngjesit të së martës, në një takim historik të mbajtur në Singapor, ku është përqendruar vëmendja e mbarë botës. Dy presidentët janë ulur në tryezë në orarin e paracaktuar duke shtrënguar duart me njëri-tjetrin pak para nisjes së bisedimeve. Takimi ndodhi në mjedisin prej 12 hektarësh të hotelit luksoz Capella në ishullin Sentosa. Presidenti amerikan Donald Trump dhe udhëheqësi koreano-verior Kim Jong Un nënshkruan një marrëveshje gjatë takimit historik në Singapor

Të bindur se krijimi i marrëdhënieve të reja SHBA-RPDK do të kontribuojë për paqen e begatinë e Gadishullit të Koresë e të botës, dhe duke pranuar se krijimi i besimit të ndërsjellë mund të promovojë çnuklearizimin e Gadishullit të Koresë, Presidenti Trump dhe Kryetari Kim Jong Un deklarojnë si më poshtë:

1. Shtetet e Bashkuara dhe RPDK angazhohen në ndërtimin e marrëdhënieve të reja SHBA-RPDK në përputhje me dëshirën e popujve të të dy vendeve për paqe e begati.

2. Shtetet e Bashkuara dhe RPDK do të bashkojnë përpjekjet për të ndërtuar një regjim paqeje të qëndrueshëm e jetëgjatë në Gadishullin e Koresë.

3. Dike riafirmuar deklaratën e Panmunjomit, datë 27 prill 2018, RPDK angazhohet të punojë për aritjen e çnuklearizimit të plotë të Gadishullit të Koresë.

4. Shtetet e Bashkuara dhe RPDK angazhohen për kthimin e robërve të luftës / të humburve në betejë, përfshirë riatdhesimin e menjëherëshëm të atyre që janë të identifikuar tashmë.

Të ndërgjegjshëm që takimi SHBA-RPDK—i pari në histori—ishte një ngjarje epokale me domethënie të madhe e që kapërcen dekada tensioni e armiqësie midis dy vendeve dhe për nisjen e një të ardhmeje të re, Presidenti Trump Kryetari Kim Jong Un angazhohen për përmbushjen e plotë dhe në mënyrë efektive të pikave të kësaj deklaratë të përbashkët. Shtetet e Bashkuara dhe RPDK angazhohen të mbajnë takime të tjera në vazhdimësi, me pjesëmarrjen e Sekretarit të Shtetit të SHBA, Mike Pompeo, dhe një zyrtari të nivelit të lartë të RPDK, në datën më të afërt të mundshme, për zbatimin e marrëveshjeve të takimit SHBA-RPDK.

Presidenti Donald J. Trump i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kryetari Kim Jong Un i Komisionit të Çështjeve Shtetërore të Repu-



blikës Popullore Demokratike të Koresë angazhohen të bashkëpunojnë për zhvillimin e marrëdhënieve të reja SHBA-RPDK dhe për promovimin e paqes, begatisë e sigurisë në Gadishullin e Koresë e në Botë.

TRUMP: "MËSOVA SE KIM ËSHTË NJË NJERI SHUMË I TALENTUAR"

I pyetur nëse do të ftonte udhëheqësin e Koresë së Veriut në Shtëpinë e Bardhë, Trump tha: "Absolutisht, po. Kjo do të çojë në gjithnjë e më shumë", tha Trump. "Mësova se ai është një njeri shumë i talentuar dhe gjithashtu mësova se ai e do shumë vendin e tij", tha Trump duke iu referuar Kimit. Gazetarja e NBC e ka pyetur gjatë konferencës, se si po e quan 'njeri të mrekullushëm' një person që ka vrarë madje edhe anëtarë të familjes së tij. Trump ka thënë se e di se kanë ndodhur gjëra të tmerrshme, por gjërat po përmirësohen.

"Ai është person i veçantë, mendoj se nisma e fundit tregon se do të ndodhin gjëra të mira. Ka ndodhur gjëra të tmerrshme por njerëzit shpresojnë se diçka e mirë do të ndodhë, në veçanti, të rinjtë. Ai ka shumë punë për të bërë", ka thënë Trump

Më herët, pas përfundimit të takimit të tyre 45-minutësh, Trump

tha se ai ka shkuar më mirë seç pritej dhe e cilësoi si "sukses të jashtëzakonshëm".

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se denuklearizimi i Gadishullit Korean do të nisë "shumë shpejt". Ai i bëri këto komente pas takimit me udhëheqësin verikorean, Kim Jong Un, për të cilin tha se ka qenë "sukses i jashtëzakonshëm".

I pyetur nëse do të ftonte udhëheqësin e Koresë së Veriut në Shtëpinë e Bardhë, Trump tha: "Absolutisht, po. Kjo do të çojë në gjithnjë e më shumë", tha Trump. "Mësova se ai është një njeri shumë i talentuar dhe gjithashtu mësova se ai e do shumë vendin e tij", tha Trump duke iu referuar Kimit. Më herët, pas përfundimit të takimit të tyre 45-minutësh, Trump tha se ai ka shkuar më mirë seç pritej dhe e cilësoi si "sukses të jashtëzakonshëm". "Do të zgjidhim një problem të madh, një dilemë të madhe që deri në këtë moment nuk ka mundur të zgjidhet", tha Trump. Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, sinjalizoi të hënën se takimi i parë nuk pritet të sjellë ndonjë arritje të madhe dhe shtoi se ai duhet të shërbejë si kornizë për "punën e vështirë që do të pasojë". Pompeo tha se Koreja e Veriut duhet të arrijë de-

nuklearizim të plotë, të verifikueshëm dhe të pakthyeshëm dhe se sanksionet nuk do t'i hiqen derisa kjo të mos ndodhë.

GJUHA E TRUPIT, KUSH DOLI I FITUAR?

Shtrëngimi i duarve mes presidentit amerikan Donald Trump dhe liderit të Koresë së Veriut, Kim Jong Un në takimin historik në Singapor, tregon dëshirën e dy liderëve për të qenë dominant, thotë ekspertja e gjuhës së trupit.

Në takimin formal të së hënës ku dy liderët u shfaqën në tepihun e kuq përballë njëri-tjetrit dhe shtrënguan duart para gazetarëve, është cilësuar si një veprim historik.

Gjatë një interviste dhënë për 'Daily Mail', ekspertja e gjuhës së trupit ka komentuar shfaqjen e dy liderëve para kamerave, si dhe shtrëngimin e tyre të duarve që tregonte qartë tendencat për të qenë dominant.

Patti Wood që për dekada studioi gjuhën e trupit, ka deklaruar se si personat e veshur me kostume të kulturës perëndimore dhe aziatike do të analizonin ndryshe takimin duke thënë se secili prej tyre do të mundoheshin ta nxjerrin 'fitues' liderin e tyre. Ai filloi me analizimin e gjuhës së trupit të liderëve në mo-



Trump sulmon sërish Gjermaninë: Paguaj më shumë për NATO-n

Beteja e Trump kundër Gjermanisë vazhdon edhe pas G7. Presidenti amerikan nis një anatëmë të re: "Gjermania paguan 1% (ngadalë) të PBB-së së saj në NATO, ndërkohë që ne paguajmë 4% të GDP-së më të madhe. A ka ndonjë që beson se kjo ka kuptim?". "Ne e mbrojmë Evropën (e cila është e mirë) me koston e humbjeve të mëdha financiare dhe pastaj ne jemi të prekur padrejtësisht nga tregtia dhe ndryshimi po vjen!", shtoi ai.

"Shtetet e Bashkuara paguajnë pothuajse të gjithë koston e NATO-s, duke mbrojtur shumë nga të njëjtat vende që na vjedhin nga tregtia", vijoi Trump, duke argumentuar se BE "duhet të paguajë më shumë për çështjet ushtarake" dhe duke drejtuar gishtin në Berlin se "paguan 1% (ngadalë) të PBB-së për NATO-n, ndërsa ne paguajmë 4% të GDP-së shumë më të madhe". Përfundimisht, rezultati i arritur nga presidenti është një pohim i ri i doktrinës "Amerika e para": "Na vjen keq, nuk mund të lejojmë më që miqtë tanë, apo armiqtë të përfitojnë nga ne në tregti. Duhet të vendosim në vendin e parë punëtorin amerikan!".

mentin që u shfaqen para kamerave në tepihun e kuq. Ajo tha se shpejtësia me të cilën Kim dhe Trump ecën tregoi 'fuqinë e barabartë'.

'Që të dy filluan të ecin në drejtim të njëri-tjetrit në pothuajse të njëjtën kohë me shpejtësinë e njëjtë, duke treguar fuqinë e barabartë', ka deklaruar ajo.

Dhe më pas ishte pikërisht Trump që zgjati dorën i pari për të iniciuar shtrëngimin e duarve.

'Ai u shfaq i fuqishëm, duke i vënë dorën në shpatull, gjë që e bëri të duket edhe më i madh sesa që është', ka shtuar Wood.

'Sa herë që dy liderë takohen dhe njëri prej tyre ia vë dorën mbi shpatull, pa dyshim se ai është fitues, duke u treguar i madh, zemërgjerë dhe plotësisht dominant', ka thënë për fund ekspertja.

Ajo beson se qytetarët amerikanë do të thonë se Trump ka dalë fitues, sikurse ashtu si do të mendonin njëjtë për liderin e tyre qytetarët e Koresë së Veriut. Megjithatë, kjo punë duhet t'i lihet kohës që do të dëshmojë se cili në të vërtetë kishte bërë punë të mirë.

PSE U ZGJODH SINGAPORI PËR TAKIMIN HISTORIK TRUMP-KIM?

Nuk është rastësi që Singapori u zgjodh si vendi ku u organizua Samiti historik midis presidentit të Shteteve të Bashkuara Donald Trump dhe udhëheqësit të Koresë së Veriut Kim Jong Un. Një arsye kryesore: ky qytet-shtet është jashtëzakonisht i sigurt dhe i kontrolluar shumë. Në fakt, ka një nga nivelet më të ulëta të krimit në botë. Kjo është pjesërisht për shkak të sistemit gjithëpërfshirës të kontrollit të vendit, siç raporton nga Singapori korrespondenti Bill Gallo i Zërit të Amerikës. Singapori e prezanton veten si i pari "komb inteligjent" në botë. Dhe është e lehtë të kuptohet pse.

Ky është një vend shumë i lidhur nga ana digjitale. Një sondazh i kohëve të fundit tregon se singaporanët shpenzojnë pothuajse 13 orë



në ditë me pajisjet e tyre digjitale. E gjithë kjo teknologji e bën shumë të lehtë që strukturat qeveritare të mbikëqyrin qytetarin. Një mënyrë për ta bërë këtë, është me kamerat e vëzhgimit. Në fakt, pavarësisht se ku ndodheni në Singapor, nuk ka nevojë të vështroni shumë larg për të parë se dikush po shikon. Ka kamera kudo këtu. Dhe sigurisht, kjo nuk është domosdoshmërisht e pazakontë për një vend.

Por në Singapor, qeveria mund të përgjojë qytetarin - duke përfshirë monitorimin e telefonatave, emailëve dhe diskutimeve të tjera private - pa urdhër gjykatë. Kjo bën që Singapori të jetë vendi i përsosur për të organizuar një samit delikat ndërkombëtar. "Singapori mund të garantojë se nuk do të ketë protesta kundër Donald Trump-it. Nuk do të ketë as protesta kundër Kim Jong Un-it. Nuk do të ketë kërcënime sigurie, sepse gjithçka do të jetë nën mbikëqyrje të vazhdueshme" thotë Phil Robertson, i organizatës "Human Rights Watch".

Singapori ka një nga nivelet më të ulëta të krimit në botë. Sipas organizatës Gallup, singaporanët raportuan se ndiheshin më të sigurt se banorët e ndonjë vendi tjetër për pesë vjet rresht. Stabiliteti ndihmon në krijimin e begatisë, duke e bërë Singaporin një kryeqendër globale financiare. Por nuk është e gjitha fushë me lule. "Pa diskutim që këto mjete përdoren për luftimin e krimit, siç thonë edhe vetë autoritetet. Por ato përdoren edhe për arsye po-

litike. Autoritetet duan të kontrollojnë se çfarë bën opozita, çfarë bëjnë aktivistët".

Aktivistë si Jolovan Wham, një nga kritikët më të shquar të qeverisë së Singaporit. "Ai që është aktivist apo politikan, duhet ta marrë me mend se gjithçka që thotë apo bën, madje edhe bisedat me e-mail me miqtë, kontrollohen nga autoritetet. Sepse mbikëqyrja është pjesë e jetës në Singapor, veçanërisht për dikë që kritikon partinë në pushtet" thotë ai. Wham u akuzua vitin e kaluar për organizimin e protestave të paautorizuara. Zëri i Amerikës foli me aktivistin në parkun Hong Lim, i vetmi vend në Singapor ku lejohen protestat - me kusht që të kesh siguruar

leje. "Këtu në parkun Hong Lim, ka kamera kudo. Pra, sistemi synon të mbjellë frikë dhe censurë". Në përgjithësi ka shumë pak disidencë kundër partisë në pushtet, e cila për dekada ka dominuar politikën në Singapor. Një nga vendet më të bukura në botë - me shumë begati, por dhe shumë siguri.

SI U PASQYRUA TAKIMI TRUMP-KIM NË KORENË E VERIUT?

Perspektiva për një takim historik mes dy liderëve, Donald Trump dhe Kim Jong Un ka qenë lajmi kryesor i dy ditëve të fundit edhe në Korenë e Veriut. Koreano-veriorët janë informuar hap pas hapi për gjithçka ndodhte në Singapor, përmes disa ekraneve gjigantë të vendosur kudo në Penian, ku televizioni qendror i Koresë së Veriut transmetonte "live" takimin. Qytetarët ishin mbledhur në rrugët kryesore për të ndjekur "live" çfarë ndodhte, duke nisur nga lideri i tyre Kim Jong Un teksa zbriste nga avioni.

Televizioni shtetëror KCNA ka raportuar hap pas hapi detajet e takimit, përveç momentit të shtrëngimit historik të duarve mes dy liderëve.



Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 dhe 164-b të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pëlqimi për punësim nga Ministria e financave nr. 18-6495 nga 06.06.2018 dhe 18-2259/2, 18-2264/2 dhe 18-2258/2 nga 26.02.2018 dhe 18-3212/2 nga 16.03.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 03-663/1 nga data 11.06.2018, u.d. Drejtori i IPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR NEUROKIRURGIJ – SHKUP, publikon:

SHPLLJE PUBLIKE

për punësimin e 1 (një) doktor të medicinës specializant për neurokirurgji dhe 6 (gjashtë) motra medicinale me kohë të pacaktuar

1. IPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR NEUROKIRURGIJ – SHKUP, ka nevojë për punësimin e:

1.1 1 (një) doktor të medicinës – specializant për neurokirurgji me kohë të pacaktuar dhe

1.2 2 (dy) motra medicinale me kohë të pacaktuar

1.3 3 (tre) motra medicinale me kohë të pacaktuar

1.4 1 (një) motra medicinale me kohë të pacaktuar

2. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme të vërtetuara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore:

- të jetë shtetas i RM,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore, dhe
- të mos jetë të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

3. Përveç kushteve të përgjithshme të vërtetuara me ligj kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:

Për kandidatin nga pika 1.1

- të ketë të mbaruar arsim të lartë me së paku 240 kredi sipas SETK apo shkalla VII/1- Fakulteti i medicinës

- provim të dhënë profesional

- licencë për punë

- suksesin e arritur për të gjitha lëndët të të gjitha cikleve të studimeve universitare të cilat i ka mbaruar kandidati të më së paku tetë (në tekstin e mëtejshëm: sukses mesatar) dhe

- në mënyrë aktive të njohë një nga tre gjuhët që shfrytëzohen të Unionit Evropian (angleze, gjermane apo frënge) në nivel B2 sipas kornizës së përbashkët Evropiane e referencës e gjuhës, mësimit dhe vlerimit (Common European Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment) (në tekstin e mëtejshëm: CEFR dhe të posedojë certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht të pranuar të dhënë nga testator evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve të nivelit B2 CEFR, gjegjësisht ELTS me 5-6 pikë, FCE, BEC, ILEC, IKFE, BULATS, apo TOEFL PBT me së paku 500 pikë, TOEFL CBT me së paku 175 pikë apo TOEFL IBT me së paku 60 pikë ose DELF, TCF, TEF, ose Goethe-Zertifikat, TestDaF.

- me dhe pa përvojë pune

njohja e gjuhës së huaj nga pika 3, përveç se me certifikatë të njohura ndërkombëtare ose certifikatë të përdorura ndërkombëtarisht, dëshmohet edhe me vërtetim për mbarim të ciklit të parë, të dytë ose të tretë të studimeve në një prej 200 fakulteteve më lartë të radhura në Shanghai Ranking – ARËU (Academic Ranking of World Universities) të një prej tre gjuhëve më së shpeshti të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane), për të cilat studime kandidatët posedon diplomë të nostrifikuar.

Për kandidatët nga pika 1.2

- Arsim sipëror të mbaruar 180 kredi – studime të mbaruar profesionale për motër medicinale

- Provim të dhënë profesional dhe

- Përvojë pune nga sfera e neurokirurgjisë në kohëzgjatje prej së paku 3 muaj

Për kandidatët nga pika 1.3

- Arsim të mesëm të mbaruar të medicinës

- Provim të dhënë profesional dhe

- Përvojë pune nga sfera e neurokirurgjisë në kohëzgjatje prej së paku 3 muaj

Për kandidatët nga pika 1.4

- Arsim të mesëm të mbaruar të medicinës

- Provim të dhënë profesional dhe

- Përvojë pune nga sfera e medicinës në kohëzgjatje prej së paku 2 vjet

4. Orari i punës 40 orë në javë dhe neto pagesa bazë:

- për kandidatin nga pika 1.1 është 29.575,00 denarë

- për kandidatin nga pika 1.2 është 22.314,00 denarë

- për kandidatin nga pika 1.3 është 18.421,00 denarë

- për kandidatin nga pika 1.4 është 18.421,00 denarë

5. Me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim:

Për kandidatin nga pika 1.1

- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt

- Biografi të shkurtë (CV)

- Diplomë me sukses mesatar

- Njohja e gjuhës së huaj dëshmohet me dorëzimin e një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatave të përdorura ndërkombëtare: BULATS, CAE, IELTS, FCE, BEC, PET, KET, ILEC, TOEFL PBT, TOEFL CBT, TOEFL IBT për gjuhën angleze, gjegjësisht DELF, DALF, TCF, TEF, BULATS për gjuhën frënge, gjegjësisht Gete Certifikatë (Goethe-Zertifikat), TestDaF dhe BULATS për gjuhën gjermane ose certifikatë tjetër të njohur ndërkombëtare të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian ose organizatave të tjera ndërkombëtare të B2 nivelit të Kornizës së përbashkët referuese evropiane për mësim, ligjërim dhe vlerësim të gjuhëve (CEFR).

- Kandidatët të cilët kanë përfunduar ciklin e parë, të dytë ose të tretë të studimeve nga sfera e shkencave të medicinës në një prej 100 fakulteteve më të mirë të radhura të Shanghai Ranking-ARWU (Academic Ranking of World Universities) nuk duhet të përbushin kushtet e posaçme të pikës 3 të kësaj shpallje, dhe as për punësimin e tyre nuk realizohet procedura e selektimit të kandidatit.

- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,

- Certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,

- Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

- Certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

- Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

- Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

Për kandidatin nga pika 1.2

- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt

- Biografi të shkurtë (CV)

- Dëshmi për kryerjen e Arsimit sipëror – drejtimi i motër medicinale/teknik medicinal profesional studime 180 kredi sipas SETK (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

- Dëshmi për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

- Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

Për kandidatin nga pika 1.3

- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt

- Biografi të shkurtë (CV)

- Dëshmi për kryerjen e Arsimit sipëror – drejtimi i motër medicinale/teknik medicinal profesional studime 180 kredi sipas SETK (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

- Dëshmi për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

- Dëshmi për përvojë pune (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- Certifikatë të shtetësisë, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

Për kandidatin nga pika 1.3

- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt

- Biografi të shkurtë (CV)

- Dëshmi për kryerjen e Shkollës së mesme mjekësore (SHMM) për motër edhe atë Dëftesat nga të gjitha 4 (katër) vitet në të cilat është i theksuar suksesi i arritur në SHMM për çdo vit veçmas (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

- Dëshmi për provim të dhënë profesional, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

- Dëshmi për përvojë pune (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- Certifikatë të shtetësisë, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

- Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

Për kandidatin nga pika 1.4

- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt

- Biografi të shkurtë (CV)

- Dëshmi për kryerjen e Shkollës së mesme mjekësore (SHMM) për motër edhe atë Dëftesat nga të gjitha 4 (katër) vitet në të cilat është i theksuar suksesi i arritur në SHMM për çdo vit veçmas (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

- Dëshmi për provim të dhënë profesional, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

- Dëshmi për përvojë pune (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- Certifikatë të shtetësisë, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

Kandidatët që kanë mbaruar arsimin përkatës jashtë vendit duhet të parashtrojnë:

• Diplomë të nostrifikuar me arsim përkatës

• Dokument për ekuivalencë të notave të dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Orari i punës është me ndërrime, 40 orë në javë, pagesa do të paguhet sipas marrëveshjes kolektive për shëndetësi.

6. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve

8. Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur për doktor të medicinës dhe motër medicinale të cilët i plotësojnë kushtet nga shpallja publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.

9. Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dhe telefonin për kontakt të dorëzohen deri në IPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR NEUROKIRURGIJ – SHKUP rr. "Nënë Tereza" nr. 17, përmes postës ose në arkivin e IPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR NEUROKIRURGIJ – SHKUP, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR NEUROKIRURGIJ – SHKUP

Ftesë për shprehje të interesit

Nr. 011-18/1.1.2-1

Republika e Maqedonisë

Projekti për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve

Huaja nr.: 8332-MK

Pozita: Këshilltar për sigurim të kualitetit në arsim sipëror për vlerësim të nevojave për përfundim të kapaciteteve të Këshillit për akreditim dhe evaluim të arsimit sipëror

Republika e Maqedonisë ka fituar mjete financiare nga Banka botërore në drejtim të implementimit të Projektit për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve dhe planifikon të shfrytëzojë një pjesë të mjeteve për shërbime konsultente, gjegjësisht angazhim të konsulentit individual si për sigurim të kualitetit në arsim sipëror për vlerësim të nevojave për përfundim të kapaciteteve të Këshillit për akreditim dhe evaluim të arsimit sipëror në Republikën e Maqedonisë.

Shërbimet konsultente ("shërbimet") përfshijnë vlerësim të proceseve, kritereve dhe procedurave për sigurim të kualitetit në arsimin sipëror në Maqedoni dhe përgatitje të rekomandimeve/aktiviteteve të detajuara për përmirësimin e kapacitetit administrativ të Këshillit për akreditim dhe evaluim të arsimit sipëror dhe disa aktorëve tjerë kyç të angazhuar për menaxhimin e aktivitetit për sigurim të kualitetit, me qëllim të plotësimin të kritereve për anëtarësimin në ENQA dhe EQAR..

Kohëzgjatja e paraparë e shërbimeve është korrik 2018 – maj 2019. Përshkrimi i detyrave të punës në gjuhën angleze është i mundshëm në <http://mon.gov.mk/index.php/dokumenti/2014-07-30-12-00-34/sdis-proekt>

Ministria e Arsimit dhe Shkencës fton konsulentët përkatës individual ("konsulentë") të shprehin interesin e tyre për sigurimin e shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të parashtrojnë letër për shprehje të interesit, biografi (CV) dhe informacione/dokumente të tjera me të cilat do të vërtetohet se përbushë kualifikimet dhe përvojën e nevojshme në vijim:

- Së paku shtatë (7) vjet përvojë në sferën e arsimit sipëror, në pjesën e rolit përkatës ose bashkëpunim me institucionet për arsim sipëror në sferën e evaluimit të jashtëm dhe sigurim të kualitetit.
- Njohuri rrënjësore të politikave, praktikave dhe komizave për arsim sipëror në BE.
- Njohuri rrënjësore të agjencive/trupave evropiane për sigurim të kualitetit
- Njohuri të kritereve dhe procedurave për sigurim të kualitetit dhe evaluimit të jashtëm të ENQA, si dhe procedurat e EQAR do të konsiderohet si përparësi
- Studime të mbaruara të magjistraturës dhe/ose doktoratës nga sfera e arsimit, shkencave shoqërore, biznes administratës dhe të ngjashme
- Përvojë të më hershme profesionale në Maqedoni ose vendet ballkanike do të llogaritet si përparësi
- Njohje të shkëlqyeshme të gjuhës angleze. Njohja e gjuhës maqedonase, serbe ose kroate do të llogaritet si përparësi.

Konsulentët e interesuar duhet marrin parasysh pikën 1.9 të procedurave për furnizim të Bankës botërore {Guidelines: Selection and Employment of Consultants [under IBRD Loans and IDA Credits & Grants] by World Bank Borrowers, January 2011 ("Consultant Guidelines")}, ku theksohen politikat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesave.

Konsulentit do të zgjidhet në bazë të procedurës për zgjedhje të konsulentit individual në pajtim me procedurat për furnizime të Bankës botërore ("Consultant Guidelines").

Informacionet shtesë mund të merren në adresën e shënuar më poshtë në kohën e punës prej ora 08:30 deri 16:30.

Deklaratat për interesim në gjuhën angleze (letër për shprehje të interesit, CV dhe informacione/dokumente të tjera) duhet të parashtrohen në formë me shkrim në adresën e shënuar më poshtë (personalisht, përmes postës ose me e-mail) më së voni deri më 27.06.2018.

Ministria e arsimit dhe shkencës – Projekti për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve

Për: Danijela Maneva, menaxher për furnizime (për shpallje nr. 011-18)

rr. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, 1000 Shkup

Republika e Maqedonisë

e-mail: daniela.maneva@mon.gov.mk (CC: igor.krstevski@mon.gov.mk)

Në bazë të nenit 101 paragrafi 1 alineja 7 të Ligjit për mbrojtje sociale (Gazeta zyrtare e RM nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 72/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18), nenit 15 paragrafi 1 alineja 7, nenit 20 dhe nenit 21 të Statutit të IP qendra ndërkombëtare për punës sociale Kavadar, dhe Vendimit të Këshillit drejtues të sjellë në mbledhjen e mbajtur më datë 11.06.2018 ndërsa të shënuar me nr. 02-1110/7 të datës 11.06.2018, Këshilli drejtues i IP qendra ndërkombëtare për punës sociale Kavadar publikon:

SHPLLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të IP qendra ndërkombëtare për punës sociale Kavadar

- Kandidatët e interesuar krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj duhet të përbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - Te kenë të mbaruar arsimin sipëror shkalla e VII/1 e përgatitjes profesionale ose 240 kredi sipas SETK, të profileve arsimore në vijim: punëtor i diplomuar social, psikolog, pedagog, jurist, ekonomist, defektolog ose sociolog;
 - Të kenë minimum 5 (pesë) vjet përvojë pune pas diplomimit;
 - Të parashtrojnë program të përgatitur për udhëheqje të institucionit.
 - Posedim të një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: - TOEFL IBT së paku 74 pikë, - IELTS – së paku 6 pikë, - ILEC (Cambridge Englis: Legal) – së paku niveli B2, - FCE (Cambridge English:First) – të dhënë, - BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku niveli B2 dhe
 - Neto pagesa është **28.362,00** denarë.
- Kandidati duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me biografi të shkurtë;
 - Certifikatë të shtetësisë;
 - Certifikatë/Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - Dëshmi për arsimin e mbaruar përkatës sipëror – certifikatë ose diplomë;
 - Vërtetim për përvojë të punës pas diplomimit;
 - Dëshmi për posedim të certifikatës përkatëse të pranuar ndërkombëtarisht ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se 5 vjet dhe
 - Program për udhëheqje të Institucionit.
- Dokumentet parashtrohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.
- Shpallja publike zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.
- Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtuara pas afatit nuk do të merren parasysh.
- Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme të parashtrohen deri të Këshilli drejtues i IP qendra ndërkombëtare për punës sociale Kavadar në arkiv ose në adresën, rr. "JNA" nr. 11, Kavadar me shenjë (shpallje publike për zgjedhje të drejtorit).

VËREJTJE: Kandidati për Drejtor i cili do të zgjidhet për Drejtor deri më 01 shtator 2018 obligohet që të përbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes.

Drejtori i cili nuk do të përbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes, i ndërpritet mandati.

IP qendra ndërkombëtare

për punës sociale Kavadar

KËSHILLI DREJTUES

Kryetar

Vanja Velevski



Momenti që Shqipëria të ketë progres me reformat

Komisioneri Jonahes Hahn në një konferencë të zhvilluar në Vjenë nga FMN ka theksuar mbështetjen e tij për integrimin e vendeve të Ballkanit. Hahn bëri për herë të parë publike një datë për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. "Tashmë Shqipëria ka momentin të bëjë sa më shumë progres me Reformën në Drejtësi dhe me procesin e Vettingut. Vendet e Ballkanit dua t'i shohim në 2025 si anëtare të BE-së. Mund të gjykojmë si optimist nga disa për datën që e them sot këtu për herë të parë: por Ballkani është Europë", tha ai. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin dhe pjesëmarrës të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku Shqipëria përfaqësohet nga 4 deputetë mes tyre Ervin Bushati dhe Evis Kushi, si dhe anëtarë të parlamenteve të Kosovës, Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Konferenca do të zgjasë tre ditë do të trajtojë temat më të rëndësishme të politikës sot. Përveç sfidave të vendeve të Ballkanit perëndimor, në dy sesionet e tjera pritet të diskutohet për opsionet e politikave në luftën kundër korrupsionit në të gjitha format e saj, zhvillimet në ekonominë globale dhe të evropiane si dhe sfidat më të ngutshme të politikës aktuale.

DËSHMITARËT PO VDESIN, RREZIKOHET NDRIÇIMI I KRIMEVE TË LUFTËS NË KOSOVË

Krimet e luftës në Kosovë u hetuan nga mekanizma të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë, mirëpo pati shumë pak aktvendime dënuese. Mijëra vrasje, masakra dhe dhunime mbesin të pazbuluara edhe sot. Përveç numrit të madh të të vrarëve, të zhdukur mbesin ende mbi 1600 persona, për fatin e të cilëve nuk dihet gjë



Drenushë Ramadani është 23-vjeçare. Fëmijërinë e saj ajo e kaloi në fshatin Krushë e Vogël, në Komunën e Prizrenit, ku në vitin 1999, forcat paramilitare ia vranë babanë.

Deri me sot për këtë vrasje nuk është dënuar askush. "Unë vij prej fshatit Krushë e Vogël dhe dihet se masakra ka qenë shumë e madhe dhe prej 113 të vrarëve janë gjetur shumë pak persona. Ka ende të pagjetur. Institucionet e Kosovës gjatë kësaj periudhe kanë bërë shumë pak". "Krejt çka mund të bëjnë institucionet është që të kujdesën për fshatin që të mos harrohet ajo, qoftë me u kujtesë që t'i gjejnë të pagjeturit, qoftë për fëmijët e atyre të vrarëve që shumë pak janë kujdesur, si në kohën e pasluftës kur ata kanë qenë vegjël, si tash", thotë Drenusha për Radion Evropa e Lirë.

Ditën kur u vra babai i Drenushës, në këtë fshat u vranë 113 persona. Drenusha beson pak tek institucionet, mirëpo mbetet me shpresë se ato do të jenë në gjendje t'i gjykojnë vrasësit një ditë. "Nuk e di. Institucionet e Kosovës edhe 19 vjet pas luftës nuk kanë bërë gati asgjë, por besoj se dikur do të vendoset drejtësia dhe se do të përmirësohen shumë, si në hetime, si në gjithçka



Ditën kur u vra babai i Drenushës, në këtë fshat u vranë 113 persona. Drenusha beson pak tek institucionet, mirëpo mbetet me shpresë se ato do të jenë në gjendje t'i gjykojnë vrasësit një ditë

tjetër edhe do të zgjidhen shumë raste të të vrarëve në luftë", thotë ajo.

Derisa Drenusha mbetet me shpresë se një ditë do të ndëshkohen vrasësit e babait të saj, vetë zbulimi i krimeve të luftës po vështirësohet çdo ditë e më shumë. Bekim Blakaj nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë thotë se me kalimin e kohës po zbehen dëshmitë dhe po vdesin dëshmitarët.

"Gjasat secilën herë janë më të vogla që t'iu ofrohet drejtësi viktimave për shkaqe ndër më të ndryshmet, por një ndër shkaqet janë që edhe dëshmitarët, mosha e bënë

të vetën. Ne i kemi qysh tani disa dëshmitarë, pra të mbijetuar që tani nuk janë në jetë, kanë vdekur dhe provat e tjera zbehen pra. Është shumë më e vështirë që të procedohen lëndët për krimet luftarë, njëzetë vjet pas këtyre krimeve", thotë Blakaj. Blakaj thotë se me vet faktin pse ka kaluar kaq shumë kohë, vet dëshmitë e dëshmitarëve mund të ndryshojnë nga ato që ishin dhënë më parë.

Sipas tij, dëshmitarët "pa vetëdije i inkorporojnë në kujtesën e vet rrëfimet e dhëna nga të tjerët dhe pastaj provat e tyre para një gjykate nuk janë shumë kredibile". "Është në shpërputhje me një deklaratë që kanë dhënë shumë vite më parë ose me deklaratat e të tjerëve (dëshmitarëve të tjerë)", thotë Blakaj. Krimet e luftës në Kosovë u hetuan nga mekanizma të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë, mirëpo pati shumë pak aktvendime dënuese. Mijëra vrasje, masakra dhe dhunime mbesin të pazbuluara edhe sot. Përveç numrit të madh të të vrarëve, të zhdukur mbesin ende mbi 1600 persona, për fatin e të cilëve nuk dihet gjë.

THAÇI NË FORUMIN E MONTREALIT

EVROPA T'IA HAPË PORTAT BALLKANIT PERËNDIMOR

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se Ballkani Perëndimor asnjëherë nuk ka pasur rast më të mirë për të ndërtuar paqe të qëndrueshme. Këtë mesazh, presidenti e ka dhënë në panelin "Evropa në udhëkryq", në kuadër të Forumit Ekonomik Ndërkombëtar të Kontinentit të Amerikës (IEFA), që po mbahet në Montreal të Kanadasë.

"Sot, çdo shtet i Ballkanit Perëndimor komunikon normalisht me njëri-tjetrin, çdo shtet bashkëpunon me njëri-tjetrin. Duhet të shfrytëzohet ky momentum dhe BE-ja t'ia hapë portat Ballkanit Perëndimor", u shpreh Thaçi.

Ndërsa, duke folur për dialogun Kosovë-Serbi, presidenti i Kosovës ka thënë se ky dialog do të fillojë në ditët apo javët e ardhshme dhe do të jetë i vështirë. "Nuk do të jetë i lehtë, por do të jetë historik dhe është i pa alternativë. Dialogu duhet të përmbyllet me një rezultat 'win-win' edhe për Kosovën, edhe për Serbinë, sipas një marrëveshjeje me vlera e standarde evropiane", u shpreh presidenti.

"Edhe Kosova, edhe Serbia, aspiratë e kanë anëtarësimin në BE", u shpreh Thaçi, duke shtuar se "ky vullnet i njerëzve nuk mund të realizohet pa normalizim dhe pajtim në mes dy vendeve dhe popuj-

ve". "Pres rol udhëheqës dhe me një dinamikë të re nga Bashkimi Evropian dhe mbështetje të fuqishme të SHBA-së, që ky proces të përmbyllet suksesshëm, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në të mirën e të gjithëve. Kosova është gati për dialog, për marrëveshje, sepse vetëm kështu do të mund të lëvizim të sigurt drejt NATO-s dhe Bashkimit Evropian, si dhe të ruajmë marrëdhënien speciale me SHBA-në dhe partneritetin me miqtë e tjerë. Vetëm një Kosovë dhe një Serbi evropiane mund të perëndimozojnë rajonin", u shpreh presidenti Thaçi. Duke folur për zhvillimet në BE, presidenti Thaçi



theksoi se ndonëse është e vërtetë që Bashkimi Evropian po përballlet me kriza dhe sfida që e prekin vetë identitetin e BE-së, megjithatë

qytetari evropian po tregon se më shumë se çdo ideje tjetër ende i beson idesë së integritetit dhe bashkimit.



Havzi Nelës i ngrejtnë bust në Kukës

Në një ceremoni zyrtare të Bashkisë Kukës, u vendos busti i Havzi Nelës në oborin e gjimnazit të qytetit që mban të njëjtin emër. Havzi Nela u burgos në vitin 1987 dhe më 10 gusht të vitit 1988 u var në qendër të qytetit të Kukësit në muajt e fundit para se regjimi të shembet pas dënimit me vdekje nga një trupë gjykatësish komuniste. Persekutimi i tij nisi në vitin 1967 kur kundërshtoi kolektivizimin, ndalimin e besimit fetar dhe ndërrimin e veshjeve për gratë e fshatit. Havzi Nelës i është akorduar titulli "Martir i Demokracisë" dhe "Nderi i Kombit". "Falë tij, Kukësi është në hartën e botës si qytet i poetit të varur. Kukësi tashmë përveçse qytet i mikpritjes së madhe dhe kandidat për Nobel në 1999, është edhe qytet i poetit të varur në litar në emër të lirisë, të fjalës së lirë", u shpreh Bashkim Shehu, Kryetar i Bashkisë Kukës.

Vjen vëllimi i katërt i Elena Ferrantes, "Historia e vajzës së humbur"

Botimi i parë i sagës së Elena Ferrantes u shoqërua me enigmën e anonimatit. Kush ishte kjo grua që i përfshiu lexuesit shqiptarë në një botë kaq të ngjashme me atë që po jetonim? Faqe pas faqe, të gjithë harruan të zbulonin kush fshihej pas këtij pseudonimi dhe gjithnjë e më shumë u përfshinë në historinë e dy heroinave të sagës.



Kështu nisi lexuesi të priste me ankth edhe vëllimin tjetër. Po çfarë e bën këtë sagë kaq të vlerësuar nga kritikët? Cili shtet do të duhet të kandidojë Ferranten për çmimet në letërsi, kur ajo nuk pranon të jetë as më pak e as më shumë se Elena?

Ishte lajmëruar që vëllimi i katërt, "Historia e vajzës së humbur", të vinte në nëntor, por lexuesit nuk prisnin aq.

Ndaj botuesja zgjodhi ta prezantojë në panairin e Prishtinës, duke përmblytur kështu një sagë, çka është një zgjedhje klasike e vështirë që zgjedhin shkrimtarët të bëjnë sot.

RAMADAN REXHEPI FITON ÇMIMIN 'BEQIR MUSLIU'

Juria profesionale për përzgjedhjen e fituesit të Çmimit letrar "BEQIR MUSLIU" për vitin 2018, në përbërje: prof. dr. Labinot Berisha, studiues i letërsisë, Emin Azemi, poet, kritik letrar e botues si dhe Sabit Rrustemi, shkrimtar e drejtues i Ars Clubit "Beqir Musliu" me seli në Gjilan, pas disa konsultave dhe dy takimeve vlerësuese të propozimeve të arritura, në fund, njëzërit VENDOSI që fitues i Çmimit letrar "Beqir Musliu" për vitin 2018, të jetë tregimtari, romansieri, autori i dramave, publicisti dhe veprimtari i shquar i mërgatës shqiptare që jeton e vepron prej më se gjysmë shekulli në Suedi, shkrimtari preshevar nga Kosova Lindore, Ramadan REXHEPI.

Shkrimtari Ramadan Rexhepi (1940) nga viti 1963 e deri më sot botoi disa vepra letrare e publicistike që dëshmojnë për një krijimtari të vijueshme dhe cilësore.

Më 1963 botoi në Prishtinë veprën me tregime dhe novela "Kumbonaret", që jo vetëm ishte njëra nga përmbledhjet më cilësore në letërsinë tonë në kohën kur u botua, po si e tillë mbetet edhe sot e gjithë ditën.

Po atë vit, duke e ndjerë thellë shtypjen dhe dhunën e shtuar ndaj shqiptarëve, që ushtrohej përmes aparatit të shtetit në periudhën famëkeqe të Rankoviçit, Ramadan Rexhepi u detyrua ta braktisë punën si gazetar i "Rilindjes" dhe ta lëshojë vendlindjen



e tij e Kosovën, të emigronte në shtetet e Perëndimit, duke gjetur strehim në Suedi, ku jeton e krijon edhe sot.

Në Suedi, ai për një kohë të gjatë ishte kryeredaktor i revistës "Qëndresa" dhe për shumë vite kryetar i Bashkimit të shoqatave shqiptare në Suedi.

Gjatë periudhës 1985–1990 me forca të veta e udhëhoqi emisionin "Radio Zëri i Kosovës" në Suedi.

Dhuntia e lindur për të shkruar, e përçollli vijimisht dhe pena e tij nuk pushoi as në Suedi, përkundër mungesës së kontakteve aktive me miqtë krijues që kishin mbetur në Kosovë si dhe letërsia që shkruhej e botohej për më se tri dekada.

Vetëm pas viteve '90-ta të shekullit të kaluar, Ramadan Rexhepi do të rivendosë lidhje me vendlindjen e tij, Preshevën, po dhe me Kosovën, ku edhe i kishte shpërfa-

qur vlerat e para letrare përmes tregimeve të botuara fillimisht në revistën JETA E RE, e më pas edhe si libër me titullin KUMBONARET, ku bashkë me Anton Pashkun, vunë themelet e një letërsie moderne shqipe që po krijohet në Kosovë.

Në vitin 1991 Ramadan Rexhepi botoi në Suedi romanin satirik – tragjik, "Dilemat e Emrush Dokos" dhe më 2010 në Prishtinë romanin "Stina e emrave të bukur", të cilin kishte nisur ta shkruante qysh në vitin e largët 1967 me titull UDHËKRYQI, roman që

e dëshmon thellësisht atë si prozator të vlerave të ngritura e të qenësishme poetike.

Këto dy romane, si dhe tregimet dhe novelat të botuara qysh më 1963, mbetën në margjina, qoftë nga mungesa e gjatë e autorit në jetën letrare në Kosovë, nga mungesa e gatishmërisë së studiuesve të letërsisë për t'iu qasur dhe vlerësuar veprat e tij, qoftë dhe nga xhelozia ndaj vlerave të mëdha letrare që përligjin veprat e tij.

Mbështetur në vlerat e mirëfillta letrare të përfutura dhe të botuara nga shkrimtari Ramadan Rexhepi, që dëshmohej, si u tha, me përmbledhjen e tregimeve dhe novelave dhe me dy romanet e përmendura, juria ia jep Çmimin letrar "Beqir Musliu" për vitin 2018 për gjithë punën e madhe krijuese poetike, sidomos me veprat në fushën e prozës, me të cilate pasuroi dhe e lartësoi letërsinë shqipe. (RAJONIPRESS)

Pseudonimi me të cilin Faik Konica shkroi dy romane

Profilit të poliedrik të Faik Konicës i është shtuar edhe një dimension i panjohur, ai i një prozatori, autor romanesh. Kjo pasi që studiuesi Fotaq Andrea, ka zbuluar dy romane të panjohura të Faik Konicës, të cilat ai i kishte shkruar në gjuhën frënge.

Të botuara në një vëllim dhe me pseudonimin Gjoni i Krujës, këto dy romane janë përkthyer po nga Fotaq Andrea. I ftuar në emisionin CODEX të KTV-së, botuesi i tyre Krenar Zejno, ka thënë se ky lajm do të duhej të bënte shumë më shumë bujë dhe të merrte më shumë vëmendjen e publikut. "Martesa e Lejlës" dhe "Sotiri dhe Mitka" janë titujt e këtyre dy romaneve të Faik Konicës, alias Jean de Kroia.

Në një shkrim mbi këto vepra të panjohura vetë Fotaq Andrea shkruan: "As më shumë e as më pak: ja sot, të studiuara dhe përkthyer, pas 115 vjetësh dy romane të reja të Faik Konicës, të shkruara drejtpërdrejt në frëngjisht dhe të nënshkuara "Jean de Kroia" apo në shqip "Gjoni i Krujës", një tjetër pseudonim i tij i ri.

Kur tashmë, artikulli e parë në moshën njëzetvjeçare (1895) ai e nënshkruante "Te-peleni" në gazetën qendrore të Parisit "La libre Parole", kur librin "Sur l'Education – 1898" (Mbi Edukimin) e firmoste "Trank Spirobeg" dhe kur në kryeveprën e tij "Essai sur les langues artificielles et naturelles –

1904" (Sprovë për gjuhët natyrale dhe artificiale) do të përdorte pseudonimin "Phyrus Bardyli". Romanet, që duhet të jenë shkruar në vitin 1909, në bazë të një analize të fakteve, janë botuar në vitin 1911, në Paris, në një vëllim të vetëm, me titullin përmbledhës "Le mariage de Leila" (Martesa e Lejlës), shtypur nga një shtypshkronjë e vogël, gjë që shpjegon edhe tirazhin e saj tepër të kufizuar, aq sa edhe Biblioteka Kombëtare e Francës, nga më të pasurat në botë, nuk e disponon një libër të tillë me tematikë të mirëfilltë shqiptare!

Është e vërtetë se zbulimet koniciane këto kohët e fundit kanë qenë të konsiderueshme, dhe dëshmon për këtë edhe libri ynë i ri "Faik Konica – Përlindësi Modern" që shoqëron si binom botimin më vete të këtyre dy romaneve të Konicës, të konsideruara tashmë nga studiues seriozë si "perla të Letrave shqipe". Krejt studimi ynë hyrës prej 100 faqesh libri vërteton katërçpërisht, me analizë të hollësishme historike, letrare, epistolare e dokumentare, se këto dy romanet të reja të Konicës mbajnë shtampën e tij të padiskutueshme identitare. Sepse sot, me mundësitë e mëdha që dhuron vetë shkencë analitike, ekziston një "skaner dhe skaninim" për të zbuluar fijet dhe indet më të padukshme të një veprë, qoftë letrare, qoftë tablo pikturë, qoftë çdo vepër tjetër arti-

stike, e porositur, tjetërsuar, përvetësuar, shitur a më në fund, thjesht vjedhur.

Të gjitha këto përbëjnë në shfaqjen e tyre të çuditshme vetë kompleksitetin e një prej enigmave mbushulli à la Faikio pasqyruar në këto dy romane me nënshkrimin aq domethënës Gjoni i Krujës. Gjoni i Krujës. Një pseudonim i ri i Konicës, rilindësit gjeni, të paparit e të paarritshmit personalitet poliedrik në krejt fushat e Mendimit modern shqiptar, të përparuar e proferëndimor. Kur asnjë shqiptar i kohës së tij, dje e sot, nuk arriti e nuk arrin të shkruajë, si Konica – dhe drejtpërdrejt në gjuhë të huaja – , Vepra madhore me tematikë ndërkombëtare, duke iu përgjigjur flakë për flakë kërkesave të intelektualitetit evropian!

Kur asnjë shqiptar nuk zotëronte e nuk zotëron erudicionin e tij brilant cilësuar nga epokali Apollinaire si "Enciklopedi lëvizëse", si "Gjigand Argus e Briare", me njëqind palë sy dhe njëqind palë krahë! Kur zotëronte me themel 16 gjuhë të huaja, nga më të lashtat deri te më modernet, dhe kur përkthente e botonte te Kryevepra "Albania" nga të parët rilindës tekste historike, filozofike, sociologjike, folklorike, për të hedhur themelet e albanologjisë moderne dhe të shkencave shoqërore, sa në shqip, aq edhe në frëngjisht për lexuesin e huaj", shkruan Andrea.

ZEKIRJA RAMADANI FLET PËR FILLIMIN E PËRGATITJEVE VERORE

GJENDJA FIZIKE DUHET TË PËRMIRËSOHET GJATË KËSAJ KOHE

“Kemi filluar punën me 6 qershor dhe në këtë periudhë do punojmë në aspektin fizik e taktik, por normal gjendja fizike duhet të përmirësohet gjatë kësaj kohe. Pikërisht për këtë shkak dhe stërvitjet janë me ngarkesa fizike, kur prej sot kemi filluar të shfrytëzojmë edhe fitnesin për forcë”, thotë trajneri Ramadani



Shkup, 12 qershor - Skuadra e FC Shkupit ka rritur ritmin e përgatitjeve dhe futbollistët do të fillojnë të ndjejnë “dhimbjet” më shumë, pasi sipas paralajmërimeve nga stafi i trajnerëve, tani është koha që të punohet më shumë në përmirësimin e gjendjes fizike. Me skuadrën janë bashkuar të gjithë futbollistët që kishin më shumë pushim shkaku i angazhimeve të ndryshme, pra në ekip janë grumbulluar, Rron Broja, Bllazhe Ilijoski, Stefan Vujçiç, Bllagoja

Ljamçevski, ndërsa nga e mërkura vijjnë edhe Basilio Ndong dhe Mariano Ondo. Për punën që është bërë deri më tani dhe atë që pritet ditëve në vazhdim, kemi biseduar me trajnerin e skuadrës, Zekirja Ramadani “Kemi filluar punën me 6 qershor dhe në këtë periudhë do punojmë në aspektin fizik e taktik, por normal gjendja fizike duhet të përmirësohet gjatë kësaj kohe. Pikërisht për këtë shkak dhe stërvitjet janë me ngarkesa fizike, kur prej sot kemi filluar të shfrytë-

zojmë edhe fitnesin për forcë”, ka thënë trajneri Ramadani, i cili ka komentuar edhe për adaptimin e dy futbollistëve që sapo janë bashkuar me skuadrën. “Mendoj që të dy futbollistët që sapo kanë nënshkruar dhe u janë bashkuar menjëherë përgatitjeve me ekipin, nuk do ta kenë aspak problem përshtatjen, ata janë djem të mirë dhe futbollist të mirë. E sidomos flas për Muaremin, i cili as që do ta ketë problem përshtatjen, për faktin se është kthyer në shtëpinë e

tij” tha Ramadani. Në fund Ramadani ka folur edhe për fazën përgatitore, e cila do të zgjasë në Shkup deri më 20 qershor. “Jemi në kërkim të një ndeshje kontrolluese deri më 20 qershor. Më pas ekspedita jonë me 21 qershor do të udhëtojë për Turqi, ku do të vazhdojmë përgatitjet në Bollu”, përfundoi trajneri Zekirja Ramadani, i cili shpreson se ekipi i tij do të kompletohet me të gjitha përforsimet e pritura deri në nisjen e skuadrës për në Turqi.



Torino nuk e do Ajetin

Ajo, që është përfolur nga mediat, është bërë zyrtare edhe nga klubi. Torino nuk ka vend për Arlind Ajetin. Mbrojtësi i Kombëtares, i cili luajti i huazuar te Krotone gjatë këtij sezoni, ka përfunduar kontratën dhe skuadra e rënë nga kategoria nuk e shfrytëzoi të drejtën e blerjes së kartonit. Në këto kushte, Ajeti mbetet një futbollist i torinezëve. Mediat pranë klubit kanë bërë me dije se Torino ka marrë vendim që të mos e rikthejë në skuadër qendërmbrojtësin shqiptar. Javën e ardhshme pritet që Ajeti dhe menaxheri i tij të takohen me drejtuesit e klubit. Këta të fundit janë në pritje të ofertave dhe të zgjidhjes së të ardhmes për shqiptarin.

TRATATIVAT ME FEKIRIN DREJT DËSHTIMIT Liverpooli hedh sytë nga Shaqiri

Drejtuesit e Liverpoolit po shikojnë mundësi të reja në merkato. Bisedimet me Nabil Fekir nga Lioni nuk shkuan siç pritej, dhe kanë mbetur pezull pasi francezët pretendojnë shumë. Shtypi anglez raporton se alternative e Fekir është Xherdan Shaqiri. Sipas “Mirror”, 26 vjeçari mund të blihet për 13.5 milionë sterlina dhe ky operacion mund të përfundojë pas Botërorit. Sipas “The Mirror”, Liverpooli do të vazhdojë me negociatën pas Botërorit, pasi aktualisht lojtari është në Rusi me kombëtaren e Zvicrës. Cekim, këtë verë, ekipi anglez ka transferuar Naby Keitan e Laipzigut dhe Fabinjon e Monakos.



SHORTI NË LIGËN E KAMPIONËVE DHE LIGA EVROPË

Drita dhe Prishtina mësuan kundërshtarët

Shkup, 12 qershor – Dje në Nion të Zvicrës u hodh shorti për raundin preliminar të Ligës së Kampionëve. Kampionët e Kosovës, Drita e Gjilanit, do të ndeshen me homologët e Andorrës, FC Santa Koloma, ndërsa Fiorita e San Marinos do të përballen me Linkoln Red Imps të Gjibraltarit. Ky raund paraprak është një mini-turne, që do të luhet në një vend, dhe përbëhet

nga gjysmëfinalët dhe një finale (të gjitha ndeshjet e njëhershme). Turneu i këtij sezoni do të zhvillohet në stadiumin “Victoria”, në Gjibraltar. Fituesit e raundit në fjalë hyjnë në raundin e parë kualifikues, që do të luhet më 10/11 dhe 17/18 korrik, me kundërshtarët e tyre, që do t'i mësojnë nga shorti i datës 19 qershor. Tri ekipet humbëse transferohen në

raundin e dytë kualifikues të “Europa League”. Raundi gjysmëfinal luhet më 26 qershor, ndërsa ai final më 29 qershor. Sipas sistemit të ri të konkurrencës, kampionët e katër kombeve më të ulëta, të renditur në vitin 2017 në UEFA (Gjibraltar, Andorra, San Marino dhe Kosova) marrin pjesë në raundin paraprak. Në anën tjetër është hedhur shorti për raundin pareli-

minar të Ligës së Evropës, ku merr pjesë edhe Prishtina, si fituese e Kupës së Kosovës. “Goglat” u treguan bujare me skuadrën e drejtuar nga trajneri Mirel Josa, sepse e ka vënë përballë një rivali nga Gjibraltari. Bëhet fjalë për skuadrën “Evropa”. Në fushën e kësaj të fundit do të luhet ndeshja e parë, më 28 qershor, ndërsa kthimit në Kosovë, më 5 korrik.

KUQEZINJTË VAZHDOJNË ME PËRGATITJET

Nga sot me nga dy seanca stërvitore në ditë

Shkup, 12 qershor – Ka përfunduar pushimi 17-të ditor i kuqezinjve, pasi ekipi kishte grumbullimin e parë për të shënuar startin e përgatitjeve verore. Në atmosferë të shkëlqyeshme pas sezonit të kaluar historik ku Shkëndija fitoi kampionatin dhe Kupën, futbollistët duken të determinuar për të vazhduar të kërkojnë sfida të reja fillimisht në eliminatoret e “Champions League” dhe më pas edhe në sezonin e ri të garave vendore. Ashtu si në vitet e kaluara edhe tani në ditët e para futbollistët do të kryejnë matjet



e nevojshme parasezonale për të vlerësuar gjendjen momentale të secilit, për të ndjekur më pas në

vazhdimësi progresin që do të arrihet gjatë fazës përgatitore. Të hënën dhe të martën ekipi ka

qenë i ndarë në dy grupe ku ka kryer testimet mjekësore në një ordinancë profesionale në Prishtinë, ndërsa nga e sot (e mërkurë) nis puna me nga dy seanca stërvitore në ditë. E premtja parashihet ditë e lirë për shkak të festës së Bajramit, ndërsa nga e shtuna pritet ngritja e tempit dhe ngarkesës në stërvitje. Prej 20 qershor deri më 2 korrik ekipi do të qëndrojë në Rogashka Sllatina të Sllovenisë ku do të zhvillohet faza kryesore përgatitore, ndërsa janë paraparë tre deri katër ndeshje kontrolluese.

REAL MADRID KËRKON PORTIER

NAVAS “KËRCËNON” ME GJUHËN E TIPOZËVE



Unë jam një lojtar i Real Madridit dhe kam kontratë deri në vitin 2020. Gjithmonë kam thënë se jam shumë i lumtur te Real Madridi dhe shpresoj që, nëse dëshiron Zoti, mund të dal në pension në këtë klub. Jam shumë i lumtur në këtë klub, me qytetin dhe e shokët e skuadrës, kështu që mendja ime është vetëm te Real Madridi. Dua të vazhdoj ta shijoj këtë ekip të madh”, pohon Navas

Kejlor Navas pretendoi mbështetjen e tifozëve të Real Madridit, ndërsa deklaroi synimin e tij për t'i dhënë fund karrierës së tij në “Santiago Bernabeu”. Portieri i Kosta Rikës ka qenë zgjedhja e parë e Real Madridit në tri sezonet e fundit, duke e ndihmuar Zinedin Zidane në fitimin e tre titujve radhazi të Ligës së Kampionëve dhe La Ligan në sezonin 2016-2017. Largimi i Zidanit në fund të sezonit 2017-2018 ka krijuar dyshime mbi pozicionin e Navas, por ai tha për “Marca” se tifozët e klubit e mbështesin atë për të qëndruar. “Mirësia që tifozët më tregojnë gjatë gjithë kohës është e pabesueshme dhe jam shumë mirënjohës për të gjithë ata, —tha 31-vjeçari.— Cilado qoftë situata sportive, ata janë gjithmonë prapa meje. Në stadium dëgjoj gjithmonë thirrjet dhe mbështetjen e tifozëve, që më motivojnë shumë. Edhe kur kaloj rrugës në Madrid, gjithmonë vijnë tek unë dhe më tregojnë mbështetjen e tyre. Ata më thonë: mos ikni,

ne të duam ty! Unë jam një lojtar i Real Madridit dhe kam kontratë deri në vitin 2020. Gjithmonë kam thënë se jam shumë i lumtur te Real Madridi dhe shpresoj që, nëse dëshiron Zoti, mund të dal në pension në këtë klub. Jam shumë i lumtur në këtë klub, me qytetin dhe e shokët e skuadrës, kështu që mendja ime është vetëm te Real Madridi. Dua të vazhdoj ta shijoj këtë ekip të madh”.

Navas pranoi se ishte i befusuar nga lajmi i largimit të trajnerit Zidane nga Real Madridi pas tri sezonesh të ngarkuara me trofe: “Kur mori vendimin trajneri, unë isha tashmë në Kosta Rika. Ishte një surprizë për mua, të jem i ndershëm. Do t'i jem gjithmonë mirënjohës Zidanit, në çdo moment ishte me mua, në kohët e mira, që gëzonim së bashku. Ai më jepte këshilla dhe gjithmonë më mirëpriste me buzëqeshje. Kjo sjellje e trajnerit përcjell besim te lojtarët, i përmirëson ato”, përfundoi Navas.

Deshamp zbulon të ardhmen e Grizmann

Trajneri francez, Didier Deschamps, zbuloi një pjesë të së ardhmes në rang klubi të Antoine Grizmann. Ai ishte i qartë: sulmuesi i Atletico Madrid po qëndron në Spanjë. Grizmann pritet të njoftojë të ardhmen e tij para se të fillojë Kampionati Botëror, konkretisht ndeshja e parë e “Les Bleus” kundër Australisë, të shtunën. 27-vjeçari është i lidhur me një lëvizje drejt kampionëve të La Ligan, por mund të mbetet ende tek Atletico Madrid. Ndërkohë,

Manchester Junajted ishte i lidhur ngushtë me Grizmann verën e kaluar, me disa raporte që tregonin se interesi i “Djajve të Kuq” është rikthyer edhe këtë vit. Megjithatë, Deschamps duket se i dha fund diskutimit për një lëvizje në Angli, siç tha ai në një konferencë për shtyp, duke saktësuar se sulmuesi do të qëndrojë në Spanjë. “Flitet shumë për të ardhmen e Grizmann dhe Nabil Fekir”, —tha Deschamps para gazetarëve.— Nuk është një situatë ideale, por

gjithsesi nuk do të na shpërqendrojë. Antoine Grizmann do të mbetet në Spanjë, kjo është aq shumë e qartë, ndaj nuk ka pse shqetësohet”. Ndryshe, Barcelona thuhet se është gati të paguajë klauzolën e lirim të Grizmann prej 100 milionë eurosh. Megjithatë, lëvizja nuk është ende e sigurt dhe presidenti i La Ligan deklaroi besimin e tij këtë javë që të dy, Grizmann dhe Cristiano Ronaldo, do të mbeten në klubet spanjolle edhe sezonin e ardhshëm.

ROMA MPOSHTI BARCELONËN DHE MANÇESTER JUNAJTEDIN

Rrëmben talentin holandez Klaivert

Transferimi i Xhaatin Klaivert te Roma u afrua një hap më tepër të hënën, pasi holandezi fluturoi në kryeqytetin italian. Djalooshi 19-vjeçar, i biri i ish-sulmuesit të njohur holandez, Patrik Klaivert, ka tërhequr shumë interes, pas një sërë shfaqjesh mbresëlënëse me Ajaksin. Manchester Junajted dhe Barcelona kanë qenë shumë të lidhur me adoleshtin e talentuar, pasi panë një përplasje të verës për nënshkrimin e tij. Roma, megjithatë, duket se e ka fituar garën për të siguruar shërbimet e tij, me klubin kryeqytetas italian që transmeton pamjet video në mediat sociale të lojtarit, që po vjen në Romë. Klaivert mbajti një shall të klubit verdhekuq dhe nënshkroi autografe për



përkrahësit, pasi u përshëndet nga një turmë e madhe, përpara një klinike mjekësore. Klubi i Seria A do të paguajë 18 milionë euro për ta shtyrë marrëveshjen, duke e bërë atë nënshkrimin e katërt të kësaj vere, pas

marrjes së Kristante, Ante Çoriç dhe Ivan Marcano. Klaivert, i cili bëri debutimin e tij me Holandën në mars, duke ardhur nga bankina në një fitore në miqësore, 3-0 kundër Portugalisë, shënoi 10 gola dhe dha pesë asistime në sezonin 2017-2018, në “Eredivisie”. Klaivert ishte paralajmëruar që të mos largohej nga Ajaksi në fillim të zhvillimit të tij, ndërsa babai Patrik i tha “Ole”: “Personalisht i thashë se ndoshta është më mirë të qëndrosh një vit më shumë tek Ajaksi, të bësh disa kilometra, të jesh i rëndësishëm për ekipin. Ai është 19 vjeç, është ende i ri, por i merr vendimet vetë. Si baba duhet të qëndroj pas të gjitha vendimeve të tij”, deklaroi Patrik.



Pjaniç rinovon me Juven deri në vitin 2023

Massimiliano Allegri tani mund të marrë frymë lirisht, sepse “truri” i bardhezinjve, Miralem Pjanic, ka vendosur të rinovojë kontratën me Juventusin. Marrëveshja e re e mesfushorit boshnjak me kampionët e Serisë A do të jetë e vlefshme deri më 30 qershor të vitit 2023. 28-vjeçari prej kohësh është vënë në shënjestër të klubeve të mëdha, por Juventus po e blinon për një rinovim kontratë nga e cila mesfushori do të përfitojë 6 milionë euro neto në sezon, teksa paga e tij aktuale është 4,5 milionë. Pjanicit i skadonte kontrata në vitin 2021, me PSZH, Manchester Junajted, Real Madrid dhe Barcelonën që shpresonin ta bënin pjesë të organikës së tyre, po me këtë lëvizje të fundit të Juventusit duhet të ndryshojnë objektivat, ose t'i ofrojnë ekipit italian një shumë të pazezistueshme për kartonin e tij.



Sterling refuzon rinovimin e kontratës

Raheem Sterling dhe Manchester Siti nuk kanë arritur një marrëveshje mbi rinovimin e kontratës. “Sky Sports” ka zbuluar se dy palët janë shumë larg njëra-tjetres dhe se nuk janë planifikuar takime të tjera në këtë moment. Ai i kaluar ka qenë një nga sezonet më të mira të 23-vjeçarit, i cili ka shënuar 23 gola në të gjitha kompeticionet për Siti. “Qytetarët” shpresonin të arrinin një marrëveshje para fillimit të Kupës së Botës, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Në muajt e kaluar, Siti ka rinovuar kontratat me disa lojtarë kyç të ekipit, duke përfshirë këtu Kevin De Bruine, Fernandinjo, David Silva dhe Nikolas Otamendi. De Bruine do të përfitojë 397.000 euro në javë nga kontrata e re 6-vjeçare, e nënshkruar janarin e kaluar, ndërsa Sterling, i cili është në vitin e tij të fundit të kontratës, fiton gjysmën e asaj shume. Menaxherët e yllit të Anglisë kërkojnë që Sterling të paguhet sa yjet e tjerë të ekipit.

TIAGO SILVA FLET PËR "GOAL"

KANË SHUMË HISTORI KËTO PESË YJE, FANELLA E BRAZILIT ËSHTË NDRYSHE



Së bashku me Gjermaninë, Brazili është përsëri një nga favoritët e Botërorit të Rusisë, që starton të enjten, dhe qendërmbrojtësi i PSZH-së është optimist se rezultati përfundimtar do të jetë i ndryshëm nga katër vite më parë. Për të, Brazili i ka të gjitha mundësitë që të nënshkruajë fitoren e gjashtë të turneut të Kupës së Botës

Tiago Silva pretendon se Brazili ka mësuar nga humbja e tij poshtëruese 7-1 me Gjermaninë, në Kupën e Botës 2014, dhe do ta përdorë atë dështim për të frymëzuar fitoren në turneun e ngjashëm të kësaj vere. Mbrojtësi u pezullua për atë lojë, katër vjet më parë, teksa Brazili u eliminua nga Kupa e Botës para tifozëve të vet, duke humbur me fituesit e më pastajmë dhe thyer rekordin e tyre ndërkombëtar për shumicën e golave të pësuar në një ndeshje të vetme, në proces. Së bashku me Gjermaninë, Brazili është përsëri një nga favoritët e Botërorit të Rusisë, që starton të enjten, dhe qendërmbrojtësi i PSZH-së është optimist se rezultati përfundimtar do të jetë i ndryshëm nga katër vite më parë. Për të, Brazili i ka të gjitha mundësitë që të nënshkruajë fitoren e gjashtë të turneut të Kupës së Botës. Lideri i mbrojtjes pranon se "Selecao" është rritur që nga ajo humbje dhe se qëllimi i tyre është të përfundojnë si kampionët e botës, edhe një herë. "Çdo ditë mëson diçka të re, profesionale, personale dhe madje edhe emocionale, sepse aspekti emocional është kaq i rëndësishëm", - tha Silva për "Goal". "Shumë herë ne përpiqemi ta ndryshojmë, por nuk mundemi. Personalisht nuk dua ta ndryshoj, por më mirë që të gjitha ndodhin natyrshëm. Gjërat kanë ndodhur mirë apo keq, por natyrisht. Jo të gjithë i meritojnë lotët tanë. Duhet të bëni të drejtin, edhe nëse dikush tallet me ju. Unë rrallë ndryshoj mendimin tim për atë që be-

soj, por mësimi është i madh, pas të gjitha gjërave që kanë ndodhur nga viti 2014. Shpresojmë që viti 2018 mund të jetë ndryshe për Silva dhe ekipin kombëtar të Brazilit. Qëllimi ynë përfundimtar është të jemi kampionët e botës, por ka një rrugë të gjatë përpara, për të luajtur një Kupë Bote të madhe dhe ta përfundojmë atë në mënyrën më të mirë të mundshme: me trofeun", vazhdon Silva.

Duke debutuar në vitin 2008, Botërori i kësaj vere do të jetë i treti për Silva, por në vitin 2010, ai u detyrua ta shikonte kompeticionin nga bankina, pasi Brazili arriti deri në fazën çerekfinale. Ai i udhëhoqi të tijtë në Kupën e Konfederatave të vitit 2013, por pezullimi me kartonë të verdhë i shkaktoi humbjen e gjysmëfinale vendimtare me Gjermaninë. Thiago tani ka 70 ndeshje me kombëtaren e vendit të tij, por ndihet jashtëzakonisht krenar, sa herë që mban shiritin e dallueshëm në uniformën e verdhë.

"Fanella e Brazilit është ndryshe, ky është një moment unik. Jo çdo lojtar mund ta veshë këtë fanellë, - shtoi ai. "Shumë prej futbollistëve brazilianë kanë talentin për të luajtur këtu, gjë që e bën konkurrencën edhe më të vështirë, kështu që duhet të bëni diçka sh-

tesë për ta veshur këtë fanellë. Ka histori, përgjegjësi në këto pesë yje, kështu që gjithnjë duhet të bëni diçka shtesë për mbi 200 milionë njerëz në Brazil. Çdo ditë ne shkojmë në limitin tonë për ta nderuar Brazilin". Ai kujton se si ka nisur të luajë futboll në rrugë deri te gëzimi për fitimin e Kupës së Botës 1994, pasi Brazili e ngriti trofeun e tij të katërt me një fitore 3-2 kundër Italisë, pas një barazimi të parëndësishëm në "Rose Bowl". "Gjëja e parë që më vjen në mendje është Kampionati Botëror 1994, - pranon Tiago Silva. - Ne kemi pasur një duet të mrekullueshëm sulmues me Bebeto dhe Romario, ndeshja finale është një kujtesë e fortë, kur Roberto Bagjo humbi penalltinë. Ky është një kujtim, si pjesë e fëmijërisë sime. Më kujtohet që do të luaja në rrugë me miqtë, ndonjëherë edhe zbathur. Do të kthehesha në shtëpi me këmbë të lëndueshme, por doja të bëja të njëjtën gjë një ditë më pas. Ky pasion na bëri të vazhdonim të luanim. Luajtja futboll ishte gëzimi ynë i përditshëm". Thiago Silva shpreson që Brazili mund të sjellë gëzim të ngjashëm te njerëzit në shtëpi, kur ata të nisin fushatën e tyre në Kupën e Botës së Rusisë, më 17 qershor, kundër Zvicrës.

Fotografohet me Sallahun për të pastruar imazhin



"Ylli" i Egjiptit, Mohamed Sallah, u gjend krejt papritur në qendër të polemikave pas publikimit të disa fotove ku ai shfaqet përkrah liderit çeçen pro-rus, Ramzan Kadyrov, një personazh kontravers, për të cilin ka akuzat të rëndë për ekzekutime pa gjyq, zhdukje të homoseksualëve në Çeçeni dhe për çështje të tjera që lidhen me mosrespektim të drejtave të njeriut. "Faraoni" ndodhej në hotel kur e njoftuan se një njeri i rëndësishëm kishte ardhur për ta takuar dhe po e

priste në hollë. Pasi e takoi dhe pa që shoqërohej nga një numër i madh njerëzish të besuar, ai u bind që të shkonte në stadiumin e Groznit për një shëtitje të shkurtër. Kadyrov e shfrytëzoi disponibilitetin e Sallah për të shkrepur disa foto, që më pas bënë xhiron e botës brenda pak minutash. Imazhet e Sallah përkrah Kadyrov konsiderohen një tentativë e liderit, që mbështetet nga Rusia, për të pastruar imazhin e tij prej vrasësi dhe dhunuesi të drejtave të njeriut.

PROBLEME PËR KRISTIANO RONALDON "Adidas" shpenzon miliona euro për ta ndalur

Ekspertët e "Adidas", kompania e famshme e veshjeve sportive, mendojnë se kanë zbuluar sekretin për të ndalur goditjet e dënimit të Cristiano Ronaldos. Cili është sekretin? Topi i ri i botërorit. "Telstar 18" është dizajnuar që të mos ketë sa më pak ndryshime të drejtimit të jetë e mundshme. Kjo duhet të ndihmojë portierët në Rusi, por jo lojtarët si Ronaldo, i cili është një ekspert në goditjet e dënimit. "Adidas" ka shpenzuar tre vite dhe miliona euro për krijimin e atij që besohet të jetë topi më perfekt i përdorur ndonjëherë në futboll. Panelet e topit, i cili është bazuar te modeli i sferës së përdorur në Meksikë 1970-të, janë krijuar për të limituar ndikimin e ajrit pasi ai goditet. Gjithashtu, topi është vënë në provë nga një makineri goditëse në zyrat e "Adidas" në Gjermani, duke bërë goditje që kanë arritur deri në 55 kilometra në orë.




DASHI 21. mars - 20. prill

Ruajtja e qetësisë në këtë moment nuk do të jetë e lehtë, sidomos nëse e keni gjetur veten të përfshirë në debate që nuk ju interesojnë. Megjithatë, mundohuni të mos tregoheni shumë agresiv në shprehjen e mendimeve tuaj. Kjo ditë do të jetë mjaft e favorshme në sektorin e dashurisë.


DEMI 21. prill - 21. maj

Ky nuk është momenti më produktiv për punën dhe kjo për shkak se do të jeni shumë të hutuar. Mundohuni që në dashuri të mos jeni shumë të ndrojtur, pasi në të kundërt rrezikoni që të humbni një mundësi të mirë për të rindezur ndjenjat.


BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Do të nisni një rrugëtim profesional shumë interesant, i cili do ju lejojë që të menaxhoni më mirë aftësitë tuaja. Në familje ka disa çështje që kërkojnë zgjidhje, por mos u përfshini shumë në polemika.


GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Mos u ndjeni të detyruar që të kënaqni të gjitha pritshmëritë e të tjerëve, sidomos nëse shkojnë kundër parimeve tuaja. Jini më shumë kurajoz! E rëndësishme është që të tregoni se jeni në gjendje që të fitoni betejat tuaja me vendosmëri.


LUANI 23. korrik - 22. gusht

Kjo ditë këshillon që të mos përfshiheni nga ankthe të kota në vendin e punës. Kjo pasi i keni të gjitha kapacitetet për të kaluar çdo të papritur që do ju dalë përpara me sukses. Mundohuni që në dashuri të jeni më të kuptueshëm.


VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Do të hapet një fazë e rëndësishme për të eksperimentuar me karrierën tuaj. Mundohuni të jeni sa më kreativ dhe kurajoz dhe kjo gjë do ju lejojë që të përballoni më lehtësisht, të gjitha çështjet që ju trembin.


PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Kohëve të fundit do të jeni disi të hutuar dhe negativ, ndoshta për shkak të keqkuptimeve të vogla që keni pasur me partnerin/en. Jini sa më të kujdesshëm në menaxhimin e të ardhurave tuaja, para se të investoni.


AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kjo e martë do të jetë mjaft e ngjeshur, por ju do të arrini të ndiheni krenarë për veten dhe gjithë sakrificat që keni bërë kohëve të fundit. Këshillohet të rivlerësoni më mirë raportet ndërpersonale.


SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Nëse do të përballeni me keqkuptime në dashuri, duhet të jeni ju të parët që të gjeni kurajën dhe të hidhni një hap drejt pajtimit. Kjo gjë vlen, sidomos nëse partnerin/en, e keni lënë pas dore kohëve të fundit.


BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Kjo ditë do ju gjejë disi të turbullt dhe në qendër të debateve. Mundohuni të silleni me sa më shumë diplomaci dhe profesionalizëm dhe kështu nuk do të bini në provokimet e të tjerëve. Në dashuri kjo e martë do të jetë e rëndësishme për të rigjetur harmoninë dhe bashkëpunimin.


UJORI 21. janar - 19. shkurt

Do të riktheheni të jeni të fortë, të sigurtë në vete dhe kjo sjellje do të jetë e rëndësishme për të shfaqur veten para bashkëpunëtorët tuaj. Në sektorin e punës, pritjet që të merni konfirmime.


PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Mundohuni që të kujdeseni më shumë për shëndetin tuaj, pasi kjo ditë mund të mos jetë më e mira. Mund të përballeni me keqkuptime të vogla, të cilat duhen menaxhuar me shumë kujdes. Në punë, duhet të tregoheni më të vendosur.

Mensur Mamuti	BRETI I FUTBOLLIT SHQIPTAR NË FOTO	PRIRE NGANJËANË	PREHU NË PAQË	LËSHOHET NË TOKË	MËSIMË QË ZHVILLOHEN PËR AVANCIM PROFESIONAL
GRATIS MALLKIME			L		
L			E		
MË SHKON FLAKA			GJ		
KËNGËTARJA JONË, SARANDA			E		
ISH BITËLLSI, XHON			N		
VOLTI	DEOXYRIBONUCLEIC ACID QYTETI I NGRITJES SË PARË TË FLAMURIT		D		
NJËSIA E VJETERËS E PESHËS			Ë	RUMANIA PERËNDESHA E BUTRINTIT	
TË HOLLA TË MARRA QË KTHEHEN NË KËSTE			E		
SHKARKIM ELEKTRIK I REVE			F	PILLAKË GRAMAFONI ATOME TË ELEKTRIZUARA	D
PËREMËR PRONOR			U		QELQ KËMISHA
KOHA	ASTATI MEDIUM I SHTYPTUR (GAZETA)		T	OTOMANE PAMFLET NJOFTIMI	KOHA
SHUMËSI		ISH SEKRETARI I KB (KOREAN) RÉSEAU EXPRESS REGIONAL	B		ZAKONI (I DUKAGJINIT) VESHJE E SIPËRME PREJ SHAJAKU PËR BURRA
KUPË, WEDALJE FITOREJE VEGËL MUZIKORE			O		FILMI I PARË ARTISTIK SHQIPTAR DETERJENT PASTRIMI
F			LL	UJIT TIRANA	
JË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO			I		AUSTRIA SPANJA
IMPULSI		KOHË E ÇAKTUAR PËR TAKIM (SH.)	T		



NË KUJTIM

 23 QERSHOR 1960
9 QERSHOR 2018

ZGJIDHJET: FALAS, LANETE, DIGJEM, IMERI, LENON, V DNA, OKË, R, KREDI, RRUFË, D, K, I JUAJI, XHAM, AT, OSMANE, SH, BAN KI MUN, TROFE, TANA, FYELL, VADIT, PRISHTINA, A, I, TERMINET.

Shummë i lehtë

Sudoku

mesatar

			5					9			8		2	1		7
	1	7	9	8					6	7						
9	8				2						3					
		9	6				8	4		4		8		5		1
	4			7			1		1					7		
6	7				8	5					9	2				4
			8				4				6				9	8
				6	5	3	2		9	1			6			
8				4	6				7		4					5

Shummë i lehtë: 462517839, 317986452, 985432167, 239651784, 548379216, 671248593, 756823941, 194765328, 823194675. Mesatar: 458621973, 671953842, 293784615, 347895261, 125346789, 869217534, 536172498, 914568327, 782439156.



Arrat dhe peshku të zgjasin jetën

Do të jetosh më gjatë? Ha më pak mish të kuq. Konsumi i këtij lloji mishi rrit rrezikun për të vdekur, në veçanti për kancerin dhe sëmundjet kardiovaskulare.

Anasjelltas, një dietë që privilegjon peshkun dhe mishrat e bardhë redukton rrezikun e vdekjes. Të paktën 9.3 për qind dhe 7.6 për qind e vdekjeve, respektivisht për meshkujt dhe femrat, është e paevitueshme duke reduktuar racionet e mishit të kuq të konsumuar.

Këtë e thotë një studim i publikuar në revistën "Archives of Internal Medicine", e Harvard School of Public Health në Boston, transmeton Koha Jonë. Në të kaluarën studime të ndryshme kishin dokumentuar se një dietë e pasur me mish të kuq rrit rrezikun për tumore të ndryshme.

Ndërsa këtë herë ekspertët kanë testuar plot 37.698 meshkuj dhe 83.644 femra, duke ndjekur kampionin për një mesatare prej 28 vjeç dhe duke regjistruar në total 23.926 vdekje, nga të cilat 5.910 nga sëmundje kardiovaskulare dhe 9.464 nga kanceri.

Gjumi i vonë dëmton fëmijët

Mos i lini fëmijët të flenë vonë pasi oraret e parregullta të gjumit mund të dëmtojnë ato pjesë të trurit që janë ende duke u zhvilluar, përfshirë ato që lidhen me shikimin, perceptimin dhe përpunimin e të dhënave. Pasi privohet nga gjumi, truri i një fëmije ka nevojë për gjumë më të thellë, sidomos në këto pjesë specifike të trurit. Në studim u vëzhgua aktiviteti i trurit të 13 fëmijëve të moshës 5-12 vjeç gjatë dy netëve, një javë larg nga njëra-tjetra, teksa të vegjlit flinin në shtëpitë e tyre. Në rastin e parë ata fjetën në orarin e zakonshëm, ndërsa herën e dytë u lejuan që të qëndronin zgjuar deri vonë. Skanerat treguan se truri i tyre i përgjigjej ndryshe mungesës së gjumit, krahasuar me të rriturit. Sasia e paktë e gjumit çonte në rritje të nevojës për gjumë të

thellë në ato pjesë të trurit në zhvillim. Efekti i gjumit të thellë nuk shfaqet në rajonet ballore të trurit, ashtu si tek të rriturit, por në anën e pasme. Ky efekt mund të jetë i përkohshëm, që do të thotë se shfaqet vetëm gjatë fazave të rëndësishme të zhvillimit të trurit në fëmijëri ose adoleshencë. Shkencëtarët mendojnë se cilësia e gjumit është përgjegjëse për zhvillimin si duhet të lidhjeve nervore gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës. Prandaj është e rëndësishme që fëmija të flejë mjaftueshëm gjatë kësaj faze të jetës. Sipas udhëzimeve ndërkombehtarë, rekomandohet që fëmijët e moshës 6-13 vjeç të flenë 9-11 orë në natë. Studimi u realizua nga Universiteti i Zyrihut dhe u publikua në revistën shkencore "Frontiers in Human Neuroscience".



3500 dollarë për mysafirët në "Hotel Gripi"

Shkencëtarët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) janë vënë në kërkim të vullnetarëve që do të qëndronin në "Hotel Gripi", ku do të ekspozohen ndaj virusit për të testuar efektshmërinë e vaksinave. Sipas një lajmi në "Live Science", shkencëtarët nga Universiteti Saint Louis në shtetin Missouri kanë themeluar "Departamentin e Qëndrimit të Gjatë për Analiza", të emërtuar ndryshe si "Hotel Gripi". Në hotel do të qëndrojnë vullnetarë të cilët do të infektohen me grip me paramendim. Pjesëmarrësit do t'i nënshtrohen vaksinave ose placebo dhe më vonë të ekspozohen ndaj virusit. Vullnetarët do të paguhet me nga 3.500 dollarë për qëndrimin dhe shpenzimet e rrugës, ndërsa do të mbahen në karantinë në hotel për dhjetë



ditë. Në objektin që posedon tiparet e një hoteli standard do të ketë edhe infermierë që do të kujdesen për pjesëmarrësit. Shkencëtarët planifikojnë ta kryejnë punimin e parë në Hotel Gripi brenda gjashtë muajve.

E ardhmja e "Fiatit" tek modelet e vogla elektrike

Brendi "Fiat" në Evropë do të reduktohet në disa modele të bazuara në linjën e modelit 500 të elektrifikuar dhe "Pandas", kanë thënë zyrtarët e "Fiat Chrysler Automobiles". Ata po ashtu kanë konfirmuar edhe shtimin e modelit "500 Giardiniera" dhe shuarjen e modelit

"Punto" e tërheqjen e modelit "Tipo" nga tregjet e Evropës. "Hapësira për 'Fiatin' në Evropë do të ridefinohet në një hapësirë më ekskluzive", ka thënë shefi ekzekutiv i "FCA"-së, Sergio Marchionne, gjatë shpalesjes së planit të biznesit të kompanisë në fillim të muajit qershor.

Ai ka thënë se kompanisë i duhet të largojë disa produkte që kanë pasur shitje jo të mëdha në tregje. "Rregulloret e ardhshme të Bashkimit Evropian për emetim të karbonit e vështirësojnë edhe më procesin e përfitimit në tregun në masë", ka thënë Marchionne.



1525 - Martin Luther martohet me Katharina von Bora, kundër dispozi-tave të Kishës katolike për priftërinj dhe motra të nderit.

1707 - Hungaria shpall veten të pavarur në Ferenc Rákóczi II

1753 - Austria, Anglia dhe Modena nënshkruajnë traktat të fshehtë ushtararak.

1878 - Mbahet Kongresi i Berlinit për të ndarë kolonitë afrikane.

1902 - Dhoma e larët e Prusisë jep 350 milion marka për Poloninë

1917 - Gjermania bombardon Londrën

1932 - Britania e Madhe dhe Franca nënshkruajnë traktat të paqes.

1978 - Forcat mbrojtëse të Izraelit tërhiqen nga Libani.

1980 - Këshilli i Sigurimit të OKB i bën thirrje Afrikës Jugore për të li-ruar Nelson Mandelën.

2000 - Italia falë Mehmet Ali Agca, personin që tentoi të vrasë Papa Xhon Palin II në vitin 1981.

KALENDARI HISTORIK 13 QERSHOR

Organi më i madh i trupit të njeriut është lëkura. Çdo person ka të ngjarë të ndryshojë rreth 18.14 kg (40 lbs) lëkurë në jetën e tij.



Sipas një mesatareje, muskujt e fokusimit të syrit lëvizin rreth 100.000 herë në ditë. E thënë ndryshe, kjo do të ishte e njëjtë sa të ecnit 50 milje çdo ditë për muskujt e këmbës tuaj.



Qeniet njerëzore janë të vetmet gjitarë në botë që nuk mund të marrin frymë dhe të kapërdijnë në të njëjtën kohë.



ZGJIMI I FUNDIT

Kthehet gruaja nga vizita tek mjeku ku i thonë se do të jetojë vetëm edhe 12 orë, prandaj i thotë burrit të saj se do të donte që në 12 orëshin e fundit ta puth me pasion dhe egërsisht tërë natën.

Burri i përgjigjet gruas: - Kollaj e ke moj grua, ti nuk ke për t'u ngrit nesër në mëngjes...



Njeriu duhet sjellë ndjeshëm dhe sjellshëm me fëmijët. Jeta familjare është lidhja më e mirë. Fëmijët janë gjykatësit tanë më të mirë. (Otto von Bismarck)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS